

Prof. Dr. Josif Papagjoni është kritik dhe studiues i teatrit, kinematografisë dhe letërsisë. Në këtë bisedë, me sinqeritet rrëfen gjithë jetën, karrierën, sfidat dhe fitoret që ka përjetuar përgjatë viteve...

JOSIF PAPAGJONI: Kritika është diçka e fisme, si vashë e bukur, por edhe syvëngër, si plakë e shëmtuar

(fq. 2)

KARAKTERI I LEXIMIT TË LIBRAVE

Nga Xhevair Lleshi

(fq. 9)

Letërsia për fëmijë mes
dilemës dhe mbijetesës

Nga Natasha Shuteriqi

(fq. 8)

Jusuf Gërvalla,
hyjnor i që mbeti i ri

Nga Naime Beqiraj

(fq. 10)

Bahri Beci dhe koncepti i tij
mbi procesin e planifikimit
gjuhësor të shqipës

Nga Prof. Asc. Albana Deda (Ndoja)

(fq. 7)

Ëndrra si shumësi dhe fshehtësi
kuptimore dhe si vizion

Nga Don Robert Kola dhe

Anton Nikë Berisha



(fq. 22)

Vëllimi "Lirikë me dhimbje" i Majlinda Ramës

Bota origjinale e një poeteshe
bashkëkohore

Prof. Dr. Klara Kodra

(fq. 13)



Fotografia © Fate Velaj

LIGJËRIMI POSTMODERN I REXHEP QOSJES

Nga Shefkije Islamaj

(fq. 4)

Të gjitha romanet e Rexhep Qosjes dhe sidomos romani "Nata është dita jonë", për arsye të bazës realiste dhe shtresës alegorike, mund të lexohen me kode të veçanta: ato mund të vështrohen nga shumë anë dhe asnjëra prej tyre nuk mund të cilësohet si më e mira, më e përshtatshme ose më objektive. Jo vetëm lexuesi i rëndomtë, por as lexuesi kritik nuk e ka lehtë të zotërojë tekstin, pasurinë e larminë e tij, por as emocionet, meditimet, kënaqësinë dhe përjetimin estetik që i jep leximi i tij. Edhe për këto arsye ky roman quhet roman postmodern.

NAPOLEONI DUKE KALUAR ALPET

Dr. Bledar Kurti

(fq. 21)

SALLY ROONEY: Mbi shkrimtarët dhe publicitetin

(fq. 20)



BIBLIOTEKË

Roland Gjoza

(fq. 14)

Kredo e çmendur

Arnaud Cathrine

(fq. 15)

Autopsi

Odysseas Elytis

(fq. 16)

*Këngë heroike për nëntogerin
e rënë në Shqipëri*

Baudelaire

(fq. 20)

Palimpsesti

Mehmet Elezi

(fq. 13)

Skifteri

Vladimir Nabokov

(fq. 18)

Kthimi i Çorbas

Pyetësori "Librat e jetës sime"

GRANIT ZELA

(fq. 12)

Libri i fundit që më bëri të qaj?
"Lamtumirë Gabo dhe Mercedes",
shkruar nga biri i Markezit

Prof. dr. Josif Papagjoni është kritik dhe studiues i teatrit, kinematografise dhe letërsisë. Në këtë bisedë, me sinqeritet rrëfen gjithë jetën, karrierën, sfidat dhe fitoret që ka përjetuar përgjatë viteve...

JOSIF PAPAGJONI:

Kritika është diçka e fisme, si vashë e bukur, por edhe syvëngër, si plakë e shëmtuar

Si përherë, e para pyetje: Si nisi rruga juaj drejt artit?

-Kur unë gazmoja si fluturak viteve të gjimnazit, ishte kitara ajo që më lidhi së pari me artin. Ia nisa udhës së teatrit qysh në vitin e dytë gjimnaz me regjisorin Taqo Lepuri. Duke e ndjerë merakun tim, ai mori një kitarë nga magazina e Shtëpisë së Kulturës dhe ma dha. Asaj kohe s'kishte mbasditë që mos të rrija me kompozitorin Thoma Gjoni, i cili shkrihej në fisarmonikë dhe kompozonte lirika të bukura erotike, që u bënë hite, një mrekullizë e vogël për të gjithë të rinjtë e përkorë, të varfër, të paveshur, të habitur, të dashuruar, por aq shumë të dhënë pas artit. Pastaj erdhi Limoz Dizdari me atë energjinë e tij për të bërë kore e koncerte të mëdha në Sarandën e vogël. Dhe, sigurisht, regjisori i estradës profesioniste, Thoma Milaj. Këta njerëz më vunë flatra si prej Dedali dhe Ikariusi; qenë ndoca magjistarë për mua, të riun sarandiot mbushur plot një valixhe ëndrrash, duke më futur në tokën e habitës, vezullimit dhe shastisjes: Artin...

Unë isha nxënës i dhjetës, por kisha qejf edhe teatrin. Ma pikasën, pra, këtë dhunti dhe luajta në shfaqjet e gjimnazit disa drama, ndër to "Mbretëresha e akullit" nga i madhi përralltar norvegjez, Andersen, e cila u bë pjesë e mbamendjes së qytetit për atë kohë dhe ne brodhëm e bëmë qejf nëpër shumë qytete të Shqipërisë nga Tirana në Vlorë, Fier, Përmet, Tepelenë, Gjirokastër etj; recitoja edhe vjersha satirike nga Noli si "Salep Sulltani", në sheshin qendror të qytetit, që më pas hyri në repertorin e estradës profesioniste. Dreq o punë, ja kështu, si me shaka, skena më "gëlltiti" dhe s'dola dot më prej andej, qoftë si një "zejtar", qoftë sidomos dhe si një "mbikqyrës" i saj, si kritik e studiues i teatrit. Kjo qe njëherazi fatmirësi dhe fatkeqësi për mua.

Fatmirësi se më futi në rrugën plot dritë të artit, fatkeqësi se unë doja të bëhesha mjek, kirurg, ndofta dhe një shkrimtar, s'i dihej!... Por në vitin 1967, kur mbarova maturën, nga pushteti m'u tha se duhet të vazhdoja Shkollën e Lartë për Aktor "Aleksandër Moisiu", pasi rrethi ynë nuk kishte asnjë kuadër në këtë fushë. Takoi që atij viti kjo shkollë nuk e çeli kursin e parë dhe mua më emëruan aktor në estradën e Sarandës. Por vërtet shkova pas një viti në konkurs dhe fitova. Fillimisht e mora pak me dëshpërim, por natyra ime i ka brenda ca valë optimizmi dhe e mblodha veten.

Ndoshta mund të bëhesha një aktor edhe unë, jo një kirurg, as një mësues letërsie a shkrimtar?! Aktori qenka një botë e ëndërrt, një ishull i bukur!...

-Dhe kjo ëndër ju thye në mes, nuk u bëtë dot aktor. Pse?

-Nuk mund të them se isha i "keq" si aktor, përkundrazi. Por ja, diku në vitin e dytë të Institutit të Lartë të Arteve unë shkrova një artikull për filmin "Njësitë guerril" të botuar në gazetën më të madhe të kohës, "Zëri i Popullit". Çfarë ngazëllimi që ndjeva! Sot më vjen të qesh me atë ndezulli



rinore prej budallai. Shëtisja bulevardit dhe pata ndjesinë se njerëzit më "shikonin", se duhet të më njihnin, se unë isha futur tashmë në sektin e "mendimtarëve", të atyre që gjykonin për të tjerët dhe kishin pushtet çudibërës mbi ta. Dhe ky entuziazëm më ka shoqëruar përherë tekta shkruaj, natyrisht pa lejuar gdhënjtë e mburrjes të rriten. Edhe sot, në vitet kur veç ndoca gjethe kanë mbetur ende mbi trungun e tharë, e dua një ndezulli emocionesh brenda vetes, ndryshe nuk ia filloj dot një shkrimi. Shkruaja në gjithë shtypin e kohës, në gazetën "Bashkimi" thuajse çdo javë, por edhe në "Drita", në "Nëntori", pastaj te "Skena dhe Ekran". Qe e habitshme se me honoraret që fitoja bëra një kostum. Më pëlqente fort regjisorja. Jeta ime mund të kishte marrë një tjetër drejtim, kur bashkë me Agim Qirjaqin si dy bashkëstudentë të një kursi, dhe të përzgjedhur, na u akordua bursë për në Rumani si regjisorë teatri a filmi. Por kjo ëndërr e bukur u pre, paçka se përgatitëm dhe valixhet. Dhe përse? Histori meskinitetesh shqiptare, dikush nga "bijtë e pushtetit" kërkonte të shkonte vetë, por nuk shkoi dot. Dhe atë vit, më 1972 kur mbarova studimet për aktor, u emërova pedagog në Institutin e Lartë të Arteve në lëndën e Historisë së teatrit botëror dhe shqiptar. Gjithë ngazëllim ia nisa punës dhe kokën e kisha të ndezur nga dhjetëra projekte-ëndrra: artikuj, libra, role, regji, filma etj.

-Dhe?!...

-Dhe "tersin" e pata nën këpucë. Ëndrra u thye. U rrëzova dhe desh theva kokën. Pas Plenumit të Katërt të partisë më 1973, isha pika 42 e shfaqjeve të liberalizmit në këtë Institut, ashtu kot, për diçka të pavërtetë e thuajse groteske, si në romanet e Kafkës, dhe... dhe... Një shkëlqim prapanicës dhe fuuuuuu në Fushë Arrëz, te sharrat dhe gatrrat... Tmerr! Një djalë nga Saranda, i mësuar me detin, me një ëndërr të bukur në sy, i emëruar pedagog, drejt e në një qytezë sharraxhinjsh, ku të përllante era, bora. Ditët e para qenë të trishta, një zyrtim si prej gulagësh të Dostojevskit: një pjatë fasule, një xhup pambuku punëtorësh, një palë çizme. Eh! Nuk vrava një plakë kurrnace si Raskolnikov i Dostojevskit, por "plaka" ime, fati i mbrapshtë a quajeni "partia", më vrau. Ma nguli thikën mu në asht. U tremba. Aty u njoha me Françesk Radin, atyre ditëve më mori në një barakë me dërrasa ku ai flinte. Frynte era gjithkund, flinim mbi ca dyshekë të sajuar me bujashka misri, drejt e në shesh. Dhe aty... boh, na grinin morrat, tartabiqet. Por fati e donte që atyre ditëve në revistën "Nëntori" m'u botua një shkrim për dy komeditë e Moliere, "I sëmuri imagjinar" dhe "Don Zhuani", të përkthyer nga Prokop M. Gjergo. Tek isha në sharra, më vjen një funksionar partie, serioz, i hollë, dhe me zgjat revistën "Nëntori". Ore djalë, më tha, ti e ke shkruar këtë? Po, i thashë i ndrojtur. Ti je Josif Papagjoni, apo jo?! Po. Pse s' thua more, ti je i YNI! - më tha ai me një sy mbushur plot respekt, habi e miradie. Unë mbeta, s'dija ç'ti thosha. E kupton, or ti? Je i yni! Ti ke shkruar këtu, te "Nëntori", në këtë organ të nderuar të partisë, të mendimit... Kjo ma ngrohu trupin në ato ditë akullimi. Pra isha i "tyre"! Dhe aty për aty ia shkrep me përбетimin naiv duke iu përgjigjur: "Po unë i partisë jam shoku..." Dhe hyra rishtazi në "kope". Shpëtova nga ndonjë stabiliment sharrash mes pyjeve a kooperativë bujqësore maleve. Punova me pasion, nder e dashuri aty në rrethin e Pukës, bëra shumë miq, më donin dhe i doja, dhe pushteti më vlerësoi e ma ktheu me përgjegjësi e detyra në fushën

e arteve dhe kulturës. Puka ishte një ngjarje madhore për mua, veç mall e dashuri kam për atë qytezë... Aty u njoha e punova me shumë artistë, ndër ta, siç thashë, edhe me kantautorin Françesk Radi, të cilit ia ktheva mirësinë që më bëri, e ftova të flinte me mua së toku në një dhomë në prapaskenën e Pallatit të Kulturës së Fushë-Arrëzit, ku më caktuan drejtor. Madje-madje, kam meritën (të më lejohet mburrja!) se e mbrojta dhe e nxora para udhëheqjes së lartë të partisë, në një koncert në vitin 1975 ku ishte i pranishëm Haxhi Lleshi, kryetari i Presidiumit të Kuvendit Popullor, duke dalë të këndoja në duet bashkë me të, sipas porosisë së Pali Miskës, sekretarit të parë të rrethit (sepse nuk lejohej që Frankua të dilte solo, konsiderohej si i "infektuar", me "njolla", që i marginalizuar). Dhe diçka tjetër, që edhe sot nuk më hiqet nga mendja: Violeta, e shoqja e Fadil Paçramit, që punonte si bibliotekare në pallat. Përjetova vuajtjen e saj, burgosjen e të shoqit. Fadili ishte flakur në minierën e Tuçit si selektues minerali. E shihja tek zbriste nga autobusi i minierës. Vetëm. Shpejt e arrestuan. Prej tij kam disa libra që m'i dhuroi. Pak më vonë e flakën edhe Violetën e gJORË, aq fisnike. I kam ende në sy lotët e saj. Nuk isha Hyjnesha Talia, që t'ia mblidhja në një lotore balte, por do doja t'i derdhja si shi të trishtë në dhembshurinën time dhe pendesën kombëtare...

-Pas atyre viteve të zymtë iu rikthyet kritikës dhe studimeve. Kur?

-Unë s'hoqa dorë as në Fushë-Arrëz e Pukë. Unë isha tashmë i miqësuar me kritikën, kisha marrë për "kumbarë" kohën dhe durimin, sigurisht dhe synimin për të trokitur seriozisht në fushën e dijes mbi artet, estetikën, kritikën, ndaj dhe krahas botimeve në shtypin e kohës, i isha futur udhës për mbrojtjen e gradës shkencore "Kandidat i shkencave" qysh në vitin 1976. Në vitin 1981 botova librin e parë me shënime kritike "Teatri dhe aktori", i pari mirëfilli i këtij lloji si botim i "Naim Frashërit". Pata disa propozime për të riardhur në Tiranë dhe mes Institutit të Lartë të Arteve dhe Akademisë së Shkencave, zgjodha këtë të dytën sepse e ndjeja se vetëdija ime tashmë gjithnjë e më shumë po mbruhej në këtë magje të mençurisë. Dhe s'di a kam bërë



keq a mirë, fati përherë luan me ne nëpër udhëkryqe dhe ti nuk e ke komoditetin të zgjedhësh, sikur je në ankth e në vrap. Por them se punës së studiuesit i kam hyrë me tërë pasionin dhe vrullimin tim. Është punë e rëndë, e fshehur nëpër mijëra net e ditë leximesh, shpesh me dhimbje dhe kokën të rëndë e të përburuar si një shpellë. Pas gradës "Doktor i Shkencave" me librin "Kumti që vjen nga trashëgimia teatrale" fitova titullin shkencor "Profesor" në vitin 1999. Dhe kështu libër pas libri, deri sot kam shkruar e botuar 32 libra, prej të cilëve dua të përmend "Regjisorët", "Aktorët", "Dialog me teatrin botëror", "Historia e teatrit shqiptar", "Kinematografia shqiptare - historia, qenësia, imazhi", "Të qeshësh: me cilin, për çfarë, përse?", "Fjala, loja, imazhi - vramendje për artin shqiptar". Një vëllim të madh pune e hulumtimi më ka kushtuar "Enciklopedia e teatrit dhe kinematografisë shqiptare", nga Toena, 2006, me mbi 1000 zëra; po kështu, si përgjegjës i redaksisë së kulturës dhe artit, edhe puna me "Fjalorin Enciklopedik Shqiptar", botim i Akademisë së Shkencave. Së shpejti do të botoj "Enciklopedia e Artit Shqiptar", botim i Akademisë së Shkencave dhe Akademisë

së Studimeve Albanologjike, me dy vëllime dhe mbi 2000 zëra, me një varg autorësh të njohur të arteve nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia. Them se ky botim ka qenë si një gur Sizifi mbi shpinën time, ngjitu lart e bjer poshtë, duke ecejakur mes 100 pengesave, dyshimeve, ngurrimeve, strapacimeve. Por më në fund ia dola. Doemos do të ketë vraga e hulli të palëruara mirë, por ama "buajt" i vumë në punë dhe ara e personaliteteve të arteve u lërua, të tjerët pas nesh le ta bëjnë më të bukur! Është një kujtesë kulturore artistike, një pergamenë që duhet shkruar medoemos, sepse ja që dhe në historishkrimet tona jemi kaq të vonuar dhe, mos qofsha i gabuar, "murgjit" e dijes për artet, letërsinë, kulturën më duken gjithnjë e më të lodhur, gjithnjë e më të pakët, sikur "përtojnë" ta lërojnë arën e dijes...

-Ç'është kritika për ju?

-Kritika është diçka e fisme, si vashë e bukur, por edhe syvëngër, si plakë e shëmtuar. E fisme sepse ti luan me veten, me mendimin, me idetë; lazdrohesh nga dija dhe sipëria e saj përballë atyre që ti gjykon. Dhe kjo të jep shumë mirënjohje, miq, falenderime. Kritika është sa shqyrtim shkencor, aq dhe pjesë e poetikës artistike, letrare, stil, vetëshprehje, përjetim. Shpesh është vëngëroshe, sepse kur diçka s'të pëlqen, vetullat bien vrik mbi sy, jo vetëm të tuat, por sidomos të atyre për të cilët ke shkruar, ke bërë vërejtje, ke kritikuar. Kjo është dhimbja tënde, bezdia. Është një thes eshtrash që e ke mbi shpinë dhe duhet ta çosh diku në një krematorium. Më e vështira gjë, ku dinjiteti yt ose lartësohet, ose bjerret në një përqeshje të pafalshme. Dhe këtu duhet karakter, ndershmëri, moralitet. Nuk them se nuk e kam pasur këtë karakter dhe këtë moralitet. Në rini e kisha me "okë", më shpesh e më dukshëm, në pleqëri "okë"-t kanë rënë disi, jam paksa më tolerant, sepse nuk dua ta pështyjë atë gjellë që artistët e kanë bërë me aq dashuri, e cila quhet dramë, shfaqje teatri, film, rol, roman, poezi etj. Nuk shkruaj për çdo gjë. Përzgjedh. Nuk dua që kur të takoj dikë, ai të kthej kokën dhe të bëjë sikur nuk shikon, sepse, dreqin, dua ta pi një kafë me "hatërmbeturin" tim!... Afërmendsh se pas vitit 1990 i hoqa zhelet e metodologjisë së shqyrtimit sociologjik me gjithë skemat e neveritshme të saj dhe, pak nga pak, mes leximeve, veshja ndoca rroba të metodologjive të kohës të fundme, që

nuk na jepeshin më parë. Ndryshoi optika, terminologjia, por edhe muskulatura e stilit duke qenë tashmë më i shkrifët, me përftesat edhe të përjetimeve vetjake e shpengimin.

Nuk i numëroj dot shkrimet e botuara. Ndofta 1500, ose 2000. Kokrra rëre të një jete që të rrëshqet mes duarsh si te sahati egjiptian, Klepsidra. Bien e bien dhe ti sheh se si koha po mbaron. Në fakt, ato bien për duarsh, ditëve të tua, germave të fushnajës së laptopit, por me trurin ngjet e kundërta: sa më shumë shkruan, aq më shumë pasioni, ambicia, puna, dashuria rriten. Është një farë sëmundje. Ves i ëmbël. Kur e mbyll një gjë dhe shkruan "fund", të ngjan sikur çlirohesh nga një ankth, por çuditërisht ajo shoqërohet përherë nga "orgazma" e mendjes. Dhe kjo vazhdon, vazhdon... një fatalitet i pakthyesëm, gjersa të mbyllësh sytë.

-Po letërsia?

-Eh, letërsia është një mikeshë e vjetër! Veç kritikës dhe studimeve mbi dramaturgjinë, teatrin, estradën dhe kinematografinë, unë kam mbetur një i malluar i saj. Kam botuar qindra shkrime për libra, romane, poetë, shkrimtarë; një pjesë syresh, e selektuar fort, ka gjetur botimin në librin tim të vëllimshëm "Fjalë për/mbi letërsinë", ku dua të veçoj shqyrtimet për shkrimtarët Kadare, Agolli, Laço, Lera, Muço, Mustafai, Bejko, Zhupa, Açka, Lleshanaku, Dino, Medi, Çapaliku, Velaj etj. Letërsinë nuk e dua vetëm ta lexoj ose të flasë mbi libra dhe autorë, por edhe ta shkruaj vetë. Qysh në gjimnaz e doja fort dhe ishte një dilemë kur zgjodha rrugën e jetës. Kam botuar një përmbledhje me 7 drama e komedi, librin me tregime e novela "Kur hëna digjej lart", që ka fituar edhe një çmim, së shpejti del romani im i parë "Hije në shtratin e mortit", por në sirtar kam përfunduar edhe romanin tjetër "Vjega e gjakut" si dhe një vëllim të ri me tregime e novela "Re që ikin, re që vijnë". Letërsia fle paqësisht në përjetimet dhe meditimin tim. Është më superiore. Ti ngazëllen me të, "fluturon" qiejve. Kënaqësinë që të jep ajo, loja dhe përkëdhelja e fjalës, si mbi një lëkurë femre, është e pazëvendësueshme. Unë shkruaj thjesht për qejf, fjala lojcake shqipe më largon nga batakua i mërzive dhe rituali idiot i ditës. Çudi, letërsia nuk më tremb, edhe sikur ta di se ajo çka po shkruaj është një dështim...



Shkrimtari Rexhep Qosja, me të drejtë, nga studiuesit e veprës së tij letrare-artistike konsiderohet përfaqësuesi më i rëndësishëm e më i veçantë i letërsisë moderne-postmoderne shqipe. Në të pesë romanet e tij "Vdekja më vjen prej syve të tillë" (1974), "Një dashuri dhe shtatë faje" (2003), "Nata është dita jonë" (2007) "Bijtë e askujt" I, II (2010) dhe "Të fsheshtat e treguara" (2020), mbizotërojnë tipare të shquara të modernizmit dhe sidomos të postmodernizmit. Postmodernizmi, sidomos i romaneve të tij të fundit, është vazhdimësi e modernizëm-postmodernizmit të tij të shprehur që në romanin e tij të parë "Vdekja më vjen prej syve të tillë", që konsiderohet romani nismëtar i postmodernizmit në letërsinë shqipe. Ai është i identifikuar si i tillë me shumë tregues postmodernë e sidomos me stilin. Ndërkaq, në romanet e botuara pas vitit 2000 prirjet postmoderne sa vijnë e përforcohen, ndërsa autori sa vjen e bëhet më i vetëdijshëm për misionin e tij dhe sa vjen e bëhet më ironik, për më tepër me sarkastik.

Me romanet e tij, ai ka sjellë zhvillim të formave letrare, risi e sintheza të reja stili, shprehje të reja artistike, i ka sjellë letërsisë shqipe dhe përvojës sonë letrare pasurim në shumë drejtime: me përmbajtjet, me idetë, me teknikën e me organizimin letrar e gjuhësor.

Për shkrimtarët modernë e postmodernë gjuha është element me shumë rëndësi, në të vërtetë është medium për të eksperimentuar dhe për të aktualizuar risi dhe strategji të ndryshme shpërbërëse në nivelin e tingujve, të fjalëve, të togfjalëshave, të frazeologjive, të ndërtimeve sintaksore deri në nivelin e njësisve më të mëdha tekstore. Sipas post-strukturalizmit, si pararendës i posmodernizmit, gjuha kuptohet si lëvizje e paskajshme dhe një lojë e përhershme e llojit të vet në të cilën raportet midis shënuesit dhe të shënjuarit vazhdimisht ndërrohen duke krijuar këtë rast përfytyrime të kuptimeve të qëndrueshme. Nga kjo anë, romanet e Rexhep Qosjes janë origjinale dhe shumë të veçanta në letërsinë shqipe edhe me gjuhën. Originaliteti dhe veçanësia shfaqen si në strukturën e brendshme ashtu edhe në strukturën e jashtme të romaneve, si në ballafaqimin e rregullsisë dhe të çrregullsisë, si në raportin midis arsyes dhe paarsyes, të heroit e të antiheroit, si në kundërvënien e të natyrshmes me artificiale, të moralit e të kundërmoralit, të lirisë e të dhunës dhe shprehen si në poetikën ashtu edhe në gjuhën e stilin e tyre.

Me stilin, siç dihet, nuk parakuptohet vetëm gjuha, por edhe struktura e romanit - ndërthurja e pamjeve, motiveve, simboleve dhe e metaforave. Në këtë drejtim, shkrimtari Rexhep Qosja, është treguar vërtet mjeshtër i madh i gjuhës, virtuoz, gjurmues e ruajtës, përpunues dhe krijuar i saj. Mund të mendohet se kjo gjuhë me veçori të spikatura është më e përshtatshme për tema të vogla, por romanet e Rexhep Qosjes e kanë provuar e argumentuar plotësisht të kundërtën. Të gjitha romanet e tij, prej romanit të parë "Vdekja më vjen prej syve të tillë" e deri te romani i fundit "Të fsheshtat e treguara", trajtojnë njëkohësisht tema të mëdha e tema të vogla të historisë e të së tashmes sonë dhe pikërisht kjo gjuhë i ka mundësuar autorit t'i trajtojë ato në mënyrën, siç i ka trajtuar: të jashtëzakonshme. Prandaj, jo vetëm temat e idetë e tij, po sidomos edhe gjuha e stili i romaneve të tij, e përlavdërojnë autorin e tyre si shkrimtar të madh.

Romanet e Rexhep Qosjes janë ndërtuar mbi një lëndë shumë të pasur jetësore e intelektuale, lëndë që e ka burimin në përvojën personale të shkrimtarit, në erudicionin e tij kulturor dhe në faktet historike e sociale. Dhe kjo pasuri e larmi përmbajtjesore, kjo përvojë e pasur intelektuale e njerëzore, kjo shumësi të dhënash kulturore, historike e shoqërore, ka kërkuar një gjuhë të pasur me shumëkuptimësi, një gjuhë shumë të pasur edhe nga ana formale e strukturore, ka

LIGJËRIMI POSTMODERNI I REXHEP QOSJES

Nga Shefkije Islamaj

kërkuar një gjuhë e një ligjërim të veçantë. Gjuha e romaneve të Rexhep Qosjes sjell pasurim nga shumë anë - nga ana semantike, leksikore e sintaksore.

Romanet e Rexhep Qosjes shquhen pos me risi, teknika e strategji ideoestetike, edhe me gjedhe të veçanta të shkrimit kritik-artistik, shquhen me vetëdije, qëndrim e ndjeshmëri të re ndaj njeriut dhe botës, ndaj mendësisë dhe moralit të tij. Për të konkretizuar atë që u tha po i referohemi në këtë rast romanit të tij "Nata është dita jonë"

ROMANI "NATA ËSHTË DITA JONË"

Romani "Nata është dita jonë" sjell njohje shumë të gjerë e të pasur, por edhe shumë personazhe, karaktere, qëllime, veprime. Ai e ndihmon lexuesin të ndërtohet me vlera dhe njohje, duke nxitur te ai përpjekjen për të sendërtuar idealin estetik, domethënë dëshirën për të bukurën, për të lartën dhe për të përsosurën. Në roman shkrimtari paraqitet ndërmjetësues aktiv midis të mundshmes e të pamundshmes, midis reales e imagjinare, midis mitit e historisë, midis të vërtetës e gënjeshtres, midis lirisë e dhunës, midis të drejtës e të padrejtës, midis kimit dhe njerëzores, midis dashurisë dhe urrejtjes. Motivi kryesor, shtytës, në romanin "Nata është dita jonë" është pakënaqësia e autorit me rrethanat e gjendjen në realitetin dhe në mendësinë shqiptare, në mjedisin ku është formuar e zhvilluar si intelektual, si studiues e si shkrimtar. Ai e përjeton thellë rënien shpirtërore, emocionale, etike, morale e kulturore të Vajazanit, të shfityruar, të veshur me pafytyrësi e qyqarësi, me vrazhdësi e paturpësi, në kohën e pasluftës së fundit, kur do të duhej realisht të ngrihej i rilindur, sepse po përjetonte çlirimin e dëshiruar e të shumëpritur. Revolta, zhgënjimi dhe dëshpërimi janë të depersonalizuara në atë mënyrë që shihet fare qartë se romani ka lindur pikërisht nga kjo revoltë, ky zhgënjim e



ky dëshpërim. Romani ndërtohet përmes një kronike të gjerë e të pasur, objektive e reale, mbushur me ngjarje e personazhe që na paraqiten prej rrëfimitarit, që është njëri ndër përfaqësuesit më tipikë të këtij zvetërimi e të kësaj rënieje morale, viktime e zhgënjimit dhe e dëshpërimit në një mjedis tipik për kohën tonë, të mbarënjohur jo vetëm nga lexuesi i pararomanit, por edhe nga lexuesi i sotëm, i pasromanit.

Romani karakterizohet me kompozicion të veçantë, me pasuri formash e me larmi strukturimi të brendshëm, i dukshëm për syrin dhe mendjen e lexuesit. E kuptueshme sepse shumësia e teknikave dhe e strategjive të autorit bashkë me kontekstin e gjerë jo vetëm kulturor janë tregues bazë të romanit postmodern, siç është cilësuar romani "Nata është dita jonë". Përdorimi i gjuhës është ndër veçoritë më të spikatura të këtij romanit. Gjuha në këtë roman nuk është vetëm krijuar, por edhe gjurmues, veçori kjo e gjuhës së shkrimtarëve të mëdhenj të të gjitha epokave.

ROMAN MODERN APO POSTMODERN?

Në romanin "Nata është dita jonë" shkrimtari Rexhep Qosja ka paraqitur në mënyrë të gjerë e të plotë artistike njëmendësinë shoqërore, politike, kulturore, etike dhe psikologjike në përmasat e mundshme reale, siç i ka parë, ndër e përjetuar ai, në Vajazanin e tij, që identifikohet me gjithë hapësirën shqiptare. Nga ky mendim i shprehur mund të mendohet se kemi të bëjmë me një roman modern, por ky përcaktim nuk do të ishte i plotë, objektiv, sikur të mos thuej se shkrimtari në këtë roman shkon përtej kësaj paraqitjeje artistike reale: ai, jo vetëm paraqet njëmendësinë por, njëkohësisht, shpreh fuqishëm papajtuëshmëri, pakënaqësi, kundërshtim, demaskim dhe përçmim ndaj kësaj njëmendësie, domethënë tregon ndërgjegje të lartë sa të përtashme aq edhe historike. Dhe këtë papajtuësi ai e realizon përmes për-

zierjes së natyrshme të llojeve të ndryshme shkrimore-ligjërimore dhe të ndërveprimeve të shumta midis tyre, prandaj mund të quhet roman postmodern. Në të vërtetë, mund të thuhet edhe kjo: romani "Nata është dita jonë" qëndron midis romanit modern dhe atij postmodern si me ndjeshmërinë ashtu edhe me formësimin. Në roman shkrimtari ka ngritur në kult artin, artizmin e shprehjen e pastër artistike, por, njëkohësisht, ka aktualizuar eksperimentimin me stilin e ashtuquajtur përmbysës (subversiv), ka zbatuar strategji e teknika arti të kombinuara, sidomos me referenca të shumta kulturore, historike, mitike, politike, shoqërore, etike dhe natyrisht estetike. Si i tillë ky roman zgjon kureshtjen jo vetëm të lexuesit, por edhe të studiuesit letrar e gjuhësor, jo vetëm për narracionin e strategjitë narrative të tij, por edhe për gjuhën e stilin, për artin e gjuhës dhe gjuhën e artit, për pasurinë gjuhësore dhe stilistikën e pasur.


Duke qenë modern dhe postmodern, qoftë edhe me titullin, me *ditën - natë e natën - ditë*, romani "Nata është dita jonë" shquan me shumësi e larmi ligjërimore, strukturore e poetike, për çka i ofron mundësi studiuesit trajtime nga këndvështrime të ndryshme dhe zbatim metodash të reja ose gërshtetim metodash tradicionale dhe moderne.

Studiuesit e prirjeve letrare thonë se postmodernizmi nuk e kundërshton modernizmin, por i interpreton lirshëm të arriturat dhe rëniet, të mirat dhe dobësitë e tij, duke i përimituar në mënyrë kritike e gjithëpërfshirëse. Mund të thuhet se ky roman është gjedhe e mirëfilltë si bashkohem modernia dhe postmodernia në letërsi e në jetë. Këtë bashkim Linda Hatçën, njëra ndër studiueset më të shquara të postmodernizmit e shpjegon si ballafaqim të modernizmit dhe postmodernizmit: vepra letrare moderne, thotë ajo, është e mbyllur, e vetëmjaftueshme, e pavarur: ajo siguron unitetin përmes ndërlidhjes së pjesëve të veta formale, të cilin unitet ajo e shpërbën më pas, kurse vepra letrare postmoderne është e hapur - ajo ia kthen botës tekstin artistik duke bërë përpjekje në atë rast që ta ruajë pavarësinë e saj estetike.¹ Ky përcaktim në mënyrë më të saktë e fut romanin "Nata është dita jonë" të shkrimtarit Rexhep Qosja në kufijtë ndjenjorë, kuptimorë e strukturorë të postmodernizmit.

Rexhep Qosja, përmes fikcionit dhe njëmendësisë, ka bashkuar polifoninë e zhanreve, toposeve, kohëve dhe personazheve në një botë unike artistike të realizuar përmes një shumësie e larmie gjedhesh diskursive. Kjo polifoni shprehet posaçërisht edhe në ndërtimin e personazheve, në përqendrimin ekspresiv të botës së tyre të brendshme, në zhvillimin e tyre dhe në kritikën e thellë të realitetit të njëmendësisë së shfityruar. Romani "Nata është dita jonë" edhe në këtë pikëvështrim hyn plotësisht në kornizat e romanit postmodern.

Vetëreferencialiteti si tipar i metafiksion-

¹ Linda Hutchion, *Poetika postmodernizma: historia, teorija, fikcija*. Botimi i parë, "Svetovi", Novi Sad, 1996.



it në këtë roman është sajuar në atë mënyrë që teksti të shpërfaqë shumanshëm strukturën e vetë, përkatësinë zhanrore, kontekstin dhe subjektin. Edhe pse metafiksioni, ta quajmë historiografik, përfshin përmbajtjen, mënyrën e ligjërimit, personazhin letrar dhe veprimin narrativ, kjo mënyrë paraqitjeje bën që lexuesi i vëmendshëm i romanit të mos harrojë në asnjë çast se po lexon krijim artistik. Metaforat, parabolat, ironia, satira dhe në përgjithësi tërësia e tropeve dhe e figurave të përdorura letrare e gjuhësore, e bëjnë romanin "Nata është dita jonë" të lidhur mirë rreth një qendrore fabulare. E kaluara dhe e sotmja vlerësohen duke u ballafaquar mes vete përmes një ironie të fuqishme dhe mbresëlënëse. Përvoja e metafiksionit historiografik, siç dihet, gjithmonë është shprehje e përvojës së leximit. Romani "Nata është dita jonë" të Rexhep Qosjes e bëjnë posmodern edhe referencialiteti dhe metafiksioni historiografik.

NARRACIONI DHE LIGJËRIMI

Romani "Nata është dita jonë" është realizuar mjeshhtërisht me shumësi veprimesh narrative të poetikës postmoderne, shumica e të cilave fshehin ose mjegullojnë gjurmët e autorit, prandaj krijohet përshtypja që idioma narrative s'është e thënë të jetë e rrëfimitarit. Kjo teknikë, e njohur edhe si ligjërimit i lirë, jo i drejtpërdrejtë, ose si ligjërimit i jetuar a i përjetuar, i ka shërbyer shkrimtarit si mjet i përshtatshëm narrativ e stilistik, me të cilin është arritur baraspeshë e përsosur ndërmyjetetës së tretë dhe vetës së parë, ndërmyjetet paanësisë realiste dhe emocionalitetit, në të vërtetë është arritur të krijohet përshtypja që ai vetë, rrëfimtari, nuk është autor i rrëfimeve në roman, prandaj në rrëfimin e romanit mbizotëron leksiku dhe sintaksa e personazheve, qoftë përmes dialogëve, monologëve të rrëfyer ose të së folurës në vetën e tretë, qoftë përmes përdorimit të

fjalëve deiktike, të përemrave dëftorë dhe të përcaktuesve kohorë, që u shkojnë përshtati citimeve e jo ligjërimit:

**Nuk ka rregull pa përjashtim. Ka krije-
sa të cilave natyra u ka dhënë të drejtë
më të madhe për jetë të gjatë sesa njeriut.
Breshka – edhe pse me samar në shpinë dhe
shkaba – edhe pse grabitqare e lirë në majë të
shkëmbit, jetojnë më gjatë se njeriu. Mrekulli
natyre! Sa më i robëruar – si breshka nga sa-
mari dhe sa më i lirë dhe grabitqar – si shkaba
në majë të shkëmbit, do të jetosh më gjatë.**

**Domethënë: robëria dhe liria – kundër-
shtohen, kushtëzohen dhe përplotësohen!**
(f. 14)

Shkrimtari ka arritur synimin të qëndrojë pak a shumë jashtë veprës së tij, të qëndrojë "indiferent" dhe "i padukshëm". Për arsye të frymës "klasike", shkrimtari refuzon të ndryshojë atë që ndien, atë që ka parë e dëgjuar e, megjithatë, përzgjedh të përpunojë e të modifikojë atë që di, atë që ka menduar ose atë që është e pranishme. Ky veprim mund të konsiderohet si veprim i aluzionit posmodern i lidhur me estetikën e pavetësisë (impersonales), i aluzionit, si formë shprehëse e pashmangshme në postmodernen, si lidhje e epërme midis asaj që mund të paraqitet dhe asaj që vetëm mund të imagjinohet. Mungesa e qëndrimit të qartë të autorit dhe, ta quajmë, pavetësia narrative e tij që sugjeron paanësi, mund të quhet përzgjedhje e ndërjegjeshme estetike e shkrimtarit Rexhep Qosja.

Në lexim të parë, gjithçka që ndodh në roman na duket objektive dhe plotësisht e qartë, por vëzhgimi i vëmendshëm që ka synim të depërtojë sidomos te të pathënat ose te kuptimet e fshehta, zbulon se këtyre rrëfimeve a monologëve të shpeshtë të personazheve, në të shumtën e rasteve qëllimisht u "mungojnë" intriga a ngjarja, të cilat shpërfaqen më tej nga ndonjë nëntekst a mbitekst që është qëndër e pozicionit të

shkrimtarit dhe e kuptimit të qëndrueshëm, që lidhet me të. Nga ky aspekt, romani "Nata është dita e jonë" nuk ndërtohet me narracion të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës, por plotësohet shkallë-shkallë me fragmente, aluzione të tejshme dhe të pakapshme, të cilat në vazhdimësi sugjerojnë diçka që mund të imagjinohet, por jo edhe të përshkruhet në mënyrë diskursive:

Nata që dy orë e ka pushtuar ditën. Janë marrë vesh që të sundojnë duke u ndërruar sa njëra sa tjetra: dymbëdhjetë orë dita e dymbëdhjetë orë nata. Kohë pas kohe dita sundon më gjatë se nata e, mandej, nata më gjatë se dita. Marrëveshja e tyre është e përjetshme. Njerëzit kurrë nuk mund të bëjnë marrëveshje të përjetshme si dita e nata: gjithmonë njëri dëshiron të sundojë më gjatë se tjetri!

**Në largësi shihen drita, që më shqetësojnë
e nuk e di pse më shqetësojnë. Ndoshta pse më
mirë, më sigurt ndihem në terr. Të dhjefsha
dritën. Rroftë terri! Punët më së miri bëhen në
terr. Terr! Dritë! Natë! Dritë! Terr! Dritë! Shkëm-
bim i padurueshëm! i them Garipit.** (f. 130)

"Ftohtësia" e paraqitjes së këtyre dhe, ta quaj, "paanësia" e stilit të këtyre, kanë pikëmbështetje të fortë estetike moderne dhe përmasën e rëndësishme etike të romanit, për çka mund të quhet edhe roman i njerëzve të pakënaqur, të diskriminuar, të skajuar, të parrealizuar, i njerëzve pa mundësi për të jetuar normalisht, i njerëzve të dështuar, të humbur, të shkatërruar, për më tepër i njerëzve të kriminalizuar, siç është Budin Buda i konvertuar në Kentaurin, në një mjedis të kontaminuar politik, shoqëror, kulturor e etik. Mund të thuhet se romani shquhet për përmasën estetike krahe përmasës etike. Përzgjedhja e shprehjeve gjuhësore që përmbajnë mllëf, pakënaqësi e pashpresë, por edhe vulgaritet, e konkretizojnë qartë gjendjen në të cilën bëjnë jetën personazhet e romanit. Budin Buda i Rexhep Qosjes sikur na e thotë mendimin e Albert Kamysë: "Mënyra e vetme për t'u përballur me botën jo të lirë është të jesh paimagjinueshëm i lirë, aq sa jeta jote të bëhet akt rebelimi".

Aluzionet, imazhet asnjëse, retorika, teknika e kolazhit, monologu i brendshëm, dialogët dhe strukturat dramatike të dialogëve, që përdoren për të humbur gjurmët e rrëfimitarit, e dëshmojnë shkathtësinë e veçantë të shkrimtarit që qëndron prapa këtyre teksteve e strategjive postmoderne. Këto strategji e kanë ndihmuar shkrimtarin për të organizuar, ndërthurur e përzgjedhur ato që ka vendosur t'ia lërë lexuesit i zbulojë dhe ato që ka vendosur t'i heshtë a t'i fshehtë. Një ndërveprim i tillë na e çon mendjen te veprat e shkrimtarëve të mëdhenj modernë e postmodernë si Xhems Xhojsi, Virxhinia Uolfi, Uiliam Fokneri, Ernesto Sabato, Hulio Kortasari, Federiko Garsia Markezi, Horhe Luis Borges, Gynter Grasi, Umberto Eko, Salman Ruzhdi. E të tjerë.

SHKRIMTARI DHE IDENTITETI GJUHËSOR I ROMANIT

Romani përshkon rrugëtimin e vet përmes gjuhës përkatëse, individualizuese dhe mjaft të përzgjedhur. Mund të thuhet se shkrimtari, përmes gjuhës në mënyrën më të plotë realizon ta quajmë një medium shumë të gjallë e të ndryshueshëm që afirmon qartë identitetin e tij të veçantë e të dallueshëm shkrimor. Në roman përmes gjuhës, herë më hapur e herë më fshehtë mund të identifikohen lehtësisht ndodhi, ngjarje dhe njerëz realë, të njohur për lexuesin që sado pak e një hapësirë shqiptare e në veçanti Kosovën. Ky identifikim bëhet edhe përmes referencave, parafrazimeve ose parodive inventive. Disa personazhe i identifikon më së qarti e folura dhe stili i tyre në monologët ose në format e tjera shkrimorë-ligjërime në roman. Disave prej tyre u përmenden edhe emrat.

Në mjaft raste lidhjet ndërtekstore janë më shumë se të qarta. Pjesët ku shkrimtari është "vetvetja", ai "i vërteti", "origjinali", i shquan stili logjik, i qartë, i saktë, përshkruar, stili që paraqet kurrizin e romanit të tij. Ja një shembull dëshmuar për këtë stil:

**Nuk është hera e parë që më rrethojnë
personazhet kur i afrohem përfundimit të ro-
manit. Pse më janë afuar këta sot? E tregojnë
vetë, natyrisht. Shumica janë të pakënaqur me
vetveten në roman, me vendin që u është dhënë
në roman, me cilësitë me të cilat janë pajisur
qoftë prej rrëfimitarit, qoftë prej meje, qoftë prej
njëri-tjetrit a njëra-tjetrës, ndërsa vetëm dy-tre
mund të jenë të kënaqur dhe kanë ardhur të
më shprehin mirënjohje për kujdesin e treguar
ndaj tyre.** (f. 351)

Ndërkaq, aty ku shkrimtari flet me gjuhën e rrëfimitarit, me gjuhën e personazheve, stili shpesh është përdallues nga ai i "vërteti", pra i vetë shkrimtarit. Ai është i shpejtë, i rrjedhshëm, është një formë narrative që "shkrihet" në fjalë, në lumë fjalësh, në radhitje fjalësh të një fushe tematike, në grumbullim, numërim ose në kundërvënje.

Kur ju kanë ndihmuar?

Kryesisht në Mesjetë!

Kur ua kanë ngatërruar punët.

Kryesisht në komunizëm!

Pse në Mesjetë?

**Sepse ishim të robëruar, kurse me to kri-
jonim iluzionin lirie.**

Pse në komunizëm?


**Sepse mendonim që jemi të lirë, kurse me
to e robëronim shpirtin.** (f. 258)

Në këto tekste që u ngjajnë dialogëve të dramave klasike e që nuk janë të pak- të, shquhen veçori stili të shkrimtarëve të mëdhenj të epokave të ndryshme, nisur nga stili solemn e nga plotësia e gjallësia e renesansës, nga retorika klasikiste e nga gjerësia e letërsisë viktoriane, përkatësisht dikensiane, e deri te ligjërimit i shkrimtarëve si Xhojsi, Fokneri, Borges, që i bashkojnë të gjitha këto në ligjërimitin e tyre artistik.

Në romanin "Nata është dita jonë", krahas stileve dhe ligjërimeve të shumta, janë aktualizuar ndërtekstualisht dhe mund të identifikohen disa lloje tekstore brenda narracionit mbizotëruar, që ndërliken duke formësuar disa nënloje të tyre, në të cilat nuk është lehtë të përdalohen kufiri i tyre e as kufiri midis shkrimtarit e rrëfimitarit, midis tekstit letrar e jo letrar.

Të gjitha romanet e Rexhep Qosjes dhe sidomos romani "Nata është dita jonë", për arsye të bazës realiste dhe shtresës alegorike, mund të lexohen me kode të veçanta: ato mund të vështrihen nga shumë anë dhe asnjëra prej tyre nuk mund të cilësohet si më e mira, më e përshtatshme ose më objektive. Jo vetëm lexuesi i rëndomtë, por as lexuesi kritik nuk e ka lehtë të zotërojë tekstin, pasurinë e larinë e tij, por as emocionet, meditimet, kënaqësinë dhe përjetimin estetik që i jep leximi i tij. Edhe për këto arsye ky roman quhet roman postmodern. Në të vërtetë romani "Nata është dita jonë" mund të quhet roman postmodern edhe për një arsye të madhe – lirinë: lirinë e shkrimtarit, lirisë e rrëfimitarit, lirinë e personazheve, domethënë lirinë e shprehjes mendimore, ndjenjore dhe sidomos lirinë gjuhësore e stilistike. Trajtat e mendimeve, të ndjenjave, të gjuhës dhe të stilit të tyre janë shpesh të papritura madje edhe të çuditshme. E kur thuhet të pazakonshme dhe të çuditshme mund të thuhet postmoderne.

Në fund, duhet të rithuhet se vendi dhe roli i romaneve të Rexhep Qosjes në letërsinë mbarëkombëtare shqipe, si shpërbërëse të kodeve letrare tradicionale romantike e realiste, janë shembëllyese me vendin dhe rolin e romaneve të Marsel Prustit në letërsinë franceze, të Xhems Xhojsit në letërsinë angleze, të Uiliam Foknerit në letërsinë amerikane dhe të Ernesto Sabatos në letërsinë latinoamerikane.



Ligji i parë i komunikimit thotë se është Le pamundur të mos komunikosh. Kjo do të thotë të implikohesh në pikëpamje konkrete dhe praktike. Ligji i dytë i pohon se ne mund të komunikojmë në disa nivele, me gjuhën por edhe përmes kanaleve të tjera që i japin konotacion të ashtuquajturës përmbajtje denotative e gjuhës. Ligji i tretë flet për aspektin pragmatik të komunikimit, kjo është ajo që ne duam të arrijmë kur i komunikojmë diçka dikujt. Për shembull kur një fëmijë vjen tek ju dhe ju thotë Sa i bukur ky stilolapsi me pelikan! Unë nuk kam një të tillë nuk e kërkon drejtpërdrejt stilolapsin, por është e qartë se çfarë do të thotë¹. Në këtë kompleksitet marrëdhënia shfaqet në dy nivele: praktike/ reale dhe e presupozuar. Kjo marrëdhënie dynivelëshe vështirëson deshifrimin...dhe kjo ndodh jo vetëm në jetën e përditshme, por edhe në botën e letrave. Letërsia është një fjalë e vështirë (Williams 1976: 183)², shkruan Uilliams dhe sipas tij kjo ndodh, sepse sensi i zakonshëm i fjalës duket shumë i lehtë në të kuptuar, por kur gjendemi para pyetjes se cilët libra, cilët romane, cilët autorë duhet të hyjnë në kategorinë e letërsisë, pashmangshmërisht, shfaqen problemet e para.

Ky dualitet paradoksal paraqet po kaq vështirësi edhe në fjalën fëmijë/fëmijëri, sepse duket po i njëjti evazion kur ndodhemi para pyetjes: këto fjalë, çfarë nënkuptojnë në situata dhe kontekste të caktuara (të ndryshme, specifike)?

Pikërisht këtu problemi ndërlikohet edhe më shumë kur interferojnë mes tyre komunikimi, letërsia, fëmija/fëmijëria të gjitha së bashku në letërsinë për fëmijë.

Çfarë bën pjesë në letërsinë për fëmijë? Sipas Lesnik-Obërshstein³ në letërsinë për fëmijë bëjnë pjesë një kategori librash ekzistenca e të cilëve varet pikërisht nga një sërë marrëdhëniesh të supozuara me një publik të caktuar, atë të fëmijëve (Lesnik-Oberstein 2002: 15).

E ndërsa në botë kritika që e trajton këtë letërsi është quajtur kontradiktore⁴, në Shqipëri ajo pothuajse nuk ekziston fare⁵. Nëse vështirësia qëndron në faktin se kritikës i takon të analizojë në një të vetme dy koncepte: atë të letërsisë dhe atë të fëmijërisë, kjo do të kërkojë detyrimisht një studiues të formuar jo vetëm në fushën e letrave, por edhe në atë të psikologjisë, pedagogjisë, linguistikës, etj, pra pak a shumë një sasi dijesh konjitive, të cilët kanë të përcaktuar më së pari objektin e hetimit. Në të vërtetë, në kohën që botimet për fëmijë sot janë më produktivët në tregun⁶ evropian dhe atë shqiptar, kritika ka ngërçet e saj në botë dhe paragjykimet e ankthshme në Shqipëri. Jo pak raste ajo është paragjykuar si një letërsi e padenjë për të marrë vëmendje, sepse është parë si tepër e thjeshtë, mediokre dhe jo fort e thellë. Ky paragjykim i ardhur më së pari nga përcakimi që termi sjell me vete letërsi për fëmijë, kufizon audiencën, por njëkohësisht indiferenca që shoqëron këtë tipologji shkrimi, tregon/ rrëfen edhe një herë për hapat e vegjël që ka bërë njerëzimi në drejtim

1. <https://www.vivoscuola.it/content/doenload/3932/122034/file/1%20PERCORSI%20EVOLUTIVI%20DEI%20BAMBINI%20E%20INDICATORI%20DI%20RISCHIO.pdf>

2. Williams, Raymond, Keywords. A Vocabulary of Culture and Society, New York, Oxford University Press, 1976.

3. Lesnik-Oberstein, Karin - Thompson, Stephen, "What is Queer Theory Doing with the Child?", Parallax 8.1 (2002).

4. Zanfabro, Giulia, "Chi ha paura dei libri per bambini/e? I presupposti della critica: una questione politica", L'immaginario politico. Impegno, resistenza, ideologia, Eds. S. Albertazzi, F. Bertoni, E. Piga, L. Raimondi, G. Tinelli, Between, V.10 (2015), <http://www.betweenjournal.it/>

5. Pak autorë janë marrë mirëfilli me kritikën e letërsisë për fëmijë në gjuhën shqipe, ku për prurje me shumë vlera do të veçonim Astrit Bishqem dhe Anton Nikë Berishën

6. Pro këtij argumenti sjellim të dhëna nga disa tregje të mëdh botimesh në Europë: <https://www.ibisworld.com/united-kingdom/market-research-reports/childrens-book-publishing-industry/> <https://www.statista.com/statistics/411524/children-and-youth-books-revenue-share-germany/> <https://publishingperspectives.com/2021/07/italy-publishers-report-44-percent-unit-growth-first-half-of-2021-covid19/>

LETËRSIA PËR FËMIJË MËS DILEMËS DHE MBIJETESËS

(Pse, drejtin, kemi frikë nga letërsia për fëmijë?)

Nga Natasha Shuteriqi

Në një nga libraritë e kryeqytetit, një pyetje për dy përgjigje:

-Çfarë libri do blesh zemër?

-Teta, mami më ka thënë të blej librin "Dy vjet pushime" të Zhyl Vernit.

- Kurse mua të dy, babi dhe mami më thonë që duhet të lexoj patjetër "Çufon", para se të hyj në klasë të pestë.



të vlerësimit ndaj pjesës më sensitive dhe më të rëndësishme të shoqërisë: fëmijëve.

Po të hedhim sytë në një rrafsh diakronik të letërsisë në botë, do të vërejmë se në historikun e saj letërsia ka njohur disa perceptime të lexuesit të kësaj letërsie, të cilat ndikuan fort në politikën botuese të shtëpive të mëdha editoriale: Alice`s adventures in Wonderland (Carroll, Lewis (Dodgson, Charles Lutwidge, publikuar nga New York: D.Appleton & Co, 1866), fill pas botimit nis përkthimin për të arritur deri në 175 gjuhë, duke u bërë me shumë gjasa, libri më i lexuar i kohërave, deri sa pa dalë Harry Potter ...

Harry Potter, i cili kapërceu gjithë pritshmëritë, duke u cilësuar çmimi i parë letrar i të gjitha kohërave⁷ arriti të mposhtë edhe paragjykimin e etiketimit të letërsisë për fëmijë si një zhanër minor. Sipas Helenë Johansen⁸ (Helene Johansen) Letërsia për fëmijë si fushë studimi ka fituar vëmendjen si një zhanër i rëndësishëm në dekadat e fundit edhe për shkak të suksesit të madh ndërkombëtar të romaneve si ato të serisë Harry Potter, të përkthyer në shumë gjuhë.

7. Beckett, Sandra L., *Crossover Fiction: Global and Historical Perspectives*, London - New York, Routledge, 2009.

8. <http://www.journals.uio.no/osla>

zhanër (një zot ua di se mbi ç`kriterë bëhet përzgjedhja e fitueseve!!!), por asnjë projekt që të përfshijë stimulimin dhe motivimin e saj.

-Shtëpitë botuese janë skeptike ndaj letërsisë për fëmijë në gjuhën shqipe, e demonstruar kjo me minorancën e titujve në shqip të këtij zhanri, krahasuar me përkthimet.

Për analogji, kjo panoramë të kujton thënie po aq skeptike dhe nënvlerësuese të Kroces⁹ më 1974, i cili pohon cinikshëm se arti për fëmijët nuk do të jetë kurrë art i vërtetë (Croce 1974: 116)

Duke kërkuar shkaqet e këtij mosvlerësimi apo edhe vlerësimi marginal, përtej politikave dhe mendjemadhësive institucionale, gjykojmë se roli didaktik që ka luajtur kjo letërsi që nga hapat e parë të saj në terrenin shkollor shqiptar (kujtojmë poezitë didaktike të N. Frashërit, për emergjencat e shkollës së parë shqipe) dhe më vonë orientimi i saj drejt pedagogjisë, ideologjizimit dhe moralizimit përgjatë viteve të diktaturës, e kanë përjashtuar në mënyrë efektive letërsinë për fëmijë nga kanoni letrar: meqë arti i vërtetë nuk është i orientuar, letërsia për fëmijë nuk mund të jetë art i vërtetë. Ky gjykim dhe pushteti autoritar i institucioneve që e përcjellin atë në mënyrë indirekte, kanë përcaktuar prej kohësh izolimin e letërsisë për fëmijë në fushën pedagogjike dhe kanë ushqyer një paragjykim estetik mbi të cilin bazohet sot pavëmendja ose vëmendja sipërfaqësore e kritikës letrare shqiptare.

Dhe kjo shfaq konstatimin/dilemën: a kemi një sistem më vete të letërsisë për fëmijë, brenda sistemit të plotë të letërsisë shqipe?

Për këtë dilemë nuk kemi gjetur ende një përgjigje, për aq kohë sa kjo letërsi vijon të vlerësohet nga lidhja e ngushtë me rolin e saj didaktiko-moralizues dhe nga tregu.

Me synimin për të qartësuar shkaqet e këtij marginalizimi ne mund të parashtrijmë disa prej tyre (sipas gjykimit tonë):

-mungesa e politikave për ta mëkëmbur atë (asnjë projekt kombëtar, ministror apo i ardhur nga QKLL për letërsinë për fëmijë në gjuhën shqipe¹⁰);

-letërsia për fëmijë, në gjykim tradicional (dhe jo vetëm në Shqipëri) është vlerësuar e lidhur ngushtë me shkollën. Sipas Kartës¹¹, komponenti didaktik, konsiderohet në sistem një pengesë për një vlerësim të plotë të vlerës estetike (Karta 2012: 46) ndaj dhe sistemi e pozicionon në margjinat e tij;

-në anketimin e 354 prindërve të rastësishëm në disa qytete të Shqipërisë, 64.3% e tyre e rolin parësor të letërsisë për fëmijë e lidhin me shkollën dhe përgjegjësinë ia delegojnë asaj; 24.1% me familjen dhe 11.6% me arsyer të tjera;

-e trajtuar si letërsi e qëllimshme, letërsia për fëmijë përjashtohet nga partneriteti me letërsinë e vërtetë.

E përjashtuar ose në kufijtë e studimeve letrare, letërsia për fëmijë është, nga ana tjetër, thelbësore për formimin e fëmijëve dhe të të rriturve. Dëshmi e këtij vlerësimi është fakti se prej më shumë se gjysmë shekulli IBBY¹² (International Board on Books for Young people) ndihmon zhvillimin e këtij zhanri dhe motivon e financon projektet për lëvrimin e tij. Pol Hezërd¹³ (Paul Hazard), pohon se Letërsia për fëmijë mund të mos përfilllet, me kusht që të mos përfilllet as bota, në të cilën një shpirt nacional formohet dhe ruhet. Ndërsa Xhuzepë Fançuli¹⁴ (Giuseppe

9. Croce, Benedetto, *La letteratura della nuova Italia*, vol. 5, Bari, Laterza 1974.

10. I vetmi që përmendet është një konkurs i nxituar i qershorit të vitit 2018, organizuar nga e sapolindura QKLL, synimi i të cilit nuk u kuptua ndonjëherë, sepse nuk u shoqëruar kurrë me kritere mirëfilli letrare.

11. Carta, Giorgia, *The Other Half of The Story: The Interaction Between Indigenous and Translated Literature for Children in Italy*, PhD Thesis, University of Warwick, May 2012.

12. <https://www.ibby.org>

13. Cituar sipas A. Bishqem, *Hyrje në teorinë e letërsisë për fëmijë*, Sejko 2004, fq 10

14. Cituar sipas Anton Nikë Berishës, *Poezia për fëmijë e*

Fanculli) këmbëngul se Letërsia për të rinj është hyrje e domosdoshme në edukimin e përgjithshëm e të atij popullor në kuptimin demokratik të fjalës; është një instrument i formimit njerëzor; është pasqyrë dhe shprehje që një fëmijëri e caktuar të formojë shoqërinë e së nesërme. E, para së gjithash, një mjet i sigurt për arritjen e mirëkuptimit e të paqësimit të popujve.

Në kontekstet e shqipes do të përmendim pohimin e personalitetit të letërsisë për fëmijë Bedri Dedes¹⁵ i cili duke kundërshtuar mendimin e disa studiuesve që e konsideronin nënsistemin letërsinë për fëmijë, pohon se ajo që nënsistemi me fabulat e Ezopit, Fedrit dhe La Fontenit, por në shekujt XVIII-XIX, letërsia për fëmijë u kthye në një sistem të pavarur artistik, me veprat e Charl Perosë, Hans Kristian Andersenit, ëllezërve Grim dhe A.S. Pushkinit dhe kështu vazhdoi si shtet i pavarur i botës së arteve.

Ndërsa Astrit Bishqemi¹⁶ (Bishqemi 2004: 10), duke vlerësuar shprehësinë dhe komunikimin e këtij zhanri thotë se gjuha e veprës letrare për fëmijë është një nga përbërësit kryesorë që e veçon atë nga gjuha e veprës për të rritur. Dhe këtë pohim Bishqemi e zgjeron duke e argumentuar mëvetësinë dhe përparimin e këtij zhanri nëpërmjet stilit të veçantë, tematikës, etj.

E vërteta është se sot, globalizimi e ka bërë të konkureshëm letërsinë për fëmijë në llojin e saj codex, sepse duke e gjetur terren të përshtatshëm për tregun (dhe komercializmin në këtë kontekst) target-grupin e fëmijëve dhe adoleshentëve, ka prodhuar paketa konkureshë me objektiva të qarta ofensive (rishkrime të përmbledhura, përshtatje tekstuale në vidiolojëra, transliterime në zhanre të reja audiovizive, etj) të cilat, duke qenë të gjitha pjesë e atij tregu kulturor të identifikuar nga target-grupi që përcaktuam, bëjnë që libri të kthehet në një produkt kulturor ndër të shumtët dhe si fenomen margjinalizues transferohet jo vetëm letërsia për fëmijë, por krejt letërsia. Vetëm se demit të parë të letërsisë për fëmijë të shkaktuar nga sistemi, i mbivendoset edhe ky dem tjetër joletërsor, i cili e degdis akoma më në skaje letërsinë për fëmijë.

Megjithatë, do tentojmë të bashkojmë disa nga qasjet e mundshme të studiuesve që janë marrë me këtë zhanër, qasje të cilat lidhen me mënyrat sesi duhet t'i referohemi letërsisë për fëmijë. Përkrah referencës së Lesnik-Obershtein, të cituar në hyrje të këtij punimi, do vendosim Inocentini¹⁷ (Innocenti 2000: 8-9), i cili identifikon tre kuptime kryesore të letërsisë për fëmijë: letërsi edukuese; letërsi e zgjedhur dhe prodhim letrar për fëmijë. Bjelinski¹⁸ ka konsideruar letërsi të vërtetë për fëmijë vetëm atë letërsi e cila lexohet me kënaqësi jo vetëm nga fëmijët, por edhe nga njeriu i burrëruar dhe plaku.

Në kundërshtim me Zipesin¹⁹ (Zipes 2001: 40), i cili mohoi letërsinë për fëmijë dhe fëmijërinë vetë si institucion jo vetëm moshor, vlerësojmë mendimin e Morin²⁰ (Morin, 1993), sipas të cilit...letërsia për fëmijë përfshin korpusin shumëformësh të teksteve nga ku merr jetë, si dhe përfaqësimet dhe imazhet e fëmijërisë për të cilat rrëfen:

libra dhe figura që përfshijnë vajza dhe djem si lexues të vërtetë, në një marrëdhënie

ku marrin pjesë në mënyra dhe role të ndryshme figurat e rritura të përfshira në marrëdhënien edukative, afektive, autoriale, rrëfyese.

Dhe që kjo pasuri të vendoset në marrëdhënien mes vetes dhe marrësit të saj, padyshim ka nevojë për ndërjetësinë e kritikës. Duke qenë letërsi e mirëfilltë, ky zhanër ka rregullat e tij, funksionet, mes të cilëve besojmë se më i rëndësishmi është kontributi që fëmijëria të skalitet në arkitekturën e duhur imazherike, sepse përmes gjuhës librat për fëmijë i mësojnë fëmijët të jenë të tillë (fëmijë) dhe kjo të qenit i tillë nuk është gjë tjetër veçse respektimi i asaj që një kulturë e caktuar e konsideron qenësi të natyrshme të fëmijërisë²¹ (Nodelman 2002: 77).

Ashtu si fëmijët që në librari vijnë me urdhrin e posaçëm përzgjedhës të prindit, ashtu edhe mes prodhimit të librit për fëmijë dhe destinacionit të tij ka asimetri derivate. Të rriturit shkruajnë, prodhojnë dhe kontrollojnë letërsinë e destinuar për fëmijë. Pushteti i këtyre të rriturve, sikurse e dëshmon dhe indiferenca institucionale në vendin tonë, i krijon pozita inferiore letërsisë e cila në një farë mënyre ka në duart e saj vlerat e së ardhmes. Nëse kritika do të ishte aktive dhe pse jo agresive, atëherë kjo asimetri nuk do të ishte aspak problematike, sepse kritika do të përcaktonte se se cilët libra janë të mirë për fëmijët dhe, veçanërisht, të mirë në aspektin e vlerave emocionale dhe morale²² (Lesnik-Oberstein 2002: 16). Megjithatë, pothuajse gjithmonë, e mirë do të thotë e përshtatshme: përmes ideve të fëmijës duhet të strukturohen debatet mbi atë që është e përshtatshme ose jo për fëmijët/fëmijërinë.

Bibliografi

Beckett Sandra L., *Crossover Fiction: Global and Historical Perspectives*, London - New York, Routledge, 2009.

Berisha Anton, *Poezia për fëmijë* e Mark Krasniqit, Prishtinë 2002.

Bishqemi Astrit, *Hyrje në teorinë e letërsisë për fëmijë*, Sejko 2004.

Carta Giorgia, *The Other Half of The Story: The Interaction Between Indigenous and Translated Literature for Children in Italy*, PhD Thesis, University of Warwick, May 2012.

Croce Benedetto, *La letteratura della nuova Italia*, vol. 5, Bari, Laterza 1974.

Dedja Bedri, *Mesazhe nga takimi ballkanik i letërsisë për fëmijë*, Mësuesi, 22 nëntor 2000.

Edgar Morin, *Introduzione al pensiero complesso*. Milano: Splerling & Kupfer, (ribotim) 1993

Innocenti Orsetta, *La letteratura giovanile*, Bari, Laterza, 2000.

Jack Zipes *Sticks and Stones: The Troublesome Success of Children's Literature from "Slovenly Peter" to "Harry Potter"*, London - New York, Routledge, 2001.

L'immaginario politico. Impegno, resistenza, ideologia, Eds. S. Albertazzi, F. Bertoni, E. Piga, L. Raimondi, G.

Lesnik-Oberstein, Karín - Thompson, Stephen, *What is Queer Theory Doing with the Child?*, Parallax 8,1 (2002).

Nodelman, Perry, *Decoding the Images: Illustration and Picture Books, Understanding Children's Literature*, Ed. Peter Hunt, London - New York, Routledge, 2002

Tinelli Between, V.10 (2015).

Williams, Raymond, *Keywords. A Vocabulary of Culture and Society*, New York, Oxford University Press, 1976.

Zanfabro Giulia, *Chi ha paura dei libri per bambini/e? I presupposti della critica: una questione politica*, <https://www.ibisworld.com/united-kingdom/market-research-reports/childrens-book-publishing-industry/>

<https://www.statista.com/statistics/411524/children-and-youth-books-revenue-share-germany/>

<https://publishingperspectives.com/2021/07/italys-publishers-report-44-percent-unit-growth-first-half-of-2021-covid19/>

<https://www.ibby.org>

<https://www.vivoscuola.it/content/download/3932/122034/file/1%20PERCORSI%20EVOLUTIVI%20DEI%20BAMBINI%20E%20INDICATORI%20D1%20RISCHIO.pdf>

<http://www.journals.uio.no/osla>

<http://www.Betweenjournal.it/>

21 Nodelman, Perry, *"Decoding the Images: Illustration and Picture Books", Understanding Children's Literature*, Ed. Peter Hunt, London - New York, Routledge, 2002: 69-80.

22 Lesnik-Oberstein, po aty, fq 16



KARAKTERI I LEXIMIT TË LIBRAVE

Nga Xhevair Lleshi

Përfytyroj gjithmonë një njeri nevrastenik që gjatë leximit shtrëngon dhembët, skërmitet, bën gjeste padurimi, habitet, ngre vetullat, lëshon ofshama dhe psherëtima, ngërdheshet, belbëzon, qeshet dhe gati shkrihet kumbimshëm, hap sytë gati në të shqyer,... pastaj he- he nis të vërë buzën në gaz, fillon të kruhet, ta ngacmojë diçka e brendshme: duket ka harruar që po lexon një libër të «pa dëshiruar», një të atillë të cilit s' duhej t'i hidhte as sytë...

Dhe menjëherë e kapa fillin. Dukej sheshit që paskej edhe leximi i librave nervin e tij, synimin po se po, dëshirën,... duke treguar hapur se librin e lexojmë negativisht apo pozitivisht. Kjo është vija e parë e frontit, të tjerat pas tyre vijnë vetë. Ato o e prishin, ose e ndreqin librin. Domethënë o ia bëjnë çorap ëndjen, o ia ndreqin shijen. Por në çdo rast, librit të mirë gjeji çfarë të duash të mete, ai sërish mbetet i një niveli që «nuk mbulohet dielli me shoshë».

Gjatë një dreke me një mikun tim shkrimtar, po diskutonim rreth karremit të të lexuarit. Domethënë ta bësh një lexues për vete, ndryshe që libri ta marrë vetë për dore lexuesit. Sigurisht një libër i mirë e ka «karremin» me vete: ngjarja, gjuha, natyrshmëria e të shkruarit, sineriteti, dashuria, bota e brendshme e personazheve, bukuria e tyre dhe e natyrës, eleganca, sintaksa e qartë dhe brenda logjikës së gjuhës, humorit që të rrëmben si tharm i veçantë, ironia e lehtë, intriga shoqëruese, pak piper në gjuhë dhe shumë «oreks» ngacmues, uri dhe etje, ngjyrim seksual etj., etj. Dhe pas gjithë këtyre u ndalëm në «të shkruarit me një frymë të veprës» edhe kur ka një ngjarje intriguese, edhe kur ka pllaze të tëra përskrimesh. Mirëpo jo dashamirësin e leximit të një libri çfarëdo e ke aty, madje që gjallon pranë teje, e sidomos po të jetë ky shkrimtar. Sepse, sado e çuditshme të duket, një shkrimtar nuk e lexon sivëllain e tij, shkrimtarin tjetër, duke ngritur kot së koti pragje e sfrate, sikurse thuhet që «një shkrimtar nuk ka kohë të merret me të tjerët, sepse s'i del koha për të shkruar të tija!». Sigurisht që ky është idiotizëm me brirë. Puna e parë e një shkrimtari është leximi i shumë e shumë librash, shumë autorësh, poetësh, ta «ngarkojë» veten me kulturë letrare dhe artistike, duke gjetur dhe bërë të tijat kalambure, fjalë të urta, anekdota, gjë e gjëza, përralla, fabula, rrëfenja, këngë të vjetra, kureshtje, me shtylla të tilla kulture të pafundme, që e «armatosin» dhe e bëjnë të pathyeshëm. Dhe më fund e bëjnë atë të depërtojë thellë në botën e brendshme të personazhit të dashur, të njeriut që e do jetën, të fenomenit, të së veçantës, të grimcës që bëhet tornado apo tajfun dhe arrin si orteq të përfshijë çdo gjë që gjen përpara. Një mrekulli!...

Mirëpo vijmë sërish tek ideja fillestare: karakteri i leximit, pasi po i mësojmë karakterit të librave. Është e vërtetë, që së pari, karakteri i leximit varet prej të dytit, karakterit të librave. E para ti zgjedh gjininë e librit, llojin e tij, zhanrin, përputhjen e interesave të tua me ato që zotërojnë në një libër dhe dalin në pah idetë, ngjarjet, përshkrimet, figuracioni, lënda, gjuha e gjallë, sineriteti, thjeshtësia, sintaksa e përdorur, dialogët, tipizimi i personazheve

(Vijon në faqen 11)

Marathonomaku

Kur e nje poezinë e Jusufit, kur ia lexon përzgjedhjen e librave dhe autorëve që i kishte përkthyer, kopertinat e librave që i kishte dizajnuar, kur ia sheh fotografitë, kur ia dëgjon komponimet e kur ia shijon zërin, të duket se e ke takuar diku, që i keni pirë dy a tri kafe, që ia ke pëlqyer stilin e veshjes, ke dëgjuar për gratë që e kanë dashuruar, që ia ke dëgjuar heshtjen e në atë heshtje të është shfaqur simpati vajzërore.

Po të mos e kishte tragjik fatin, Jusuf Gërvalla, më 1 tetor do t'i mbushte 77 vjet. Do të kishte botuar libra e do të kishte përkthyer libra të mirë. Ai nuk i mbante vjershat vetëm për vete. Për 15 vjet krijimtari, i botoi tri libra me poezi, i shkruajti dy romane (njëri romani u tërhoq nga shtypi në "Rilindje" pas ikjes së tij në Gjermani), një dramë, botoi shumë shkrime, intervista e analiza, u krijua në artist/krijues poliedrik, shijues e plasues i arteve. Po të mos ishte fati tragjik, arti muzikor do të kishte dhjetëra këngë, hite, padyshim, muzika e tij do të krijonte shije muzikore te shqiptarët e zëri i kadifentë do të na bënte të dashuroheshim rishitas. Do të shkruheshin nga pena e tij artikuj e opinione kulturore, tekste të interesante për lexuesin shqiptar. Edhe do të na kritikonte. Jusufi nuk do ta kursente asnjërin.

Por, u këputën krahët e poetit për tu kthyer në Marathonomak, një luftëtar që nuk u harrua asnjëherë. Brezat u ndërruan, emrat u harruan, edhe mbiemrat, por letërsia mbet. Ashtu siç mbet i ri, vetëm 36 vjeçar.

Libri i shenjtë

Me këtë polifoni krijimtarie, nga perspektiva e lexuesit të ri, shtrohet pyetja: si ka mundur të ecë binarë paralel qenja intelektuale e Jusuf Gërvallës dhe ajo e njeriut të angazhuar në lëvizje nacionale. Për Jusufin, angazhimi atdhetar nuk ka qenë ideologji, ka qenë përtej saj; ka mbetur frymëzim, kreativitet, sakrificë.

Në të tre librat e tij poetik të cilat botohen në harkun kohor prej katër vitesh, secila poezi i shfaqet e frymëzuar. Edhe idilika e shtresëzuar me fëmijërinë së cilës i rikthehet herë pas herë, edhe urbanja, shquhen prajshëm me frymëzim pa të cilin duket që autori i ri, nuk mund të shkruajë. "Megjithatë, mendoj se frymëzimi është një akt i domosdoshëm, të cilit krijuesi nuk i shmangët dot", shquan Gërvalla në një intervistë për revistën "Zëri i rinisë". Pra, secili varg i tij mbet i frymëzuar, secila poezi. Njeri, autor i mbushur frymë, me frymëzim e rikthen dhe fëmijërinë, si te poezia Libri i shenjtë:

druri i vetmuar më tutje ca hithër ia djegin këmbët fëmijës që ëndëron

Mjeshtër i përzgjedhjes së fjalëve, i ndërtimit të togfjalëshave, Gërvalla, po t'i ishte përkushtuar poezisë, sot do të kishim nën emrin e tij krijimtari të bollshme e poezi edhe më të arrira. Togfjalëshat e tipit: flijim i begatshëm, tëmbli i detit, zgjim i heshtur, djep i vjetër, etj, fshehin atmosferë fëmijërie, lajtmotive të cilave u rikthehet në të tri librat. Fëmijëria, herë e nxjerrur jashtë hullinave, herë e thelluar në hullinat e saj bashkë me hithërat që ia djegin këmbët fëmijës ëndërrimtar, e risjellin në një ditë kur do ta ndiqte rrugën e dëshirave të veta, do të bëhej poet plot muzikalitet e të shkruante për fëmijërinë.

Nëna

Lojërat e fëmijërisë të ndërtuara si përralla, aso që fëmija inteligjent me emër Jusuf i dëgjonte orëve të vona në kullën e gjyshit në Dubovik, i mbetën të pashlyera në tërë krijimtarinë. E mbi to po qëndronte Nëna. Ajo grua e cila u kthye shënjesë e qëndrestarisë, ishte person i gjallë, i prekshëm, pas vrasjes së të bijëve, e dyfishoi ashtin e qëndresës e të kujtesës dhe u bë ngushllimtare e qindra nënave shqiptare që i humbën bijat e bijtë për ta luftuar armikun. Nënë Ajshe, lexuesi, më

JUSUF GËRVALLA, HYJNORI QË MBETI I RI

Nga Naime Beqiraj



parë e njohu si personazh poetik, pastaj si qëndrestari. Motivi për nënën ka mbetur më sublimi, e më i fuqishmi, personazh i dashur muzikor e poetik krijuar nga zemra e mendja e Jusufit. Nëna Ajshe u përballoi rrebesheve, ashtu siç i shkruan në një letër Jusufi së ëmës duke ia kujtuar që në fund të përrallave të fëmijërisë, mesazhi i tyre ishte i gjithmonshëm si përfundim: "Rruga e nderës asht ma e zorshme por ma e mira dhe e vetmja rrugë e vërtetë për njeriun. Dhe, kush u mundue për nder, nder ka gjetë"! Në këtë letër të bukur e plot inkurajim, nuk e ndeshim skofiaritetin e Jusufit si krijues por qëndrestarin, gati gati revolucionarin. Ndryshe nga vargjet për nënën që i ka botua te libri i dytë dhe i ka kthyer në vargje kënge tashmë të njo-

hur, në këtë letër i drejtohet: "Kur i kujtoj këto, më del se ti, në vend se të mërzitësh, duhet të gëzohesh e të përtërihesh. Ma në fund, veç tuj mos u dorëzue në këtë kohë të vështirë, ti nanë, do ta qitësh edhe hapin tand të fundit burrnor, që të bon si të gjitha ato nana trimnesha e fisnike shqiptare, të cilat, kur e ka lypë puna e vatanit, s'e kanë kursye e s'e kanë kajtë me lot jetën e djemve të tyne dhe kanë këndue kur kanë kukatë qyqet".

Shijeholli e stilisti

Edhe vokacioni poetik dhe tematik i Jusufit është kombëtar. Këto i pasuroi edhe me dijen e bollshme që kishte për poezinë botërore. Në muzikë, ndonëse një

pjesë e këngëve të tij ishin të përshtatura, tekste të këngëve të Jusufit ishin origjinale, me vargje të autorëve shqiptarë e pjesa më e madhe tekste të shkruara nga vet ai.


Jusuf Gërvalla është autor modern për kohën, modern në të kënduar, në përgatitjen e kopertinave të librave, të autorëve shqiptarë që i ka përzgjedhur për t'i përkthyer (Teki Dërvishin, Zejnullah Rrahmanin, etj.), autorët botëror që i ka shqipëruar (Xhojsi, Kafka, Zllobeci, Kishi, etj).

Jusufi fëmijë dhe Jusufi adoleshent, një pjesë të verave i kishte kaluar në Dubrovnik. Nga bisedat private me zonjën Suzana Gërvalla, Jusufi është rritur te daja i tij në Pejë. Meqenëse daja ishte martuar me kroate e çifti nuk kishte fëmijë, nipin e marrin përherë gjatë verave në Dubrovnik. Në qytetin e njohur të antikitetit, djali shijehollë e kurrështar mëson shumë hire të kulturës, qytetërimin, të modës, sjelljes, përzgjedhjes. Prandaj, në fotografitë bardh e zi të Jusufit, ne e shohim një djalë modern, të veshur me shije, duke pozuar simpatik e hedonist para aparateve fotografike, herë herë edhe me kitarë.

Me gjithë figurën atdhetare, Jusufi mbetet poet, shkronjës, artist. Duke qenë me dije të gjërë artistike, Jusufi shoqëron në vargjet e tij atmosferë muzikore, përshkrim që reflektojnë artet pamore duke krijuar vizuelisht katër dimensione.

A mjafton arti për të qenë i lirë

Jeta e tij ndalet në moshën 36 vjeçare, atëherë kur një pjesë e poetëve e fillojnë krijimtarinë, kur një pjesë e mirë e tyre arrijnë të konsolidohen si krijues pas një periudhe ta zëmë rinore. Jusuf Gërvalla e mbyll opusin krijues në këtë moshë. Duke



e sfiduar robërinë, duke qenë armiq të saj, writen edhe poetë të tjerë shqiptarë: Latif Berisha, Luigi Gurakuqi, Ymer Elshani, Jusuf Gërvalla...

Veprimtaria ta quajmë atdhetare, jetën e Jusufit e ndau në dysh. Përgjatë këtyre gati katër dekadave është shkruar aq shumë për aktin e vrasjes së Jusufit me vëllat e me shok, janë punuar dokumentarë, janë bërë këngë e intervista, akademi e komemoracione, tubime e përvjetore, janë shkruar libra: romane, novela, drama e mijëra poezi, por është botuar vetëm një herë kompleti i librave të tij. Librat e Jusufit nuk gjenden as në librari, e rrallë në biblioteka publike.

Ndërkaq, fat i madh që incizimet e tij të këngëve janë ruajtur në fonotekën e Radio Shkupit, në të kundërtën do të mbeteshim pa fondin e artë të këngëve të Jusufit që i interpretoi me përsosshmëri e sensibilitet, një pjesë të cilave, vet ishte autor i vijës muzikore dhe i teksteve. Me të ikur në Gjermani për t'i shpëtuar burgosjes, pothuaj të gjitha këngët, intervistat dhe incizimet që mbanin emrin e Jusuf Gërvallës ishin asgjësuar nga fonoteka e Radio Prishtinës. Mund të thuhet se tekstet e këngëve të Jusufit ishin poezi në vete. Djali i imtë me shpirtin plot botë artistike e kulture, ai kitaristi që shkruante poezi me tinguj sublim, nga perspektiva e sotme, zor se një të huaji, njohës të arteve do t'i shkente në mend se ai kishte milituar dhe ishte i organizuar në një grup për t'i bashkuar të gjitha për çlirimin e Kosovës dhe bashkimin e saj me Shqipërinë. Edhe një të riu të sotëm, do t'i dukej absurde që një penë e një pamje skofiare e këngëtarit të ishte i veshur së brendshmi me mantelin e një nacionalisti. Jusufi nuk linte udhë pa rrahur e shtigje pa hapur për ta bërë të lirë vendin e tij. Nuk i mjaftoi kënga, as kultura e as poezia.

Pak biografi

Jusuf Gërvalla (1945) u lind në Dubovik të Pejës. Është shquar si: poet, kritik i arteve, dramaturg, publicist, kompozitor, përkthyes, këngëtar, autor këngësh... Pas përpjekjeve të pasuksesëshme për tu burgosur nga policia serbe, bashkë me familjen emigrojnë në Gjermani ku e vazhdon veprimtarinë atdhetare. Vritet më 17 janar 1982 në një atentat të organizuar kundër tij dhe të vëllaut Bardhosh Gërvalla dhe Kadri Zeka të dy veprimtarë në emigracion të çështjes shqiptare në Untergruppenbah (Gjermani). Kanë kaluar 40 vjet dhe vrasja nuk është zbuluar ende nga drejtësia gjermane.

Jusuf Gërvalla është autor i librave me poezi: "Fluturojnë e bien" (1975), "Kanjusha e verdhë", (1978), "Shenjat e shenjata", (1979). Ka përkthyer në gjuhën shqipe autorë, si: Danillo Kish, Zllobec, Marinković, Asturias, etj.

POEZI NGA JUSUF GËRVALLA

Libri i shenjtë

Shpuzë e errët matanë qelqeve që avullojnë mesnatës së ngjyer me tëmbëlin e detit në obror po fshihej një hije dhe qerrja e drunjte kuajt sonte askund s'do të marrin udhë në mur ndrit dhe pipërrin kandili e në letër mes dy vijash të zeza si përherë druri i vetmuar më tutje ca hithër ia djegin këmbët fëmijës që ëndërron drita e pruar gjerdan me guaca hën' e verdhë atje lart në tavan – dhe teja tok me djepin e vjetër që s'përkundet – e ha nuk shihet atje rrëzë gardhi një vogëlush që shiu i tetorit e qull ngadalë në vatër u dogjën urët – s'ka mbetur më prush frika nga trupi im në shtrat po më fton mbi tryezë ora e vogël rrah e s'pushon.

qenie, varr as frymë

Një shishe hermetike grykëngushtë lëfytëgjatë në murin prej argjile në detin e ëmbël në lëkurën me pore drite në ballsam të largët egjijti një një të milionin yll në çdo kristal në çdo gur të çmuar. Bima mugullon në terrin e tokës në qullin e baltës qenie, varr as frymë sy i zbrazët nga gjithë bukuria mbeti vetëm kjo e prekshme e flakët dhe e pakuptueshme. Seç po lebetitem po më dridhet buza zëri im i djeshëm se ku u bë amshim i zbrazët si syri që më sodit me plotëninë e trilluar i ndritshëm e i thatë si mermer i zi dashuria e të çmendurit nga frika mes të gjithëfuqishëmve një gogol druri mbuluar me të tharat e vjeshtës një leckë e një enë e ndryshkur ca pulla sedefi. Në shesh i nxora gjithë rekuizitat e para-jës e syri i zbrazët në roje sodiste dhe përgjonte pamundësinë time të mundshme.

fletë testamenti

Në zgjimin tim të heshtur të më ngurosni në flijimin tim të begatshëm të verës në nisjen time në fillimin tim të ri në gjumë shekujsh me ndërime të më zgojnë le të më puthë rrezja e qartë ngazëllyese e druvarit të fjetur në rudinë myshku le të jetë gjithmonë i blertë mbi gurë emër të mos ketë e shkronja le të flasë në gjuhën e vjetër të kafshës së zezë guaca e kërminj le të vijë për dasmë mbi rrasën time le të shtrihen edhe ata si dy yje ftohtë le të bëjë dimrit e verës verë e me një pikë ujë verdhësisë së barit tim le t'i mëshirohen vërmeni atje tek do të tregojë guri për udhën deri te shtëpia ime bërë me dru e kashtë le të thyhet çdo pasqyrë që ka ballsamorus ballin tim e mërrolën e çastit plot mllaf se ja tek po zgjohet er' e re e dashurisë së tokës se jam i parrezikshëm kaq i pafuqishëm mumje përfytyrim që krahasohet me rrahun tek do të më vini përsëri ju pas le të më lënë të fle qetë si pranë stufe dimrit të madh të dashurisë sime nuk do të përpëlitem s'do të rrotullohem s'do të shplohem natën nuk do të kollitem me fjalët e mia le të më mallkojnë në rrasën time atë rrasë të zezë të ftohtë në duart që i kam prekur le të më lëshojnë rrjedhës të qetë të fatit që pret shigjet' e mërisë le të bjerë mbi dhe në shkretëtirën e moskuptimit le të fiket kurrë të mos vijë kur unë nuk i pres ata që tërë jetën i prita, të dashurit ç'po flas kështu pash zotin?

bekimi i nënës

le të pihen pemët kur të kesh ardhur sërish bari i zverdhur fare le të jetë nën çatitë e kullës le të pikoje shi le të vërë trashë cipa e tëmbilit në kusi le t'i marrë lumi urat e trerët le të thyhen në cung le të ketë një shtëpi për dru lulet e verës le t'i ketë prerë me barë kostari le të ftohet ka stinë kur veç parzma e nënës do të ngrohet.

(Vijon nga faqja 9)

të ndryshëm (krejt të ndryshëm) nga njëri-tjetri, shprehjet e tyre, veshjet, qëndrimet, mendimet, të metat, loja, skena ku zhvillohen ngjarjet etj. Pra, *sa e gjen veten lexuesi* në librin që po lexon. Kjo e vërtetë e pamohueshme ose të fut në lexim, ose të shtyn drejt paragjykimit.

Vijmë kështu në një pikë interesante: paragjykimi i librave: nga mënyra si është zgjedhur kopertina, titulli, emri i autorit, pastaj si godet me fjalinë e parë, si të shtyn padukshëm drejt leximit të mëtejshëm, elementet e përdorur, shkathhtësia e shprehjes... Por paragjykimi i të lexuarit buron nga paragjykimi i të shkruarit. Sigurisht që ka lexues me kulturë jashtëzakonisht të gjerë, ose edhe me intuitë të mrekullueshme që e kapin në ajër – edhe me nuhatje – një të shkruar me paragjykim: personazhin, përshkrimin, subjektin, gjuhën, figuracionin... Kështu ndodh që lexuesi e ndien menjëherë se me çfarë tipi ka të bëjë, me çfarë klisheje është katranosur «gjella letrare», varur nga përvoja e krijimit, ndërtimi amator, stisja e subjektit, mungesa e gjetjeve artistike etj. Për më tepër tani që si futbollit edhe letërsia kanë shumë lojtarë dhe lexuesit (shikuesit) i bie barra për ta gjetur... Ec e gjeje, të lutem! Të gjithë janë letrarë, të gjithë lexojnë. Ose, ngjan edhe me popullin: popull tregtar, të gjithë shesin dhe blejnë. Mes kësaj katrahure është libri...

Por çdo të thotë ta paragjykojë një vepër letrare? Thjesht, ta marrësh me mend, pa i hyrë fare detit 'të mundimshëm' të leximit dhe thua fjalë të mira, ose fjalë të këqija... Gjoja nuk merr dot guxim in ta lexojë! Ose për më keq, «të lexuar e ka! E di cili është! Me kaq 'filmi' mbaron, libri u lexua dhe librit iu vu vula. Prandaj dhe libri do lexuar, do ndërmarrë «ai mundim» dhe pastaj le të vihët pika mbi «i». Pale nëse duhet të bëhet diskutim' i harruar letrar! Sa i dobishëm do të ishte! Mirëpo këto quhen forma të tejkaluara! Gjëra demodë, të vjetruara! Ec e bëji po deshe. Dhe më tepër, kërko ndonjë recension, ndonjë panoramë letrare, interpretim fragmentesh, cilësi diskutimesh dhe vlerësim stilistikor. Kjo do të qe mahnitëse. Një gjë që ka për të tërhequr në një të nesërme edhe vëmendje më të kultivuar për letërsinë, artin...

Në të vërtetë në majë të gjuhës është mungesa e vlerësimit. Një kritik, ose – e thënë ndryshe – një që e mban veten kritik, e merr me zor të madh librin në dorë, ngërdheshet sapaq, mbledh supet, lëpin buzët, bëhet sa Uriah Hip, sa Njeriu që Qesh dhe ec e përmbaje atë Tip! Në vend që ta kesh mendjen te Libri, do të duhet të ruash Kritikun, se mos i plas zemra apo i bie Damllaja... Fill, pas kësaj, bëhet punë vërtetë e vështirë...

Librat! Janë bërë gjë e rënduar!... Detyrë e vështirë të gësh librin që duhet për të lexuar! Por detyrë po aq e vështirë edhe t'i përkushtohesh librit që nis për të lexuar! Populli thotë me të drejtë: hall me buaj dhe hall me qe! Por leximi ka më së pari anën e zymtë, që i zë rrugën, e prapëson, e nguc keq, e lë në mes të udhës dhe nga ana tjetër edhe kur ecën e shikon me syze të errëta,... vetëm e vetëm për të gjetur të meta, për të ngritur pragje e sfrate, sepse edhe pse duket e tmerrshme, ajo zë fill te meskiniteti, tek egoizmi, ose mendimi nistor negativ, paragjykimi. Po edhe nëse udhëhiqesh prej mendimit pozitiv në të lexuar, prapëseprapë do të hasësh pengesa të tjera. Shkollat, objekti i vetëm i sotëm i librave (pasi bibliotekat publike kanë vdekur dhe ato të universiteteve kanë ngelur në një pritje të gjatë, ende pa u tenderuar, mbase për çështje buxheti!), janë rrethuar nga miqtë e panumërt të bordit të Ministrisë së Arsimit, miq që natyrisht kanë librat nëpër lista dhe duhen lexuar pikërisht ato. Miqtë e bordit të Ministrisë për librat artistike dhe literaturën tjetër, qëllojnë që janë shumicë dërrmuese nga Elbasani (Dhe Elbasani nuk është kot këthizë e kulturës dhe e letërsisë së Shqipërisë!) dhe librat do kenë me siguri orientimin e duhur! Një çështje drithëruese! Do të na kapë shpejt malli për të gjetur librin e duhur, të vëmë pikat mbi «i» sak për librin e mirë, kritikun e saktë, orientimin e duhur letrar dhe botimin ekselent.

Aq të vështira bëhen këto, sa që po të zësh në gojë librat nëpër shkolla, më mirë të të zërë tartakuti! Frika nga molepsja? Frika prej librit? Apo thjesht se shkolla nuk lexon më! Rrethimi me *bordistë* – rojtarët se mos librat futin hundët në shkolla! – e detyron shkollën të mos kthehet në çerdhe *miqsh të librit* (mirë do të ishte edhe *minjsh të librit!*), por në një vend ku vetëm për libra të mos flitet... Ndodh edhe kështu. Më kujtohet një drejtoreshë shkolle, së cilës i ra të fikët, mu te këmbët e mia, sa i zura ngoje punën e librave, edhe pse unë kisha vajtur t'i falja një bibliotekë shkolle...

Takon jo rastësisht një kritik librash që shkruan edhe vetë romane të shkurtër dhe që fiton çmime dhe po ashtu është kryetar jurie (!) në një nga shtëpitë botuese të njohura shqiptare, që edhe ajo ndan çmime (!) dhe... ç'ndodh? «Kujtova se do më jepje ndonjë libër për të lexuar!» - thotë. «Jo, i them, por desha të kujtoj se javën tjetër e kemi lënë të diskutojmë rreth romanit tim...» Ai u drodh. Mbeti i ngrirë, madje u zverdh. «Po pse, mmm, kur ma dhe romanin? S'po më kujtohet!» «Po ne diskutuam për të...» Ai që po zverdhej isha unë tani. Djesë të ftohta! «Ç' do të thotë, kjo?»... E lashë fare. S'i fola më tej. Pak më tej po mendohesha: ia kisha dhënë apo jo librin kritikut tim? Dhe kjo më kujton Sheri Mitën, mikun tim të vjetër, që i fshihej njërit prej shkrimtarëve sarandjotë vetëm nga frika se mos i dhuronte ndonjë libër! ...I zuri halli edhe shkrimtarët që kanë dalë rrugëve dhe dhurojnë libra...

S'kanë faj shkrimtarët, të themi të drejtën. Venë në librari, libraritë s'ua pranajnë! U thonë t'i çojnë botuesit. Këta, më zi se shkrimtarët, ua plasën librat shkrimtarëve, sepse as atyre s'ua marrin librat në librari... Ç'të thuash!

Por, në të vërtetë, për librat që nuk lexohen s'ka faj askush! Edhe pse libra promovohen përditë. Të paktën kështu thonë lajmet dhe kronikat televizive... Kurse librat zgjasin kokën pas djerve, nga frika se mos i shikon njeri...

Libri që po lexoj ndërkohë:

Po lexoj librin e Rexhep Shahut "Bisedë e përfytyruar me Havzi Nelën". Ky libër ka në "themelet" e tij aktet më të fundit në kohë të nderimit të kujtimit të poetit Havzi Nela: vendosjen e bustit para shkollës që mban emrin e tij, rindërtimin e shtëpisë në Kollovoz në vitin 2018, botimin e një numri të veçantë të revistës "illz" kushtuar Havzi Nelës, Vilson Blloshmit, Genc Lekës dhe Trifon Xhagjikës, dhe të gjithë shkrimtarëve martirë, botimine e librit "Shkrimtarët për Havzi Nelën", botimi e veprës së plotë poetike, e nderuar me çmimin kombëtar të letërsisë nga Ministria e Kulturës si vëllimi më i mirë poetik në vitin 2018, pelegrinazhet e shumë shkrimtarëve në Kukës e në Kollovoz te shtëpia e Havziut, në Peshtan të Tepelenës te shtëpia e Trifonit, dhe Bërzhestë të Librazhdit te shtëpia e Vilson Blloshmit dhe Genc Lekës. Janë këto ngjarje të rëndësishme, parateksti i këtij libri që e kanë frymëzuar autorin të shkruaj një libër më së shumti në formën e dialogut me poetin e vdekur, duke iu drejtuar në vetë të dytë, formë eseistike e cila krijon një ton përsiatës, reflektues, dramatik, revoltues, dhe shumë herë elegjiak. Ky libër u në shkak që të rilexojta të gjitha librat që kam në bibliotekë për Havzi Nelën: "Fjala në litar: shkrime për Havzi Nelën" (2005) dhe librin eseistik të Petrit Palushit "Kryqëzimi i Havzi Nelës" (2008), libra - dëshmi të rrugëtimit të vështirë të Havzi Nelës për t'u bërë pjesë e ndërjegjës sonë shoqërore dhe kujtesës kolektive si hero i fjalës së lirë dhe si poet. Rexhep Shahu e ka shoqëruar librin, ndër të tjera, edhe me fotografi të shkrimtarëve që morën pjesë në sesionin përkujtimor për Havzi Nelën në Kukës në qershor 2018, A. Tufa, S. Bejko, B. Londo, P. Zogaj, B. Gjoka, P. Shllaku, B. Ahmetaj, N. Dokle, etj, si provë e nderimit më të thellë që shkrimtarët shqiptarë i bënë kolegut të tyre të varur në litar. Bardhyl Londo, ka një poezi në vëllimin "Prilli i hidhur" (Onufri 2020) të shkruar "ditën që u vendos në Kukës busti i martirit Havzi Nela" poezi e cila përmbyllet me vargjet:

*Dielli lind në Kukës me fytyrën e Havzi Nelës
trupi i tij i varur në trekëndëshin e tri maleve
kurmi i tij shtrënguar në njëjën e dy lumenjve
Një lajmës i përjetshëm midis qiellit dhe tokës.
Herë i jep tokës sinjale me këmbë
Herë mesazhe i kumton qiellit me dy duart e ngritura lart.
Mëngjesi vjen në Kukës me Havzi Nelën
ndërmjetës midis qiellit dhe tokës.
(“Mëngjesi në Kukës”, Qershor 2018).*

Të gjitha këto ngjarje kanë lënë mbresa të thella jo vetëm te autori i këtij libri ashtu si edhe te shumë poet dhe shkrimtarë të cilët kanë shkruar fatin tragjik të poetit Havzi Nela. Te "Bisedë e përfytyruar me Havzi Nelën" shqetësimi kryesor autorial është se shumë dukuri të kohës totalitare vazhdojnë edhe sot, njeriu i ri i dikurshëm thjesht vijon të njëjtën mënyrë sjelljeje në një habitat të ri, e shkuara është shndërruar në një makth të së sotshmes, sepse kemi po atë kult të udhëheqësit, po atë gatishmëri për nënshtrim, po ato vese e ligësi ndaj njërit-tjetrit.

Libri që më ka ndryshuar jetën:

Është libri "Një mijë e një netë". Leximi i këtij libri ishte përnjimend magjepsës: "Zbardhëllimi i dritës së la Sheherazaden që ta vazhdonte më tej këtë histori; por të nesërmen, në orën e zakonshme ajo e vazhdoi me këtë fjalë..." Kishite një magji të veçantë në ndërprerjen e këtij rrëfimi, mbaj mend se më mbante në ankh ideaja nëse Sheherazadja do të mundej të vazhdonte pafundësisht me rrëfimet e saj mahnitëse, dhe ajo vazhdonte, "nata e njëqindendjës, nata e njëqind e dytë... Ajo vazhdonte pafundësisht për një mijë e një net të fëmijërisë time. Sigurisht që fund të këtij rrëfimi të gjatë, jeta ime kishte ndryshuar, kisha zbuluar pushtetin e pakufishëm të imagjinatës.

Pyetësori "Librat e jetës sime"

GRANIT ZELA

Libri i fundit që më bëri të qaj?

"Lamtumirë Gabo dhe Mercedes", shkruar nga biri i Markezit



Libri që do të doja të kisha lexuar:

Do të doja të kisha lexuar romanin "Zgjidhimi i Fineganëve" të Xhojsit. Më tërheqin librat shumë të vështirë, gjatë leximit të të cilëve ti je si një somnambul që ecën me sy mbyllur dhe të duhet të orientohesh me zhurmërimat që dëgjon në pyllin e errët, të ndiesh fushën gravitacionale të tekstit, të orientohesh nga intuita që të dikton modeli i frymëmarrjes dhe fuqia e mendjes dhe kulturës letrare që ke grumbulluar ndër vite. Natyrisht, në lexime të këtij lloji, paraplëqej që të lexoj paraprakisht gjithçka që të tjerët kanë shkruar për librin. Besoj se do të vijë koha (ajo që duket se nuk mjafton kurrë) për të pasur këtë përjetim të pazakontë leximi që ta japin librat e patëdytë.

Libri që pati ndikimin më të madh në shkrimet e mia:

Është shkruar se te romani "Dodona" ka një jehonë të "E madhe është gjëma e mëkatit" e Kutelit, për sa i përket personazhit të femrës-hyjni. Në kohën e shkrimit të këtij romani, "E madhe është gjëma e mëkatit" ishte ndër ato vepra që përshkruajnë madhështinë e një dashurie, dhe e lexoja bashkë me romane si "Lolita" e Nabokovit, "Dashnori i Ledi Çetërlejt" i D.H. Laërence-it, dhe "Letra gruash time të vdekur" të Gjovalin Gjadrit. Këtë të fundit, atëherë e pata lexuar në përkthimin e Petraq Kolevicës. Kreu i parë me titull "Të parat fjalë trishtimit" fillon kështu: *E dashur! Sot, më 3 Shtator, bëhen shtatë vjet që kurse jemi martuar dhe ti nuk jeton më. Ti vdiqe, vatra jonë u shkatërrua. Ne nuk do rrimë së bashku të ngohemi pranë zjarrit, nuk do të ulemi pranë tryezës të hamë së bashku, nuk do festojmë asnjë përvjetor të dasmës sonë. Nuk do të puth më duart e tua të dashura. Me vdekjen tënde gjithçka e bukur dhe e mirë për mua vdiq.* Personazhi i romanit tim "Dodona", një shkrimtar që gjakon të shkruaj një kryevepër letrare citon Edgar Allan Poe-n të ketë thënë se "subjekti më i bukur në botë është ai për një grua të vdekur". Kur shkruaja romanin, si autor, shumë herë kam menduar se si mund "ta vrisja" kryepersonazhin tim që të kisha këtë subjekt, por nuk e vrava dot, pesonazhi nuk e

vret dot, se nuk është e tillë fabula e romanit, e cila ka jetën e vet. Shkrimtari i romanit, Lum Drini, nuk arrin ta shkruaj kryeveprën dhe i djeg librat e tij ashtu siç kisha bërë edhe unë pasi kisha botuar me vetëfinancim për disa vjet disa nga librat e mi. Libri i Gjadrit, u botua në 2018 i përkthyer nga Ardian Ndreca, me titullin "Letra gruash seme të vdekur" dhe unë e lexova me kërshtërinë e madhe nëse do të më ngjalle po ato ndjesi të dikurshme. E vërteta është se e shijova edhe më shumë për shkak të magjisë së përkthimit. Kreu i parë i librit "Të para fjalë pikëllimi" në përkthimin e Ndreçës tingëllon kështu (them "tingëllon" se përkthimi ka raste që ngjan me muzikën): *"E dashuna jeme! Sot më 3 shtator janë mbushë shtatë vjet qyshse jemi martue e ti nuk jeton ma. Ti ke vdekë e votra jonë asht shqymë, nuk kemi me zanë vend bashkë rreth saj për me u ngrohë, nuk kemi me u ulë bashkë rreth saj për me hangër, e s'kemi për me kremtue ma përvjetorin e martesës sonë. Unë s'kam me puthë ma duert tjeja të dashuna, me vdekjen tande kam bjerrë çdo gja të mirë e të bukur".* Ndoshta ky libër ka ndikuar te shkrimi i atij romani.

Libri që më ndryshoi mendjen:

Është romani "Kronikë në gur", i Kadaresë. Deri në kohën kur e lexova këtë roman, në vitin 1997, nuk kisha menduar se do të shkruaja prozë. Atëherë e shihja veten si dikush që do të shkruante vetëm poezi, por pas leximit të këtij romani, pasi e mbylla librin, pata dëshirën e madhe që unë të bëhesha, të shkruaja, të rrëfeja një histori si rrëfimtari i këtij romani. Një përjetim të tillë, një lloj magjepsje nga rrëfimtari e kam provuar edhe me romanin "Njëqind vjet vetmi" dhe "Fëmijët e mesnatës" të Selman Ruzhdië.

Libri i fundit që më bëri të qaj:

Libri "Lamtumirë Gabo dhe Mercedes" i Rodrigo Gacia-s. Ishte ai episodi ku infermierja thotë se Gabriel Garcia Marquez-it "I ka pushuar zemra", dhe sakaq, i zhytur në lexim, unë isha te ajo dhomë dhe nisa të qaja. Dhe mendoja, sa çudi, ky shkrimtar që e kam në mendje dhe në zemër, pra është një

nga njerëzit e mi të dashur, ka vdekur para shtatë vitesh dhe unë nuk kam qarë për të. Sa mirë që i biri e ka shkruar këtë rrëfim prekës që edhe unë, ndoshta si shumë lexues të tjerë të bëhemi pjesë e kësaj lamtumire.

Libri i fundit që më bëri të qesh:

"Liza në botën e çudirave", një libër me ilustrime e frymëzuar nga kryevepra e Lewis Carroll-it. Ua lexoj në darkë nganjëherë dy çunave të mi të vegjël, dhe personazhi me të cilin qeshim më shumë është ai i mbretëreshës, e cila ka një ushtri me ushtarë që janë letra bixhozi, dhe për çdo gabim që bëjnë nënshetasit e saj urdhëron: "Pritjani kokën!". Në fund, askujt nuk i pritë koka, dhe libri mbaron kur Liza zgjohet nga gjumi.

Libri që më vjen turp që s'e kam lexuar ende:

Janë librat që i kam në bibliotekë dhe nuk i kam lexuar ende për shkak të mungesës së kohës dhe vijimit të pasurimit të bibliotekës me libra të rinj. Nuk më vjen turp, por kam një lloj ankthi nëse do të gjej kohë t'i lexoj sa më shpejt të jetë e mundur. Nga ana tjetër, ndërsa lexoj, e di se do të vazhdoj të blejë të tjerë, dhe këndi i librave të pallexuar do të jetë aty, gjithmonë.

Librat që kam dhuruar:

Në fillimet e mia si krijues, kam dhuruar shumë libra të mi, me një lloj guximi të verbër se të tjerët duhet t'i lexojnë patjetër. Atëherë, si shkrimtar i ri, mendoja se mes shkrimit të një libri nga unë dhe leximit ose përkthimit të një kryevepre, unë duhej të zgjidhja shkrimin e një libri origjinal.

Libri me të cilin dua të mbahe mend:

Nuk i kam shkruar dhe botuar të gjithë librat e mi që të zgjedh njërin prej tyre. Do të doja të mbahe mend si përkthyes i kryeveprave letrare. Sivjet mbarova përkthimin e romanit "Absalom, Absalom!", libri më i ndërlikuar dhe më i vështirë që kam përkthyer nga Folkneri. Siç shkruan Kadare te "Ftesë në studio: "Uiljam Folkneri e çoi atë (letërsinë) gjer në skaj. Që të mos i futej kush në zotërim të vet, njëlljosi si pronari që ngre gardhe të pakapërcyeshme, ai krijoi një krahinë-shtet të paqenë, "Yoknapataphwa". Ishte mënyra më e mirë për të qenë krejtësisht veç. Portat e këtij shteti, lumenjtë, kryeqytetet, bankat, kufijtë, nuk i gjente dot askush. Atje lëviznin personazhet e Folknerit, pa dalë kurrë jashtë, por dhe pa u trazuar prej askujt". Romanin "Absalom, Absalom!" Folkneri e ka pajisur me hartën e perandorisë së tij letrare, të vizatuar nga ai vetë, me dorë, "Uiljam Folkner, Zotëruesi dhe Pronari i Vetëm", vend imagjinari me një popullsi prej 15.611 personash të shpërndarë në 2400 milje katrorë, i pajisur me kronologjinë e ngjarjeve, dhe me gjenealogjinë e prejardhjes së personazheve të tij ndër breza. Përkthimi është duke u redaktuar nga Bujar Hudhri dhe do të botohet nga Onufri. Është nga ato romane që e kanë të përhershëm vendin e tyre në kanonin e letërsisë botërore dhe unë kam shfrytëzuar edhe përvojën e fituar si përkthyes i Folknerit me romanet "Dritë e gushtit" dhe "Duke dhënë shpirt". Natyrisht, pas përkthimit të këtyre tri kryeveprave të Folknerit, sipërmarrja ime më e madhe në zejen e përkthimit, është përkthimi i tetralogjisë së John Updike për Herri "Lepur" Engstrëmin, "Lepur, vrapo", (1960) "Lepuri kthehet", (1971) tashmë të përkthyer si dhe "Lepuri është i pasur" (1981,) dhe "Lepuri prehet" (1990), një sage romanesh e cila ashtu si edhe romanet e Folknerit përfshihen te ai që quhet "romani i madh amerikan".

Libri që më bën të ndihem mirë.

Libri "Frymë të vdekur" i Gogolit në shqipërimin e Mitrush Kutelit. Është rast fatlum kur një vepër e madhe gjen edhe një përkthyes të denjë në një gjuhë tjetër.


Libri që mendoj se është më i nënvlerësuar:

Mendoj se shumë vepra të botuara në Kosovë dhe mërgatë kanë kaluar pa jehonë e duhur te kritika letrare dhe nuk kanë gjetur lexuesin që meritojnë.

Vëllimi "Lirikë me dhimbje" i Majlinda Ramës

BOTA ORIGJINALE E NJË POETESHE BASHKËKOHORE

Prof.dr. Klara Kodra



Majlinda Rama është një lirike e ëmbël, fine dhe e thellë. Ajo ka lëvruar me sukses disa fusha, po ajo që e shpreh më mirë individualitetin e saj krijues është poezia. Mund të themi se Majlinda është një nga përfaqësueset më të spikatura të avangardës së katërt, asaj të viteve 2000 ku modernizmi ndërthuret me posmodernizmin, ku poezia shqipe arrin më në fund një ekuilibër relativ pas "shkrirjes së akujve" të përjetuar në vitet 90-të, çlirimit nga akujt e rregullave të ngurta të "realizmit socialist".

Në thelb të poezisë së Majlindës është problematika ekzistenciale e ndërthurur me problematikën sociale. Temat e përgjeshme të dashurisë erotike dhe gjithënjëzore, problematit të së mirës dhe së keqes, vdekjes si armike të jetës dhe si ligj biologjik dialektik ndërthuren me temat e anarkisë, përmbysjes së vlerave tradicionale, po edhe rrezikut të zhdukjes së vlerave, emigracionit, pandemisë, të tëra këto të tretura në një dhimbje lirike.

Poezia e saj ndërthur hermetizmin me pashermetizmin. Vëllimet e saj më domethënëse janë "Lulet e egra" dhe "Lirikë me dhimbje" që sikur plotësojnë njëri-tjetrin, që alternojnë elitarizmin me një frymë thjeshtësie dhe qartësie e cila i vjen nga poezia popullore.

Majlinda i këndon sipas mënyrës së vet temave që marrin një ngjyrim të veçantë në krijimtarinë e poeteshave, dashurisë erotike dhe amësisë. Këto dy dashuri për të janë ambivalente, gëzim-dhimbje, pasion të furishëm, dhëshuri të butë.

Majlinda lëvront edhe lirikën e ndjenjës edhe atë të mendimit. Po edhe kur lëvront këtë lirikë të fundit ajo di të gjejë pikën e duhur të vlimit midis mendimit dhe ndjenjës, ajo nuk bie kurrë në ftohtësi dhe cerebralizëm, siç ndodh me ndonjë tjetër poet hermetik.

Nga vjershat më të realizuar të Majlindës mund të përmendim "Më pëlqen të takohemi në mëngjes", "Më pëlqen të takohemi në mbrëmje", "Vajzës së palindur", "Trëndafilat e bardhë", "Si nuk e vesh një fustan të bukur", "Rituali i puthjes".

Do të ndaleshim edhe të një vjershë me temë të pazakonshme, "Vjehrrës në agoni" ku dashuria njerëzore përshkon një dialog të veçantë me ngrohtësi e dhimbje, larg nga xhelozia, që jo rrallë dallon marrëdhëniet nuse-vjehrrë, po kur vjehrra shihet si nënë e dytë dhe dashuria për bashkëshortin nuk është barrierë, po urë midis heroinës lirike nuse dhe nënës së të shoqit e cila portretizohet në çastin e fundit të jetës, ndërsa nusja e përcjell me një buqetë vargjesh, duke e quajtur me emrin e shenjtë "nënë".

Një vjershë plot tharm jete, jetë që i kundërvihet vdekjes është "Eja të duhemi" që i këndon jo vetëm çastit në mënyrë hedonistike, po dashurisë në kuptimin e plotë të fjalës.

Ka edhe poezi me frymë të freskët popullore, të stolisura me rima dhe nganjëherë me refren si "Lulet e luftës", "Mall' e burrë", "Lojë të dashuruarish", "Sy më sy", "Prit ca, pak!", "Mos pyet kurrë", "Pikëllim i vonë", "Ndizma një qiri".

Një vjershë konçize, e qartë, e thjeshtë dhe plot tragjizëm është vjersha që i kushtohet ngatërrimit të vlerave "Çfarë të jesh në këtë vend?!"

Poemthi pa titull me katër këngë është poemthi i himnizimit të familjes si ishte dikur dhe vajtimet për shpërbërjen e saj sot që shprehet në vargjet pyetje që e mbyllin çdo këngë.

Figuracioni i poezisë së Majlindës është befasues. Vetëm nga shpirti i një gruaje, një nëne mund të buronte krahasimi për gruan që lind "me kurmin e ndarë më dysh si dy gjysma hëne" që sintetizon bukurinë dhe dhimbjen. Po metafora mbresëlënëse "diell i gjinjve", një metaforë dygjymtyrëse që shpreh bukurinë dhe zjarr pasionit?

Ka edhe metafora që pikojnë dhimbje "Këmishë e grisur kjo jeta ime", madje metafora aq të vrazhda sa të lenë pa frymë, si "deti kockë e kalbur".

Detajet s'janë të huaja për poezinë e Majlindës, ndaj janë shpesh të ashpra e tokësore, ashtu si janë edhe fine.

Në poezinë e kësaj autoreje ka një palitër të pasur ngjyrash, e kuqja, e zeza, roza, e kaltërta, grija, po ngjyra e bardhë është e parapëlqyera e Majlindës, ngjyra e dliresisë, ngjyra e borës dhe e qumështit, ngjyra që shkrin në vetvete ngjyra të tjera. Mund të kujtojmë "Trëndafilat e bardhë", "Lulet e bardha", "Trio bardhë e zi".

Poezia e Majlindës ndizet nga patosi lirik, po edhe nga patosi dramatik dhe tragjik, nganjëherë nga patosi satirik.

Në këtë poezi mund të vihet re një nënshtresë mitologjiko-biblike dhe një nënshtresë popullore. Në këtë terren mitesh dhe legjendash që vijnë nga lashtësia dhe rinovohen për të marrë formën moderne, ka çelur poezia e kësaj autoreje si një lule e egër.

SKIFTERI

Tregim nga Mehmet Elezi

Skifteri përplaste sqepin në shkrep. I dhimbe në zemër. Dhimbja ia dan-
fte frymën. Shkrepi shkrepse xixa. Pas çdo shkapetjeje të sqepit shkëmbi
shungullonte. Ai prapë e prapë.

Mbi krye një hije e vockël. Mirëmëngjes, thotë *Apus apus* - emër arti i
zogut martinet i zi. Pse e mundon veten kaq rëndë?

Skifteri i mëshoi sqepit më fort. Bjeshka bubulloi. Po e fitoj rishtazi jetën,
tha.

Zogu martinet i zi nuk kuptoi gjë. Ti po fiton vdekjen, tha. E shkallmove
fare sqepin. As një shujtë të thjeshtë nuk mund të hash më me të.

Skifteri as sytë nuk ia lëshoi.

Jetën e fitoj unë, tha zogu martinet i zi. Unë mund të endem nëpër qiell
dhjetë muaj paia. Pa cekur tokë. E lëshoj veten nëpër rrymat e ajrit. Fle,
zgjohem në ajër. Këndoj, çiftohem në ajër. Aty bëj gosti. Ndash në re insek-
tesh. Bëj orgji në një dyshek ajri të gjerë sa hapësira. Dhjetë muaj rresht e
kam tërë botën nën vete.

Një copë sqepi e shkëputur u rrokullis pjetposhtë në kersh. Martineti i zi
u dridh prej gjëmimit. U shkoq një qoshe shkëmbi? Ti, zoti skifter, ke pësuar
krizë nervore. Po sillesh si njerëzit që përplasnin kryet për mur. Që presin
damarët.

Nuk guxoi me e shqiptue. Skifteri ia bleu mendjen. Sa jeton ti?, i tha. Zogu
martinet i zi u përpëliti. Unë e rrumbullakoj shekullin, tha skifteri. Duke filluar
jetën për së dyti. Me vuajtje mbinjerëzore.

Zogu martinet i zi prapë s'kuptoi gjë.

Në mes të jetës ndiej se po më erohet vdekja, tha skifteri. Afrohet, më
sillet rrotull. Sqepi im, dikur kosë, nis me u lodhë. Përkulet, kthehet krrut.
Nuk çan dot më një pre. Thonjtë e bjerrin fuqinë. Nuk janë më shqyes, të pa-
thyeshëm si dikur. Nuk mbërthejnë dot një zog pule, le më një rrunxak. Edhe
pendët plogështohen. Më ngjiten mbas trupit, bëhen plumb të rënda. Nëpër
vite janë mbushur me rrëshirë, ajo ngjit si zamkë. Nuk i hap dot krahët, qiel-
lin tim e shoh veç në ëndërr. Mezi i jap trupit me u kapë majë një pishe.

Është apo nuk është skifter ky?, përbluan martineti i zi. Kushedi çka po
më zbifet.

Nuk dorëzohem, tha skifteri. I them vdekjes: vdis ti!

Dhe zgjohem me yllin e dritës. Marr turr e fluturoj në thepin më të lartë.
Këtu, ku e ndërtoj çerdhen. Frymoj thellë e i mëshoj sqepit në shkëmb me
tërë fuqinë e shpirtit. Një javë të tërë, pa pushim. Qokthi im thërmohet, thy-
het copë e grimë. Gjaku kullon përrua rrasës teposhtë.

Rri, pres me durim. Sa të rritet prapë. Sqep i ri, i fortë.

Dhe zgjohem me rrezen e parë të diellit, që ndez detet tej. Me sqepin e ri
e të fortë u turrem kthetrave. Deri në mish të gjallë i shkul. I flak në greminë.

Rri, pres me durim. Sa të rriten prapë. Të reja, të forta.

Dhe zgjohem me ftohtimën e agut ngjyrë lirëze. Puplat mpiksuar i shnduk
me sqep riosh. I zhbij një nga një. Me lapra lëkure i shkul. Era i rrëmben, i
zatet hejseku.

Rri, pres me durim. Sa të rriten prapë. Të reja, të lehta.

Pesë muaj torturë. Pesë muaj vetëflijuar, as i gjallë, as jetëndërruar.
Dhimbja më tret, palca thellë më ther. Njëqind e pesëdhjetë ditë skëterrë.
Përtej këso jete.

Dhe lej për së dyti. Vogëlush i ngratë, këto më bëjnë skifter.

Ti treqind ditë lundron krahëlëshuar nëpër qiell. Rrjedhat e ajrit të kanë
lodër nëpër duar. Unë i çaj rrymat ajrore. Shigjetë shkoj kundër tyre, me
fishkëllimë e flakë.

Flakëron sqep i skifterit, vetëtin si shpatë.

Kthetrat shpojne shkëmbin si rrënjë të prushta pishe.

Fërfëllojnë puplat pyll, gufojnë e marrin zjarr, re ndezur prej diellit.

Merr hov e i sulet qiellit.

I ziu martinet zverdhët. Cijat një herë e zëri krejt i shterret.

Mos u tut! Veç një pendël me ta prekë unë ty te çerdhja ime, nuk më
thonë më skifter!



NJË GRUA NGA VENDI IM

një grua nxjerr plehrat në continental avenue
me tuta të kuqe, me krela të verdha gjer mbi gjinj
dhe fshin
pastaj futet në shtëpi, pasi më ka hedhur një
vështrim
dhe unë një vështrim i kam hedhur si rastësisht
kjo është një lagje private milionerësh
me vila antike si në filma
dhe unë te ajo grua shoh një kontradiktë, që më le pa
mend
si nxjerr plehrat një avokate, apo një bankiere,
dhe fshin?
kaloj prap andej një ndajnatherë dhe si me ndrojtje
bëlbëzoi; mirëmbërëma!
për çudi ma kthen; mirëmbërëma! me një zë kaq të
ëmbël sa unë marr guximin dhe e pyes;
mos jeni irlandeze? ajo qesh. jo, thotë, jam shqiptare.
dhe ma kthen shqip: po ju, zotëri?
shqiptar dhe unë, po s'më besohet..
ajo qesh përsëri. prindërit nga përmeti, unë lindur
këtu, im shoq nga betlehemi, vendi ku lindi krishti,
po ai s'është krisht. dhe qesh sérish.
unë jam mjeke, ai bankier. po ju pse çuditëni kështu?
jo, jo, aspak! tani po mahnitëmi! ju nxirrni plehrat,
fshini. kjo më çudit
sa herë kaloj këtej shoh vetëm shërbëtorka të zeza që
i bëjnë këto punë..
ajo qesh përsëri; e kam zakon nga ime më të bëj çdo
punë, im shoq s'mban shërbëtorka, kursen...
është aq e dashur ajo grua sa unë e kam të pamundur
të mos kaloj andej
kur ajo nxjerr plehrat dhe fshin..
a mund të them diçka? e pyes
po unë, a mund të them diçka? ma kthen
i shoqi është larg në një shtet tjetër
ajo vetminë e vuan si një krisht
ndoshta si një krisht mund ta ketë dhe dashurinë
pak minuta janë ato, po unë kthehem i lumtur në
shtëpi
nuk di si kthehet ajo
një grua kam njohur
një grua nga vendi im
dhe gjaku nuk di ç'ka, ndoshta ka njohur gjakun e tij
dhe mishi mishin e tij
dhe ndjenja bëhet fir
në një dalli ndizet dhe shuhet dhe s'ndodh asgjë,
veç çdo gjë përsëritet në një delir..
ajo ka lindur këtu
unë kam ardhur këtu
po kemi një ndryshim; ajo rron në një rrugë private
të Amerikës
dhe unë në një apartament të varfër
veç na bashkon një gjuhë magjike, një shqipe e
çuditshme
që nostalgjinë e kthen në dashuri.
dhe ashtu takohemi kur ajo nxjerr plehrat dhe fshin
gjuha amerikane zbret, ne ngjitemi
në ca shkrepë e qytete të vegjël ballkanik
ku ajo takon prindërit përpara se të lindëte
këtë magji e bën gjuha shqipe
ajo bashkon një rrugë private milionerësh me një
apartament të varfër poeti
ajo di të shpikë një puthje
një flirt
rroftë gjuha shqipe!

VARKË PREJ LETRE

vështroj gishtërinjtë e tu të tharë, plot damarë që
dridhen ngapak me një nervozizëm të çuditshëm
i prishi soda, paraja që s'doli, po u numërua me
mijëra herë se mos pillte diçka më tepër
ç'nuk fshive dhe lave me ato gishtërinj

Kredo e çmendur

Cikël poetik nga Roland Gjoza



ku rri unazë e liruar
me diamantin e krisur që ka zënë cipë dhe më
vështron vëngër
ka diçka të heshtur që më trishton dhe më bën fajtor
as thonjtë nuk i lyhen më aq shpesh, se nuk shkojmë
gjëkund
u harrua kinemaja, teatri, opera, u harrua dhe vetë
harresa e gjërave më të bukura
nuk e di si ndodhi kjo dhe bëjmë sikur nuk e vëmë re
flasim për gjëra të tjera po atë e fshehim
pëllëmbët e tua kanë zënë kallo
ato pëllëmbë të buta që mbanin lilakët blu dhe çdo
mollëzë i puthte
më trembin damarët jeshil që të kanë kërcyer sikur
duan të më zënë për gryke
unë i kam fajet
se rashë i pari në detin e vanitetit me një varkë prej
letre të mbushur me vjersha
dhe shkruaj e shkruaj pa mbarim të tjera duke
përsëritur veten
kaq herë i thashë rolandit të sëmurë; mos, lere me
kaq, grisi
po ishte një fuqi e huaj djallëzore a hyjnore që ma
shtynte atë varke në një det shtrëngate prej boje
isha nisur si odiseu dhe tani po kthehem për të parë
gishtërinjtë e tu dhe për të vrarë veten
por s'po më lenë ato gishtërinj si shpirt
që më kërkojnë diçka pafajësisht të humbur
unë s'kam ç'të jap kaq vonë dhe për këtë arsye duhet
ta gris atë varkë prej letre dhe të dal prej detit blu të
shkrimit
çuditërisht kaq të mjafton
dhe nuk e fsheh një pikë lot
kur të puth

po vetë më nis sérish në detin blu

PASQYRA

një krisje në pasqyrë, një krisje që s'bie në sy
e shoh vetëm unë
ia ndieva kërcitjen, po nuk bëra zë
me një drithmë në zemër
as vetë s'e besova

poetët prej ndjeshmërisë trillojnë shumë gjëra
nuk shihem aq shpesh në pasqyrë, as ti, e dashur
dhe e vogla që mban në çantë krisi, ia ndieva dhe asaj
kërcitjen
nuk iu vije rëndësi rrudhave
as damarëve,
as blanave mavi nën sy
po e harronim rininë
një instrument delikat ishte zhdukur nga shpirtrat
tanë
prej mallit pasqyrat e kishin atë krisje
ne prej rutinës së përditshme
prej kohësh kishim hyrë në planetin e harresës
që s'ishte në tokë
po në qiellin me yje
dhe yjet kriseshin
bënim sikur nuk e vinim re
bënim sikur nuk e ndienim se dhe kujtimet
kriseshin
ishim kthyer në qelqnajë
thërrmimin
prisnim!

DUHET TË MËSOHESH, E DASHUR, TË RRISH ZGJUAR

ti fle
je shkëputur nga bota dhe nga unë
në qytetin e nju jorkut që s'fle kurrë
bota çuditërisht ka rënë perdhë e vdekur
s'ka lexues që shfletojnë libra
dhe shpikjet e mëdha
s'po shpiken
krijoi rrudha seventh avenue në times square
u thinj menjëherë empire state building
prej teje
prej gjumit tënd shkatërrimtar

zgjohu
të flesh në nju jork është kriminale

duhet të mësohesh, e dashur, të rrish zgjuar
ose të kthehemi mbrapsht
në vendin tonë që fle

DHE SHPIKJET NUK E PËRSOSËN NJERIUN

dhe shpikjet nuk e përsosën njeriun
veçse e bënë më të lirë
më të lirë se ç'duhej dhe ai kishte më shumë forcën e demonit
se sa të krishtit të martirizuar. ecja nëpër vitet e mi dhe
nuk ngjitesha kurrkund, veçse zbrisja për atje ku ishte fundi.
ëndrra dëgjoja, ëndrra që i këndonte turma me pohe e bujë
dhe unë si bisht pas saj mundohesha të kuptoja, po isha i pafuqishëm përballë instinktit triumfues.
dhe nuk mund të shqiptoja se ishim në një cirkuid ku gjërat ishin përsëritur me kohë, po ne shikonim festën, jo ferrin.
na gënjen, na mashtruan, na korruptuan fund e majë, po ne iu besuam!
unë kurrë s'u bëra pjesë e turmës që e para ra në provën e zjarrit, sepse shikoja thelbin si nxinte pas fasadës plot shkëlqim të festës bakunale dhe derdreshin gotat me eleksirin hyjnor të fitores, që ishte humbja më e madhe. veçse humbnim gjithmonë duke festuar triumfet!
eci poshtë, po për lart kam marrë. kur do të vijë ai çast i bardhë që të shoh qiellin si hapet? po ai hapet veç në ditirambet!
eci dhe e di tashmë se cirkuidi po më përcjell me një salut ala european që shkëlqen fushqetash shkrepimtare!
kur do të mbërrij? po ku? eci me një vetëpërmbytje përvoje të hidhur që s'u shndërrua dot në qëllim të mbaruar.
i papërkryer, përgjysmë njeri që e di mirëfilli se fundi po vjen për mua, por jo për njeriun.
Qoftë i tërë njeriu, por ky është iluzion, që e shijon rinia, ndonëse pleqërinë e mjeron.
cirkuidi ecën në të njëjtën udhë bashkë me mua, ia hipi sipër si një kali gërdallë dhe shkoj drejt fundit tim si në epin klasik, hem kafshë, hem njeri!

I NGJALLA SË VDEKURI NËNËN DHE BABAIN

i ngjalla së vdekuri nënën dhe babain në varrezën e sharrës
ku kishin vite të dy në një varr
i solla në amerikë
vizitën e parë e bëmë në distriktin e modës iu tregova vendin ku kisha punuar 11 vjet nëna tha të ktheheshim,
nuk e ngrinte dot kokën lart
i merreshin mendt nga rrokaqiejt babai shikonte për herë të parë amerikën dhe i dukej shumë e madhe
këtu humbet si gjilpëra në kashtë
bëre gabim, bir, që e le tiranën
për dhjetë minuta shkoje në qendër
për pesë minuta mbaroje pazaret, shtoi nëna.
nuk dolën më,
kërkuan mjekun
kthejini nga kanë ardhur, tha ai, kanë nevojë të flasin i përcolla nënën dhe babain
në sharrë zbritën shkallët dhe humbën poshtë në abys
të kapur për dore
nuk donin prap të ngjiteshin lart ku ndodhej Amerika
prej fundesh vinin zëra
dhe kori këndonte
de profundis

AUTOPSI

Tregim nga ARNAUD CATHRINE

Përktheu nga frëngjishtja
Aristidh Shqevi



Ora është dhjetë. Dielli vezullues depërton përmes perdeve të bardha dhe shndrit mbi shpatullat e tij të përvëlura. Ti po plas nga vapa, ashtu si edhe unë, megjithatë dukesh i qetë. Ke një fytyrë feminare, e cila nuk pret asgjë; këtë kam parë gjithmonë në fytyrën tënde të përgjumur, qetësinë, e cila i shkon shumë flokut tënd që shkëlqen si dyllë, e që ti e lan sa herë që ndodhesh nën dush; flokun e drejton menjëherë, me nge, e trajton atë me krem, dhe kur, pa mendoje pak, tani që mosha thujse po të kalon. I dashur, asgjë nuk ndryshon tek ty.

Vështroj me ngulm shpatullat e tua që ngrihen lart në mënyrë të papërkapshme.

Si çdo mbrëmje, gjumi më ka marrë me njëren këmbë të vendosur midis gjunjëve të tu; sa të buta që janë qimet e tua të verdha mbi lëkurën time! Gjithsesi, si çdo mbrëmje, momentin kur më braktise nuk arrita ta ndiej, më dëbove – gjumi tashmë më merr menjëherë, sepse harroj paraprakisht se në shtratin e madh do të qëndrojmë shumë larg njëri-tjetrit; harroj gjithashtu se do të kërcasësh e ikësh, ndërkohë që unë fle dhe ta lejoj që të ikësh teksa vetë rri e zhytur në vetminë time të lumtur, ku nuk kam të drejtë të të urdhëroj.

Ora është dhjetë. Sytë i kam të zgurdulluar. Parakrahu im prek shpinën tënde, dhe për një moment mendova se ky kontakt nuk ishte gjë tjetër veçse një ëndërr. Shtrij dorën në drejtim të zverkut tënd, dhe e di mirë se flokët e tu do të më refuzojnë si të ishin tela me gjemba. Mëngjesi i sotëm do të jetë si gjithë të tjerët. Nuk ka asnjë arsye të veçantë që të poshtërohesh në këtë betejë të kotë – dora ime vazhdon të zgjatet përpara, por pastaj tërhiqet, sepse ti nuk më përket më; një urdhër i prerë nuk lejon që pasioni yt të vijë tek unë, nga ty tek unë, sepse atë ti e ke humbur, dhe është një humbje kjo që unë shtirem sikur e injoroj, për të të pasur akoma timin, ngaqë preferoj më shumë këtë se sa hiçin.

Sidoqoftë, sot nuk mundem ta ndal këtë avancim vetëvrasës. Dora ime pushon në zverkun tënd. Pikësëpari, ti as që e vë re atë. Pastaj ajo të zgjon. Ti sillesh sikur të mos ketë ndodhur asgjë. Unë do të zhgënjehem çdo mëngjes, dhe nga ty nuk do të marr kurrëgjë. Preferoj më mirë që të kem nga larg, sesa të mos jesh më i imi: ky është për mua një dorëzim pa kushte.

Dora ndjek linjën e shpinës tënde. Çarçafin e ke rrudhosur me këmbët. Vështroj pjesën e prapme të trupit tënd. Ah sikur të mund të hidhesha mbi të, por këtë nuk jam në gjendje ta bëj.

- Anna...

Zëri yt është shformuar nga protesta e përgjymtë. Gjithsesi, Anna bën sikur nuk të kupton, dora ime vazhdon të avancojë përmes kofshëve të tua teksa ti vazhdon të rrish shtrirë përmbys. Megjithatë, diçka më thotë që gojën të mos e vendos aty (një truk mbijetese, një dëshmi, nuk mundem që ta poshtërojë veten më shumë se kaq, nuk mundem të vij pranë teje si një vjedhacake kur zëri yt i ngjirur më shpërfill me ligësi). Gjumashi im, që aq shumë të pëlqen të flesh, e di çfarë: do të doja ta dalloja erën e të pasmeve të tua pas një numri të madh orësh të kaluara pa ty, deri në atë pikë të dua, o horr i vogël.

Ti i hapë sytë. Unë të shikoj me ngulm me shpresën absurde se shikimi im do të na shpëtojë të dyve nga mospërfillja jote barbare.

Dora ime lëviz sërish në drejtim të shpinës tënde.

- Anna...

Toni i zërit tënd tashmë nuk është më kërkues, ai është i pamëshirshëm. Fare papritur vijon një heshtje e tmerrshme. Dora ime ndalet në mes të kësaj heshtje, godina e stërmunduar e dashurisë sonë.

Ti i mbyll sytë sërish.

Dora ime qëndron në lartësinë e kockës së supeve të tua. E palëvizshme. Para së gjithash, kam një dhimbje të beftë që nuk e di se nga më vjen. Ndihem e shastisur, megjithatë e di se trupi im nuk pranon që unë ta keqtrajtoj në këtë mënyrë, dhe se atë e lëndoj sa herë që prek lëkurën tënde.

Jam kureshtarë ta di se çfarë bën ti aty, dhe për këtë e pyes veten çdo ditë, por ama nuk flas; kjo gjendje mund të vazhdojë kështu gjithë jetën, dhe ndoshta do të vazhdojë gjithë jetën, ndaj dhe herëherës unë e kam një pritshmëri të tillë. Njeriu im, jepma mua këtë lëkurë hidhërimi, e cila na merr jetën të dyve, vdekjen tonë të cilën unë e mbaj në jetë, në distancë, teksa mbaj gjallë frymën e saj që po jep shpirt.

Dora ime provon ngrohtësi mbi shpinën tënde, njësoj sikur ajo të ishte një pllakë elektrike, dhe aty e lë.

Unë kurrë nuk kam njohur një verë më të nxehtë se kjo.

VAJZA ME BIÇKLETË

Eca buzë detit në rrugën e shkretë
ku përditë kalonte vajza me biçkletë

I gjeta frutat që kishin rënë prej shportës
byzylykun e hequr nga kyçi i dorës

I gjeta zilen e biçkletës, shallin e saj
rrotën, timonin dhe pedalen në një skaj

Gjeta edhe rripin e mesit dhe një gur
si një pikë loti e ngrirë qyshkur

I mbloodha ato sende të hedhura dosido
dhe thosha me vete : vallë ku ishte ajo ?

Një ditë tjetër e pashë të hipur në biçkletë
pa e çikur ujin, po kalonte nëpër det

Pastaj unë pashë kur ra nata në varreza
sesi u ndezën në qiell dritat e saj bukureza.

**KËNGË HEROIKE DHE ELEGJIAKE
PËR NËNTOGERIN E RËNË NË SHQIPËRI***
(fragment)**IV**

Tashti, ai dergjet i shtrirë mbi kapotën e përcëlluar,
Me një puhi të ngecur në flokët e shtruar,
Me një bisk harrese mbi veshin e majtë;
Ai i ngjan kopshtit nga ku befas ikën zogjtë,
I ngjan këngës që e detyruan të heshtë natën,
I ngjan sahatit të engjëllit që mbeti,
Kur qerpikët e tij thanë:“Tungjatjeta, djema!”
Dhe heshtja u marmaros...
Ai dergjet i shtrirë mbi kapotën e përcëlluar...
Shekuj të zinj, të mbledhur rreth tij
Me kokalla qensh ulërijnë kundër heshtjes mizore
Dhe orët e shndërruara në pëllumba guri
Dëgjojnë me vëmendje;
Por e qeshura u dogj, por toka u bë shurdhe,
Por askush nuk e dëgjoji klithmën e fundit:
Tërë bota u zbraz me klithmën e fundit.

Erzë pesë dëllinjave,
Pa qirinjtë të tjerë,
Ai dergjet mbi kapotën e përcëlluar...
Helmata është e zbrazët, gjaku i përzier me baltën,
Krahu është gjysmë i mbledhur
Dhe në mes të vetullave, ai ka
Një pus të vogël mizor ku vuri gishtin fati,
Një pus mizor, në ngjyrë të kuqe të errët
Një pus ku kallkanoset kujtesa...

*I vrarë gjatë Luftës italo-greke, më 1940-1941

HIMN ME DY PËRMASA

Tashti unë të dua me dy përmasa

si një figurë etruske
si një ravijëzim i Klee-së që sos në trajtë peshku
ti bën përpara muzikë dodekafonike
acaruese
e rrufeshme
e bukur
me një dallgë Karaibesh në palën e fustanit
dhe me perla të mëdha kaltërie të rrugës Pandrosée
rreth qafës sate.

Prani e ylbër të idhull
i mbrujtur në dritën
e një ylli të zhdukur
para shumë shekujsh.
Atëherë unë pres vërshimin e ujërave dhe kam frikë
nga ti.
Ndonëse ti mund të mos jesh e vetëdijshme
(asnjëherë Timonieri nuk e di se ç'mision ka)

ODYSEAS ELYTIS

Çmimi Nobel për Letërsi më 1979

**KËNGË HEROIKE DHE ELEGJIAKE
PËR NËNTOGERIN E RËNË NË
SHQIPËRI**

Përktheu Anton PAPLEKA

nën zbehtësinë e tualetit tënd
unë zbuloj rrugën e pabesueshme që kam bërë
për të t'i thënë këto fjalë

Udhë Qumështi, o motër e ndritshme

O Zot, i vetmi fat, të cilin nuk e desha
Qe të m'i zbukuronin supet me spik.

NJË POEMË DHURATË PREJ ARGJENDI

Unë e di se të gjitha këto janë gjepura dhe se gjuha që
përpiqem të flas
Nuk ka alfabet

Meqenëse dielli dhe dallgët janë njëfarë shkrimi
rrokjesor
që njeriu di ta zbërthejë veç në kohën e hidhërimit
e të ekzilit

Dhe atdheu është një afreskë e bërë prej shtresash të
njëpasnjëshme
frënge a sllave dhe nëse një ditë
ti do të doje t'i restauroje, do të të çonin
fill e në burg dhe atëherë do të jepje llogari

Para një morie Pushtetesh të huaja që gjithnjë të
prishin punë

Ashtu si atëherë kur kanë ndodhur mynxyra

Por përpiqu të imagjinosh sikur në truallin e rrahur
me këmbë
të ditëve të qëmotshme, i cili mund të jetë edhe
trualli
i një ndërtese të madhe për fëmijët që luajnë dhe kur
ai që humbet

Sipas rregullave duhet të flasë me të tjerët
dhe t'ua thotë të vërtetën

atëherë secili do të qëndronte aty
duke mbajtur në dorën e tij të vogël
Një poemë dhuratë prej argjendi

E SHTUNE II

Unë dola të kërkoja plagë të reja
Që rrinë si zambakë mbi plagët e vjetra
Në këtë det të zanafillës që e kam njohur aq mirë
Tashti bota është fundosur
me dy pajorët e saj të pjerrët që dalin mbi ujë
dhe unë, sikur kjo të ishte e vërtetë, vazhdoj të
shkruaj.

E DIEL I MAJ

Unë e kap pranverën me kujdes dhe e hap:

Më pushton të tërin një zjarrmi merimange
një e kaltër që kundërmon firomë fluturë
tërë yjesitë e luleshqerrës por edhe
një mori krijesash rrëshqanore e fluturake

kandrra, gjarpërinj, hardhje, vemje
dhe përbindështa të tjerë të larmë me antenat si tel
me leskra prej fletëzash ari dhe me temina të kuqe

thua se gjithë këto krijesa janë gati për t'u nisur
për në ballon me maska që jepet në Ferr.

IKONA

Nëpër errësirë ecin
Shkëmbinj që adhurojnë dallgët. Badra dhe narcisë
Që rriten në ëndërrimet e të vdekurve
Shoqërojnë retë dhe gjumin

Unë eci përpara me hamendje pa e ditur ç'ditë është

Ajo ka diçka nga fisnikëria e një druri të moçëm
Ose të një kafshe të keqtrajtuar. Sigurisht
Pikërisht këtu m'u desh të rroja; kaq shpejt
Saqë zbardh drita dhe unë takoj sërish
Mundime të shenjta, shtëpi të braktisura ngjyrë okër
midis limonëve
Harqe kubera ku kam ecur ujëra të rrjedhshme
Ku ka vënë gishtin engjëlli. Çfarë ka mbetur?
Kush është tashti?

Gjysmë i shuar unë vij nga qyteti
Siç vjen nga kisha e djegur ikona
Me njollat e kuqe të zjarrit me njollat e zeza të
demonit
Që treten ca nga ca në vesën e mëngjesit
E ciflosur, e gërvishtur fjala TË DUA që shihet ende
Ja muri! Edhe parmaku i shkallëve prej druri
I lëmuar nga rrëshqitja e kaq duarve!

I ngarkuar me pleqëri dhe me rini unë i ngjit prapë
shkallët
Duke e ditur ku do të kërcasin dërrasat e vjetra
Dhe kur do të m'i ngulë sytë teto Melisini nga korniza
e saj
Dhe a do të bjerë shi nesër

Pa dyshim unë kërkoj një gjë që gjithmonë ka qenë
imja
Dhe ndoshta thjesht kërkoj një vend tek Ai që vjen
Çka është e njëjta gjë; veshje e sajuar me zjarr të
ftohtë
E gjelbra e bronzit, e kuqja ngjyrë qershie e
Virgjëreshës

Në këmbë me dorën e djathtë mbi zemër
Prapa meje janë dy ose tre shandanë
Katrori i vogël i dritares nga ku duken rrebeshi
Viset e largëta dhe Ardhmëria.

SHTATË NOKTURNE SHTATËVARGËSHE

I

Erdhën ëndrra dhe prapë ëndrra
Për ditëlindjen e jaseminëve
Erdhën net dhe prapë net
Në pagjumësitë e bardha të mjellmave.

Në gjethe lind vesa
Siç lind në qiellin e pafundmë
Ndjesia e yjezuar.

II

Ndriçimi i volitshëm i yjve solli heshtjen
Dhe prapa heshtjes një melodi që futet kudo
E dashura
E tingujve të dikurshëm, joshësja.

Tashti kanë mbetur hija që vdaret
Dhe besimi i saj i krisur
Dhe lëbyrjet e saj të pashërueshme.

III

Tërë këta qiparisa thonë se është mesnatë
Tërë gishtat thonë
Se duhet të heshtësh

Jashtë nëpër dritaren e hapur të ëndrrës
Shtillet tejet ngadalë
Pohimi
Që ecën kërthazi drejt yjeve si një imazh.

IV

Një sup krejt i zhveshur
Si të qe një sup i vërtetë
Me bardhësinë e tij
Mat fundin e skajshëm të mbrëmjes
Që ndrit fillikat
Nën gjysmëhënën e fshehtë
Të nostalgjisë sime.

V

Natën që nuk e ruan askush, e pushtuan kujtime
Të kaltra
Të kuqe
Të verdha

U mbushën me gjumë krahët e saj të hapur
Flokët nuk ia rreh më era
Sytë e saj janë prej heshtjeje

VI

Natë e pahulumtueshme, hidhërim pa cak
Qepallë që rri zgjuar prore
Dhimbja digjet para se të gjejë një dënesë
Zia zhduket para se t'i vihet sinori.

Përgjim që mbaron shpejt
Ndërsa mendimi përmes meandrash të kota
Sapo u përplas te platforma e fatit të vet.

VII

Në ballin e natës ndrit diadema e hënës
Kur hijet ndajnë midis tyre
Sipërfaqen e vizionit

Kur dhimbjen e mat një vesh i rysur
Bie poshtë detyrimi



Te mendimi që e bën të kotë
Ndalimqarkullimi melakolik.

EROTAS

I

Eros
arkipelagu
dhe bashi prej shkume
dhe pulëbardhat e ëndrrave të tyre
I ngjitur në pajorin më të lartë
detari përhap në erë një këngë
Eros
kënga e tij
dhe horizontet e udhëtimeve të tij
dhe jehona e nostalgjisë së tij
në shkëmbin e rrahur më shumë nga dallgët
e fejuara
pret një anije
Eros
Anija e saj
dhe limontia e erës së saj verore
dhe vela trikëndëshe e shpresës së saj
mbi valëzimin më të lehtë përkundet një ishull
kthimi.

II

Ujërat lojcake
lundrimet e hijezuara
flasin për agimin me puthjet e tij
që fillon
në horizont
Dhe pëllumbi i egër
e bën një tingull të drithtohet në shpellën e tij
zgjim i kaltër në pusin
e ditës
dielli-
era e veriperëndimit ia jep pëlhurën
detit
ledhatime floknaje
për ëndrrat e tij moskokëçarëse

vesë-
dallgë në dritën
që i rilind prapë sytë
Atje ku jeta lundron drejt detit të hapur
Jeta
e parë prej së largu

III

Deti i bën pyetjet e tij të shkasin mbi rërën e
përkëdhelur-

-Eros

Pulëbardha i jep horizontit
Lirinë e saj të kaltër
Vijnë dallgë shkumëzuese
Duke pyetur pareshtur në veshin e guaskave
Kush e mori vajzën flokëverdhë e të nxirë nga dielli?
puhia e detit me frymën e saj të tejdukshme
e përkul velin e ëndrrës
Tejet larg
Erosi murmurit pentimin e tij - Det që shket.

MONOGRAM

(fragment)

III

Në të vërtetë unë flas për ty dhe për veten

Meqenëse të dua dhe te dashuria di të hyj
Nga të gjitha anët ashtu si Hëna e Plotë
T'ia shkund petalet jaseminit në çarçafët e pamasë
Për këmbën tënde të vogël dhe madje këtë aftësi e
kam
Kur ti je në gjumë, të fryj aq fort sa të të marr me vete
Përmes labirinteve pa hënë dhe portikëve të fshehtë
të detit
Përmes pemëve të hipnotizuara që i argjendojnë fijet
e merimangës
Dallgët kanë dëgjuar të flitet për ty
Për ledhatimet e tua, për puthjet e tua
Për mënyrën sesi ti murmurit « çfarë? » dhe « eh... »
Rreth gushës sate, rreth golfit tënd
Gjithmonë jemi ne drita dhe hija

Gjithmonë ti je ylli i vogël dhe unë gjithmonë jam
anija e errët
Gjithmonë ti je porti dhe unë jam fanari i volitshëm
Moli i lagur dhe vetëtimja që rrëshqet mbi rema
Atje lart te shtëpia me kulpra
Me radhë trëndafilash, me valën që të freskon
Gjithmonë ti je statuja prej mermeri dhe gjithmonë
Unë jam hija që zmadhohet
Ti je kanati i shtyrë, unë jam era që e hap

Meqenëse të dua dhe të dua
Gjithmonë ti je monedha e ndritshme dhe unë jam
adhurimi, me të cilin e këmbej

Kaq për natën dhe kaq për britmën në erë
Kaq për pikën që pikon në qiell, kaq për heshtjen
Që rrethon despotikun det
Për kupën e qiellit me yjtë e saj
Kaq për psherëtimën tënde më të lehtë
Kaq mirë, saqë nuk kam ç'të bëj më gjë tjetër
Midis këtyre katër mureve, kësaj dyshemeje, këtij
tavani
Veç të them me zë të lartë emrin tënd
Të nuhat gjurmën tënde dhe të sulmohem nga
njerëzit
Meqenëse ata nuk e durojnë të pazakonshmen
As atë që vjen prej gjetiu dhe ngaqë është tepër herët,
a më dëgjon
Ende është herët në këtë botë e dashura ime

Që unë të flas për ty dhe për veten.

Vladimir NABOKOV

KTHIMI I ÇORBAS

Përktheu nga origjinali
Agron TUFA

Bashkëshortët Keller dolën vonë nga teatri. Në këtë qytet të qetë gjerman, ku Ajri qe paksa i zbërdhlyt dhe tash tetë shekuj në lumë drithërima tërthore e ujërave shuante katedralen e pasqyruar; Wagnerin e vinin në sallat verore, me shije, të ngopnin me muzikë gjer në grykë. Pasi dolën nga teatri, Keller e shpuri të shoqen në një tavolinë luksozen, në të cilën shërbehej një nga verërat e bardha më të famshme. Dhe vetëm në orën dy të natës, automobili i ndriçuar mendjelehtësisht përbrenda, i gjezdisi ata nëpër rrugët e vdekura gjer në deriçkën e hekurt të një vile fisnike. Kelleri, një gjerman i moshuar shpatullgjerë, shumë i ngjashëm me presidentin Kjurjer, zbriti i pari në trotuar, ku nën dritën e marrtë të fanarit, lëvrinin hijet e spërdredhëta të gjetheve. Drita e mbuloi për një grimë parzmën e kollarisur të Kellerit dhe pikëzimet e mërkurta në fustanin e së shoqes, e cila me të lëshuar këmbën e saj të ngjallme, zbriti nga automotobili. Në paradhomë i priti shërbëtorja dhe, në vrap e sipër, me pëshpërimë të trembur, u kumtoi për vizitën e Çorbas. Fytyra e ngrirë dhe ende e re e Varvara Klimovna Kellerit u drodh dhe u skuq prej trazimit:

- Ju tha se ajo është e sëmure?

Shërbëtorja pëshpëriti dhe më fortë. Kelleri lëmoi me dorën topolake mjekrën e thinjur dhe fytyra e tij e madhe, paksa e ngjashme me atë të një majmuni, me buzën e sipërme të stërgjatur dhe me rrudha të thella, pati një trembe pleqërishte.

- Nuk mundem gjallë të pres deri nesër. Do të nisemi që tani, nëpërdhëmbi duke tundur kokën Varvara Klimovna dhe rëndshëm u suall rreth vetes, duke rrahur të kapë çipin e vualit, me të cilin qe pështjellë paruka e saj e gështenjtë, - O Zot i madh... Kot nuk qe ajo, një muaj pa një copë letër.

Kelleri ndreqi me trinën e dorës cilindrin e shkarë shtrembër dhe foli me rusishten e tij të saktë e paksa grykore:

- Ky njeri s'është në vete. Si guxon, nëse ajo është sëmure, ta shpjerë prapë në atë hotel të ndyrë...

Por, sigurisht, ata gaboheshin, kur mendonin se vajza e tyre ishte e sëmure. Çorba ashtu i kish thënë shërbëtores, thjesht se e kishte patur të lehtë të fliste. Në të vërtetë, ai kthehej nga jashtë shteti fillikat dhe tani e kuptoi që, gjithsesi, duhej të sqaronte se si e qysh vdiq gruaja e tij dhe pse nuk u kishte shkruar asgjë. Kjo ishte krejt e vështirë. Si t'ua shpjegonte që ai dëshironte ta zotëronte fill i vetëm hidhërimin e tij, pa e fëlliqur dhe pa e ndarë atë me askënd tjetër? I qe dukur se vdekja e saj qe një rrethanë tepër e rrallë, rrethanë pothuaj e padëgjuar, që asgjë nuk mund të jetë më e pastër se një vdekje e tillë – prej goditjes së rrymës elektrike, e cila duke u përplasur në xhama, jep dritën më të pastër dhe më verbuese.

Dhe qëkurse ajo, atë ditë pranvera mbi xhadenë e bardhë afro dhjetë vjorsta larg Nisës, shkeli tekta qeshte telin elektrik të këputur nga shtylla prej stuhisë, - e gjithë bota për Çorban saora shtangoi, u spraps dhe madje kurmi i saj i vdekur, të cilin e mbarti në krahë deri në fshatin më të afërt i dukej tashmë disi i huaj dhe i panevojshëm. Në Nisë ku duhej ta varrosnin, një pastor i shpifur veremli lodhej më kot t'i shkëpuste ndonjë hollësi, - ai veçse buzëqeshte mefshët, gjithë ditën e Zotit rrinte mbi zhurin e plazhit, duke hedhur nga njëra pëllëmbë në tjetrën guralecë laraganë, - dhe befas, papritur të mbarojë varrimi, u nis të kthejë në Gjermani përmes po atyre vendeve, nga patën bujtur së bashku gjatë udhëtimit të martesës. Në Zvicër, ku patën kaluar dimrin dhe ku tani kishin çelur mollët, ai nuk njohu asgjë përveç hotelit; ana në Shvarcvald, tërthor të cilit kishin kaluar që në vjeshtë,

pranvera paksa e ftohtë nuk i pengonte kujtimet e tij. Dhe po ashtu si në plazhin e jugut, ai përpiquej të gjente atë guralec të rrumbullt, të zi, me një larë të bardhë e të rregullt nëpërmasë, të cilin ajo ia kishte treguar në vigjilje të shëtitjes së fundit, - gjithëpo njëllor, edhe tashti ai kërkonte për udhë gjithësa ajo pati vënë re nën klithma ngazëllimi; arabeskat e veçanta të shkëmbinjeve, shtëpizat e mbuluara me luspa të argjendta, bredhin e zi dhe urën mbi një përrua të bardhë dhe atë çka qe ndofta shëmbëlltyra fatale, - pezhishkën e gjerë rrezatuese që ndehej në telat e telegrafit, të kërrusura nën rruazaret e mjegullës. Ajo e pati ndjekur këtë: çizmet e saj me taka të larta, çapiteshin shkathët dhe gjithçka lëvizte, lëviznin duart, herë duke shkëputur një gjethez nga shkorreti, herë duke lëmuar shkarazi muret shkëmbore, doçkat e saj të lehta, gaztare, të cilat nuk gjenin prehje. Ai këqyrte fytyrën e saj të vockël, cit me prenka të errëta, dhe sytë e gjerë me një të gjelbër të zbehtë, ngjyrë ciflash qelqi të lëmuar prej dallgësh. I dukej që, nëse i mbledh të gjitha ato çikërrima të cilat i kishin vënë re së bashku, nëse e ringre këtë të tashme të afërt, - imazhi i saj bëhet i pavdekshëm dhe do t'ia zëvendësonte atë përgjithmonë. Netëve, prania e saj vegullore bëhej papritmazi e llahtarshme, ai pothuaj nuk vuri gjumë në sy gjatë kohës së këtij udhëtimit trejavor dhe tani mbërriti krejt i rraskapitur në qytetin e qetë, ku qe takuar e kishte vënë kurorë me të, në stacion, prej nga vjeshtës së kaluar u larguan së bashku.

Ishte afro tetë e mbrëmjes. Prapa shtëpive kulla e katedrales nxinte shkoqur në brazdën e purpurt të muzgut. Në sheshin para stacionit qëndronin truc gjithëpo ato kaloshina të rrëguara. Spikaste po ai gazetashitës me zërin e tij të shurdhët mbrëmjesor. Po ai pudel i zi me sy indiferentë ngrinte putëzën hollake ndanë reklamës së komodinave, drejt e mbi gërmat e kuqe të afishes: "Parsifal". Çorba kishte me vete një valixhe dore dhe një sënduk të madh të verdhë. Ai ngau përmes qytetit me kaloshinë. Karrocieri tundte përtueshëm frerët, duke mbajtur me një dorë valixhen. Çorbës iu kujtua që ajo, të cilën ai kurrë nuk i thërriste në emër, pëlqente të udhëtonte në kaloshinë.

Në rrugicën prapa qoshes së operës, ngrihej hoteli i vjetër trikatësh i një stili bajat, në të cilin jepeshin dhoma edhe për një javë, dhe për një orë, - një ndërtesë e zezë, e zhvoshkur si hartë gjeografike, me perde të ashpra pas xhamave të turbullt dhe me një derë hyrëse të mezidukshme, që kurrë nuk mbyllej me kyç. Një lakë i zbehtë e i shpenguar, i priu Çorbës nëpër korridorin gjarpëruar, të nginjur me lagështirë dhe erë lakre, dhe Çorba hyri pas tij në numër, njohu saora, për nga vaska e trëndafilte brenda kornizës mbi krevet, që është po ajo dhomë ku ai pati kaluar me të shoqen natën e tyre të parë të përbashkët. Asaj i dukej zbatimëse atëherë, - dhe trashaluaqi pa xhakët, i cili villte në korridor, dhe fakti, sepse zgjodhën të tillë hotel të gërbulur, dhe ajo që në lavaman gjetën një fije floku tepër të ndritshme, por më fort se të gjitha të tjerat, ajo shkulej gazet nga mënyra se si i fshiheshin shtëpisë. Dhe menjëherë pas kthimit nga kisha, ajo pati vrapuar në dhomë të ndërronte rrobat, - gjersa poshtë mbledheshin të ftuarit për darkën. Kelleri, veshur me një frak prej një cohe të mirë, me buzagazin e butë në surratin e tij majmunor, u rrihte shpatullat herë njërit, herë tjetrit, u servirte vetë shnaps, - ndërsa miqtë e ngushtë Varvara Klimovna i shpinte dy nga dy të sodisnin dhomën e gjumit, të caktuar për të sapomartuarit, - dhe duke përsëritur me mallëngjim, duke treguar një dyshek gjigand prej puplash ngjyrë portokalli, dhe mbi dy palë pantofla të reja dhoma, njëra me katrorthë të mëdhenj dhe tjetra, e veckël me xhufka të vocërta të kuqe, - të vendosura pranë njëra-tjetrës, nëpër të cilën shtrihej mbishkrimi me shkronja gotike: "Bashkë do jemi gjer në dërrasë të varrit". Mandej, të gjithë iu afruan tavolinave, - ndërsa Çorba me nusen me të rënë në ujdi sakaq, u arratisën nga dalja e fshehtë dhe vetëm në mëngjes, vetëm gjysmë ore para nisjes së trenit-ekspres, kthyen në shtëpi sa për të marrë bagazhet. Varvara Klimovna dënosi gjithë natën e lume; i shoqi, për të cilin Çorba përfaqësonte veçse një emigrant të varfër dhe letrar, - gjithnjë ishte një njeri dyshues, mallkoi zgjedhjen e vajzës, shpenzimet për blerjen e verës, policinë e cila s'arrinte të bënte asgjë... dhe pastaj, kur të rinjtë qenë larguar, plaku dilte të vëzhgonte hotelin pas ndërtesës së operës, - dhe që atëherë, kjo ndërtesë e zezë, e qorrur, u bë diç e neveritshme dhe joshëse, mu si kujtimi për krimin.

Gjersa bartte sëndukun, Çorba këqyri palëvizshëm oleografinë ngjyrë trëndafil. Kur dera u hap, ai u përkul mbi sënduk dhe e mbylli. Në qoshk, për nën zhelen e çartallozur të letrës së murit, bridhte një mi. Ai u rrotullua rreth thembrave me një rrëqethje të shpejtë. Një llampë e zhveshur që varej me një sixhim në tavan, memzi kolovitej. Hija e sixhimit rrëshkiste tërthor divanit, duke u kthyer në këndet e lakuara të tij. Mu në këtë divan, ai pati fjetur atëherë. Nusja e tij frymonte prajshëm fëmijërisht. Atë natë ai veçse e pati puthur në gropëzën e fytyrës, - dhe asgjë më tepër. Miu filloi të lëvrinte sërish. Ka të tillë tinguj të veckël të cilët janë edhe më të tmerrshëm se të shtënat me top. Çorba la sëndukun, përshkoi dhomën dy herë. Një fluturz nate goditej kumbueshëm pas llampës. Ai përplasi derën pas vetes dhe doli. Duke zbritur për shkallësh, ndjeu se sa shumë qe lodhur dhe kur u gjend në rrugicë, koka i vinte rrotull nga bluaja e turbullt e natës së majit. Me të kthyer në bulevard, nxitoi hapin. Sheshi. Kalorësi i gurtë. Retë e zeza të parkut qytetas. Tashmë lulëzonin gështenjat, ndërsa atëherë ishte vjeshtë. Ata patën shëtitur gjatë bashkë në vigjilje të dasmës. Sa i këndshëm ish erëtimi i dheut, i vllazhët, me amëstinë e vjollcave kundërmonin gjetet e zverdura, që mbulonin trotuarin... Qielli ato ditë të ngrysurat e të hirshme ndodhte të ishte i zgjyrtë dhe përmes sokakut të errët, degët pasqyroheshin në një pellg të vogël, të ngjashme me një fotografi të palarë mirë. Midis vilave të hirta palëvizshëm dhe butësisht zverdhorin pemët, ndërsa para shtëpisë së saj vyshkej një plep dhe gjetet e tij kishin ngjyrën e tejdokshme të rrushit. Përtej kangjellave vizllonin trungjet e mëshhtëknave – herë tjetër në këtë këllëf të plotë shtjellej shermasheku, - dhe ai rrëfen, që në Rusi nuk bën vaki t'i qepet mëshhtëknës shermasheku, ndërsa ajo i thoshte se nuanca e kuqërreme e gjethezave të tyre të veckla i çonte ndërmend ngjyrën delikate të ndryshkut në të

linjtat e hekurosura. Përgjatë trotuarit hidhnin shtat lisat dhe gështenjat; nëpër lëvozhgën e zezë ende gjethnaja e zbehtë dhe e kadifenjtë; herë pas here këpotej ndonjë gjethë, pluskonte shkarazi tërthor rrugës, mu si një zhele e shqyer letër muresh. Ajo rrihte ta kapte atë najrë me ndihmën e një lopatke, të cilën e gjeti rrëzë një pingu tullash të kuqe, atje ku po meremetonin rrugën. Tutje, nga gypi i furgonit të punës, shtëllungej një tym mavi, zhdedhej, zhदारaritej ndërmjet degëve, - dhe muratori që po pushonte, këqyrte me duar në ije zonjën e lehtë si një gjethë të zbehtë, që vërtitej me lopatën në duart e ngritura. Ajo kërcente dhe gajasej. Çorba, duke u kërrusur paksa, e ndiqte dhe qeshte dhe i dukej se ja, kështu sak, siç kundërmojnë gjethet e zverdhura, kundërmon vetë lumturia.

Tani ai mezi e njohu këtë rrugë, të gapërruar prej harlisjes mbrëmjesore të gështenjave. Përpara ndriçonte fanari, duke përkulur degët mbi qelq, dhe disa gjethë qenë krejt të tejdukshme, të nginjura me dritë për skajesh. Çorba u avit. Hija e deriçkës me kangjella të thyera u dha drejt tij që nga trotuari, duke i zënë këmbët. Pas kopshtit, pas larës së mjegullt të zhavorrit, u rrit fasada e errët e një ndërtese të njohur. Njëra dritare që e hapur dhe me dritë. Në këtë gropë të qelibartë shërbëtorja, me një lëvizje të gjerë, shtronte çarçafët me ngjyra të ndezura. Çorba i thirri asaj me zë të lartë e të prerë. Me një dorë ai mbahej për shtalke dhe ndjesia e hekurit të vesuar poshtë pëllëmbës, që më e forta nga gjithë kujtimet.

Shërbëtorja rendi drejt tij. Siç i pati thënë ajo më vonë Varvara Klimovna, atë para së gjithash, e kish tronditur fakti që Çorba, vazhdoi të qëndronte duke heshtur në trotuar. Megjithëse ajo menjëherë e kishte mbyllur deriçkën. "Ishte pa kapele, - pati rrëfyer ajo, - dhe drita e fanarit i binte mu në ballë, dhe ballin e kishte të qullur nga djersa, dhe flokët në ballë të ngjitura. Unë i thashë se zotërinjtë janë në teatër dhe e pyeta përse ka ardhur i vetëm. Sytë i ndrisnin mnershëm dhe ai dukej se s'qe rruar qëmoti". Ai tha zëulët: "Lajmërojini se ajo është sëmure". Unë e pyeta: "Po ku jeni vendosur?". Ai tha: "Në po atë vend", - dhe mandej: "Kjo s'ka rëndësi. Nesër në mëngjes do të vij vetë". "Unë i propozova të presë, po ai nuk u përgjigj, ktheu shpinën dhe iku". Kështu, Çorba që kthyer mu në burimet e kujtimeve të tij. Ky që një tundim i ëmbël e torturonjës, të cilit tashmë po i vinte fundi. Mbetej të kalonte gjithëqysh një natë në atë dhomë të natës së parë të martesës, dhe pastaj, nesër, - tundimi do të ketë kaluar dhe imazhi i saj do të bëhet i përfunduar. Dhe ndërsa kthehej mbrapsht në hotel, për bulevardit, ku nëpër gjithë stolat, në terrin blu, po rinin figura të mjegullta, ai kuptoi papritmas që, pa marrë parasysh lodhjen, ai s'do mundë të flejë i vetëm në atë dhomë me llampën lakuriqe dhe qoshet pëshpëritëse. Ai doli në shesh dhe brodhi nëpër rrugën kryesore, - e tashmë e dinte se ç'duhej bërë. Por s'e kërkoi gjatë: qyteti ishte i qetë, i papërlyer, - dhe ajo rruginë e errët, ku shitej dashuria, që e njohur për Çorban. Dhe vetëm pas një ore harrakatjesh të pashpresa, prej së cilave i digjnin



thembrat dhe i zhaurinin veshët, rastësisht në atë rruginë, ai ia qëlloi dhe saora iu avit një femre që iu gjegj:

- Mbrëmani, - nëpërdhëmbi Çorba.

Femra vajisi kokën mënjanë, koloviti çantëzën dhe iu gjegj:

- Njëzetë e pesë.

Ai tundi kokën. Vetëm shumë më vonë, duke e këqyrur atë rastësisht, Çorba pikasi me indiferencë se ajo s'ishte copë e keqe, megjithëse shumë e shkëlqyer dhe që flokët i kishte me një prarim bjond e të prera.

Ajo kishte qenë disa herë me burra të tjerë në këtë hotel ku qëndronte Çorba, - dhe lakeu i zbehtë e hundak që po zbriste shkallët, ia shkeli syrin miqësisht. Ndërsa përshkonin korridorin, dëgjohej se si prapa njëres prej dyerve, ritmikiisht dhe rëndshëm gërvinte krevati, mu sikur dikush të sharronte një tra. Pas disa dyersh, prej një tjetër numri vinte jehu i një tingulli po të tillë shtërzues, dhe - teksa kalonin përska, femra me një koketëri të ftohtë, i hodhi sytë Çorbas. Ai, heshturazi, e shpuri atë në dhomën e tij dhe menjëherë, me parangjërimitin e thellë të gjumit, zuri të shkopsitë xhupin. Femra iu avit puthitshëm dhe e pyeti me buzagaz:

- Po për dhuratën e vockël?

Çorba e këqyri përgjumësh dhe hallakatshëm dhe me vështirësi iu kujtua se ku i rrihte asaj. Me të marrë paratë, ajo i futi me kujdes në çantë dhe, pasi fshani lehtëzi, iu avit rishtaz dhe shpupurisi flokët:

- Të zhvishem?

- Po, shtrihu, - bërbeliti Çorba, - në mëngjes do të të jap prapë.

Ajo nisi të shkopsitë nxitimthi komçat e këmishës dhe gjithë kohës kundronte vjedhurazi me bisht të syrit Çorban, duke u habitur paksa me zyrtësinë e tij të hallakatur. Me t'u zhveshur, ashtu, shpejt e shkujdesshëm, ai u shtri në çarçafë dhe u kthye nga muri.

"Ky, si duket, qenka me një dërrasë mangut", - mendoi vagullt femra. Ngadalë, paltoi këmishën dhe e vendosi në karrige. Tashmë, Çorba po bënte gjumë të rëndë.

Femra bënte vara-vinga nëpër dhomë dhe, me të pikasur që kapaku i sëndukut që qëndronte rrëzë dritares ishte paksa i hapur, u lëshua kacipup dhe kërkoi me sy cepave. Duke lëvizur dhe shkuar dorën me kujdes, ajo preku një fustan, një palë çorape, dofarë cohash të mëndafshta, të paluara disi dhe që kundërmonin aq erandshëm, sa e kaploi trishtimi.

Ajo drejtoi shtatin duke gromësirë, kruajti brinjët dhe, ashtu siç që, cullake, vetëm

në çorape, iu avit dritares dhe mënjanoi perden. Tej perdes flegra e dritares që e hapur dhe në honin e kadifenjtë të rrugës dukej qoshku i operës, supi i zi i Orfeut të mermertë që spikaste në sfondin blu të natës, sikundërse dhe një varg dritash nëpër fasadën e mjegullt, që humbisnin kërthazi në mugëtirë. Atje, në largësi, shtresave gjysmë të rrumbullta të shkallareve të Kishel-it, duke shkarë përska, dritave të forta ndanë dyersh, siluetat e imëta e të errëta rrëshqisnin drejt shkallëve, duke lodruar nën fanarë e duke shkëndritur poshtë çative të lëmuara të automobilëve. Dhe vetëm kur mori fund kjo shpërndarje dhe dritat u shuan, femra lëshoi perden dhe, me të fikur dritën, u shtri në shtroje përbri Çorbas. Duke e marrë gjumi, ajo ndërmendi se kishte qenë dy herë, pikërisht në këtë dhomë: ndërmendi tablonë trëndafil në mur.

Ajo fjeti jo më shumë se një orë: e zgjoi një klithmë e mprehtë dhe e llahtarshme. Klithte Çorba. Ai u zgjua në mesnatë, u kthye në brinjë dhe shqoi gruan e tij që shtrihej përbri. Ai klithi mnershëm me gjithë barkun. Hija e bardhë e femrës brofi nga shtrojet. Kur gjithë duke u dridhur ajo ndezi dritën, Çorba qëndronte në çarçafët e bërë shuk me shpinë nga muri dhe, përmes gishtave që i mbulonin fytyrën, me një shkëlqim të çmendur, vetëintje njëri sy. Mandej, ai prajshëm shploi fytyrën, prajshëm njohu femrën. Ajo duke u lebetitur lemerishëm, veshi nxitimthi këmishën.

Dhe Çorba, i lehtësuar, fshau dhe kuptoi që ankthi mori fund. Ai u zhvendos në divan dhe, duke ndrydhur me pëllëmbë pulpat leshtore, me një buzagaz shpërfillës këqyrte femrën. Ky buzagaz e rrenqethi atë më shumë dhe, me t'u kthyer, ajo kapi mbërtheckën e fundit, lidhi këpucët dhe ngjeshi beretën.

Dhe në këtë grimëherë, në korridor kumbuan zëra dhe çape.

- Po ai është bashkë me damën e tij...

- përsëriste trishtueshëm zëri i lakeut.

Por zëri i mllefosur e grykor këmbëngulte:

- Mor po, jua përsëris që ajo është ime bijë.

Hapat u ndalën pas derës. Mandej jehuan të trokiturat. Atëherë femra rrëmbeu çantën nga tavolina dhe vendosmërisht hapi derën. Para saj qëndronte një zotëri i vjetër e i hutuar me një cilindër dalëboje, me një margaritar mbi këmishën e bardhë në gjoks, - prapa supit të tij kundronte një damë topolake me sy të skuqur nga të qarët e me vual flokëve dhe, në fund fare, një lake shtatpakët e i zbehtë që ngrihej majë gishtash, duke zgurdulluar sytë e duke i bërë me dorë asaj gjeste që të dilte. Femra e kuptoi shenjën e tij dhe kërcëu në korridor, përska plakut, i cili gjithëpo me atë hutesë, ktheu kokën nga ajo dhe mandej, bashkë me damën, kapërceu pragun. Dera u hap. Femra me lakeun qëndruan në korridor, - të frikësuar vështronin shoshoqin dhe, duke u përkulur, vunë veshin. Në dhomë që heshtje. Dukej e pabesueshme, që atje, pas derës, kishte tre njerëz.

As edhe një tingull nuk vinte prej andej.

- Ata heshtin, - pëshpëriti lakeu dhe vuri gishtin ndër buzë.



CH. BAUDELAIRE

PALIMPSESTI

Përktheu nga origjinali Fabiola Kadi

“Ç’është truri i njeriut, përveçse një palimpsest i stërmadh i natyrshëm? Truri im është një palimpsest dhe i juaji gjithashtu, lexues. Shtresa të panumërta idesh, imazhesh, ndjenjash kanë rënë njëra pas tjetrës në trurin tuaj, po aq butësisht sa edhe drita. Duket sikur secila prej këtyre shtresave ka varrosur atë të mëparshmen. Por, në realitet, asnjëra nuk ka humbur përgjithmonë.” Gjithsesi, midis palimpsestit që mban, njëra pas tjetrës një tragjedi greke, një legjendë asketësh dhe një histori kalorësie, dhe palimpsestit hyjnor të krijuar nga Perëndia, që është kujtesa jonë e pamatshme, shfaqet ky dallim, që në vend të parë ka një kaos fantastik, grotesk, një përplasje mes elementeve heterogjenë; ndërsa në vend të dytë ndodhet fataliteti i temperamentit që sjell harmoni mes elementeve nga më të larmishmit. Sado jokohërente të jetë një ekzistencë, uniteti njerëzor nuk turbullohet. Të gjithë zërat e kujtesës, nëse do të mundeshim t’i zgjonim në të njëjtën kohë, do të formonin një koncert, të këndshëm dhe vajtues, por logjik dhe pa konflikte.

Shpesh disa qenie, që pësojnë një aksident të papritur, të mbytur përnjëherësh nga uji, dhe në rrezik vdekjeje, kanë parë tek ndizet në trurin e tyre gjithë teatrin e jetës së tyre t’u kalojë përpara syve. Kohës nuk i kanë mbetur më gjurmë, dhe disa sekonda kanë qenë të mjaftueshme për të mbajtur brenda një sasi ndjenjash dhe imazhesh të barabarta me disa vite bashkë. Dhe ajo që është më e çuditshmja në këtë përvojë, që rastësia ka sjellë më tepër se një herë, nuk është njëkohësia e shumë elementeve që ishin të njëpasnjëshëm, është rishfaqja e gjithçkaje që qenia vetë nuk e njihnte më, por që është tashmë e detyruar ta njohë sikur të ishin pjesë e saj. Harresa është veçse e përkohshme; dhe në rrethana të tilla solemne, në vdekje ndoshta, dhe në përgjithësi në eksitimet e forta, të krijuara nga opiumi, i gjithë palimpsesti i stërmadh dhe i ndërlikuar i kujtesës ndodh menjëherë, me të gjitha shtresat e mbivendosura të ndjenjave të vdekura, ta balsamosura në mënyrë të misterishme në atë që ne e quajmë harresë.

Një njeri gjenial, melankolik, mizanotrop, dhe që ka dashur të hakmerret për padrejtësinë e shekullit, hedh një ditë në zjarr të gjitha veprat e shkruara me shkrim dore. Dhe meqenëse është qortuar për këtë holokaust të tmerrshëm të bërë në urretje e sipër, e cila, për më tepër, ishte flijimi i të gjitha shpresave, ai u përgjigj: “E ç’rëndësi ka? Ajo që ishte e rëndësishme është që këto gjëra u krijuan; ato janë krijuar tashmë; ato janë të krijuara, pra ato janë.” Ai u vishte të gjitha gjërave të krijuara një karakter të pashkatërrueshëm. Sa e aplikojmë këtë ide më saktë në gjithë mendimet tona, në gjithë veprimet tona, të mira apo të këqija! Dhe nëse duke besuar kështu ka diçka pafundësisht ngushëlluese, në rastin kur shpirti ynë kthehet nga ajo anë e vetvetes të cilën ne e konsiderojmë vetëm me dashamirësi, a nuk ka edhe diçka pambarimisht të tmerrshme, në rastin e ardhshëm, të paevitueshme, ku shpirti ynë do të kthehet nga ajo anë e vetvetes me të cilën mund të përballlemi vetëm me një lloj tmerrri? Në botën shpirtërore si në atë materiale, asgjë nuk humbet. Dhe edhe çdo veprim, i gjendur në vorbullën e veprimit universal, është në vetvete i pakthyeshëm dhe nuk mund të ndreqet, abstragim i arritur nga rezultatet e mundshme, ashtu si çdo mendim nuk mund të fshihet. Palimpsesti i kujtesës është i pashkatërrueshëm.

“Po, lexues, të panumërta janë poemat e gëzimit apo hidhërimit që janë gdhendur njëra pas tjetrës në trurin tuaj, dhe si gjethet e pyjeve të virgjër, si dëborat e pashkrira të Himalajeve, si drita që bie mbi dritën, shtresat e tyre të pambarimta janë mbledhur dhe me radhë janë mbuluar në harresë. Por në çastin e vdekjes, apo në një moment ethesh, apo ndërsa je në kërkim të opiumit, të gjitha këto poema mund të rikthehen në jetë dhe të rimarrin fuqi. Ato nuk kanë vdekur, janë veçse në gjumë. Besojmë gabimisht se tragjedia greke është nxjerrë jashtë dhe është zëvendësuar nga legjenda e murgut, legjenda e murgut nga romani kalorësiak; por nuk është kështu. Sa më shumë përparon qenia njerëzore në jetë, romani që në rini e mrekullonte, legjenda e mahnitshme që e joshte në fëmijërinë e vet, e humbasin madhështinë dhe mbulohe nga errësira. Por tragjeditë e thella të fëmijërisë, - krahë të rrëmbyer me forcë njëherë e përgjithmonë nga qafa e nënave të tyre, buzë fëmijësh të ndara përgjithmonë nga puthjet e motrave të tyre, - jetojnë përgjithmonë të fshehura, nën legjendat e tjera të palimpsestit. Pasioni apo sëmundja nuk kanë kimi aq mjaftueshëm për të djegur këto gjurmë të pavdekshme.”

SALLY ROONEY:

Mbi shkrimtarët dhe publicitetin

Përktheu Andreas Dushi

Ditë për ditë çuditë pse jeta ime ka marrë këtë drejtim. Nuk mund ta besoj se më duhet të toleroj gjithë këto gjëra: të ketë artikuj të shkruar rreth meje, të shoh fotografi të miat në internet dhe të lexoj komente rreth vetes time. Kur e vura re këtë, mendova: kjo është? Dhe tani, çfarë? Por fakti është, ndonëse nuk do të thotë asgjë, se kjo më bën të mjerë dhe se nuk dua të jetoj këtë lloj jete. Kur dorëzova librin tim të parë, doja thjesht të bëja mjaftueshëm para për të përfunduar pasardhësin. Asnjëherë nuk e kam reklamuar veten si një njeri të fuqishëm mendërisht, të aftë të përballojë kërkesat e çdo fushe nga publiku brenda personalitetit dhe edukimit tim. Njerëzit që bëhen të famshëm ndërkombtarisht, dua të them njerëzit që pas një shijeje të vogël të famës duan gjithnjë e më shumë, janë, dhe vërtetë e besoj këtë, thellësisht të sëmurë mendorë. Fakti që jemi të ekspozuar përballë këtyre njerëzve kudo në kulturën tonë, sikurse ato të jenë jo vetëm normale, por edhe tërheqës edhe për t’u pasur zili, tregojnë nivelin e çfigurimit të shoqërisë tonë të sëmurë. Ka diçka që nuk shkon me to, dhe mandej kur ne i shohim dhe mësojmë prej tyre, ka diçka që nuk shkon me ne.

Gjithsesi, çfarë raporti është mes shkrimtarit të famshëm dhe librave të tij të famshëm? Po të kisha një sjellje të keqe, personalitet të pakëndshëm dhe theks irritues, çka në opinionin tim mund të jetë pikërisht rasti, do të kishte të bënte diçka me romanet e mia? Sigurisht që jo! Puna do të ishte e njëjta, pa asnjë ndryshim. Dhe çfarë fitojnë librat duke qenë të bashkangjitur me mua, me fytyrën time, me sjelljet e mia, në të gjitha veçantitë e tyre demoralizuese? Asgjë! Atëherë pse, pse ndodh kështu? Interesit të kujt i shërben kjo gjë? Kjo më bën të mjerë, më mban larg nga e vetmja gjë në jetën time që ka kuptim, nuk kontribon asgjë në interesin publik, përmbush vetëm kafshërinë dhe nepset e kureshtarëve dhe shërben për ta vendosur diskursin letrar krejtësisht rreth figurës dominuese të “autorit” jeta dhe idiotësitë e të cilit duhet të bien në sy deri në detajet më të zbehta pa asnjë arsye. Vazhdoj të ndeshem me këtë person, që është vetja ime, dhe e urrej me të gjitha forcat. Urrej mënyrat me të cilat shpreh vetveten, urrej pamjen e saj dhe opinionet që ka rreth çdo gjëje. Dhe ende, kur njerëzit e tjerë lexojnë rreth saj, besojnë se ajo jam unë. Të përballem me këtë fakt më bën të ndihem sikur tanimë jam e vdekur.

Sigurisht, nuk mund të ankojem, pasi të gjithë janë gjithnjë duke më thënë “shijoje”. Çfarë dinë ata? Ata nuk kanë qenë këtu, e kam bërë gjithçka vetëm. Okay, ka qenë një përvojë e shkurtër në mënyrën e vet dhe e gjitha do të venitet në pak muaj ose vjet dhe askush nuk do të më kujtojë ndonjëherë, faleminderit Zotit. Por ende, është dashur ta bëj këtë, më është dashur të shkoj përmes saj vetë, pa askënd që të më mësojë se si, dhe kjo më ka bërë ta neveris veten deri në një gradë thuajse të padurueshme. Çfarëdo që unë të bëj, çfarëdo talenti të parëndësishëm të kem, njerëzit thjesht presin nga unë që ta shes atë, dua të them tekstualisht, ta shes atë për para, deri kur të kem shumë para dhe aspak talent të mbetur. Dhe atëherë, kjo është: jam e mbaruar, dhe në një çast, njëzetëepesë vjeçarja e ardhshme vjen me një kolaps psikologjik të pashmangshëm. Nëse kam takuar njerëz të vërtetë përgjatë rrugës, ata kanë qenë të maskuar më së miri në turmën e vrullshme, gjakatare e egocentrike, aq sa nuk i kam njohur dot.



Sa herë që përmendet emri Napoleon Bonaparte mendja shkon menjëherë te bëmat kolosale historike që ai arriti gjatë jetës së tij dhe ndikimin që ato patën në rrjedhën e mëvonshme në histori, por për sa i përket imazhit dhe portretit të tij, na vjen në mendje kjo tablo monumentale, në të cilën, i hipur mbi një kalë, me gishtin drejtuar përpara, ai çan përmes Alpeve duke udhëhequr fushatën ushtarake për të mposhtur trupat austriake në Marengo. Napoleoni mbetet një figurë madhështore historike, por lavdia e tij shpalolet më së miri figurativisht nga tabloja *Napoleoni Duke Kaluar Alpet*, (1801) e piktorit francez Jacques-Louis David (1748-1825).

Shumë kritikë e kanë vlerësuar këtë veper si propagandë. Dhe në të vërtetë ajo u krijua si e tillë. Por përtej propagandës ajo mbetet edhe një kryeveper në historinë e artit botëror. Një Napoleon shtatshkurter që shpalolet me një madhësi të tillë nuk mund të arrihej dot përveçse forcës së artit dhe dorës së mjeshtarit Jacques-Louis David.

Kompozimi i veprës është i përsosur. Një moment i ngrirë përmban dinamikë të pashteruar. Napoleon-i është i ulur mbi një kalë të bardhë të racës arabe, i cili këmbët e përparme i ka të ngritura furishëm ndërsa të pasmet të përkulura sikur mbajnë një peshë të rëndë, jo vetëm trupin e gjeneralit por të vetë kohës, betejave, fitoreve, sakrificave, dhe fatin e një kombi të tërë.

E gjithë tabloja lëviz për nga e majta. Napoleoni ka gishtin tregues të dorës së djathtë të drejtuar për nga e majta. Ajo dorë është pa dorezë, edhe pse i ftohti i Alpeve është i acartë. Edhe manteli i kuq vërshon nga i njëjti drejtim, sikurse edhe flokët dhe bishti i kalit. Ushtarët në sfond dynden për nga e majta nën urdhrat e drejtuesit të tyre, dhe të gjitha gjestet dinamike duken triumfuese kundrejt maleve të thepisura si nën këmbët e kalit ashtu edhe në sfond, megjithatë, sado të larta, ato nuk ia kalojnë cepit të mantelit, gishtit, dhe kapelës së Napoleon-it të cilat tregojnë epërsi edhe mbi kushtet ekstreme të natyrës.

Në këtë tablo, me pikënisjen nga këndi i poshtëm i djathtë i tablosë që shpërthen për nga lart në anën tjetër të kanavacës, kalimi i Alpeve nga gjenerali Bonaparte na shpalolet si kaplim i mundimshëm prej ferrit drejt një paradise të gjendur përtej kreshtave të larta, si ato makthe që manifestohen vetëm në ëndrrat e frikshme të netëve të zeza dimërore, por, vështrimi i drejtpërdrejtë i Napoleon-it për nga shikuesi, dhe kalërimi besimplotë tregojnë se gjenerali e pret me vetësiguri atë sfida, si një betejë e lavdishme e radhës e cila do shkruhet në histori.

Aspekti historik është i pashmangshëm. Gishti drejtues dhe vështrimi depërtues i Napoleon-it janë ftues. Ato na ftojnë të ndjekim atë triumf që do gdhendet në epoka, ndaj dhe Davidi ka shkruar në gurët e këndit të poshtëm të tablosë tre emra, Bonaparte, heroin e veprës, si edhe Hannibal dhe Charlemagne, dy figurat e tjera të shquara të historisë të cilët drejtuan trupat e tyre përmes Alpeve.

Tabloja shpalos një dinamikë të paprecedentë në art. Davidi e ka arritur këtë jo vetëm përmes lëvizjes së elementëve figurativ por edhe atyre gjeometrik. Figura gjeometrike e zgjedhur nga Davidi është trekëndëshi, i cili dallohet në shumë plane, për shembull: kapela e Napoleonit që formon një piramidë me këmbët e përparme dhe të pasme të kalit; gishtit drejtues me dy qoshtet e poshtme të tablosë; cepi i përparmë i mantelit të kuq me cepin e pasmë dhe me fundin e palltos së zezë; linja e shkëmbit të poshtëm dhe e malit në sfond; përthyerja e krahut dhe këmbës së majtë të Napoleon-it; palosja e fundcepit të palltos së zezë; si edhe vetë drejtimi i reve që shërben si përforsim për të theksuar lëvizjen.

Edhe aspekti piktoresk është mjeshtëror. Trajtimi i mantelit dhe veshjes së Napoleonit, shpata e artë e mbërthyer në brez, trupi dhe vështrimi i kalit, dora me dorezë e cila shtrëngon me forcë forin, janë të gjitha të harmonizuara më së miri artistikisht. Vetë Napoleonit i pëlqeu shumë kjo tablo ndaj edhe porositi disa kopje.

Por, përtej vlerave artistike apo historike, tabloja mbart edhe një moment të



NAPOLEONI DUKE KALUAR ALPET

Dr. Bledar Kurti

jashtëzakonshëm të bisedës midis Napoleonit dhe Davidit. Për ta pikturuar këtë tablo artistit i duhej ta bindte Napoleonin të ulej e pozonte për të, dhe ashtu ndodhi, por pas tre orësh torture pozimi, dhe me një natyrë të paduruar siç kishte Konsulli i Parë i Francës, Bonaparte u ngrit dhe bëri të largohej. Kur artisti iu ankua se i duhej ende kohë që ai të pikturonte ngjashmërinë e tij, Napoleoni iu përgjigj: "Askush nuk e di nëse portretet e njerëzve të mëdhenj i ngajnë atyre, mjafton që gjenialiteti i tyre të shpalolet në to." Me fjalë të tjera ai po i tregonte artistit se brezat e ardhshëm nuk donin të dinin se çfarë pamje kishte patur Napoleon-i por se çfarë kishte bërë Napoleoni. Dhe Davidi e kuptoi fare mirë atë mesazh ndaj përdori të birin si model, e ngjiti atë mbi një shkallë sikur të ishte përmbi kalë, duke i shtuar pamjen e Napoleonit, por mbi të gjitha duke arritur të përçonte mbi kanavacë lavdinë e arritjeve dhe emrit të tij.

David-i në fillim kishte menduar ta pikturonte gjeneralin me shpatë në dorë por Napoleoni i shpjegoi se betejat nuk fitoheshin më nga heroizmi i një njeriu të vetëm, dhe e këshilloi ta pikturonte "calme sur un cheval fougueux" (i qetë mbi një kalë të zjarrtë).

Por, pas çdo historie të lavdishme ka gjithnjë një të fshehtë. Napoleoni i kaloi vërtetë Alpet, dhe më pas arriti një fitore të lavdishme në Betejën e Marengo, por ai nuk i kaloi me një kalë hamshor të racës arabe, por i hipur mbi një mushkë, përmes një shtegu të ngushtë, e madje dy ditë pas ushtisë së tij. Por, a ishte kjo e vërtetë e rëndësishme në kapitujt e historisë? Aspak! Davidi kishte një qasje tjetër për artin, ai donte ta përfaqësonte rolin tradicional moral, social dhe politik të artit. Ai nuk ishte thjesht një artist i angazhuar politikisht, por krijonte një art publik dhe e shihte veten si shërbëtor i të mirës së përbashkët kombëtare. Dhe ishte ky qëndrim ai që i mundësoi atij të mbështeste

dy role të kundërta, atë të aktivistit revolucionar të Revolucionit Francez në kohën e Maximilien Robespierre dhe atë të oborrtarit në perandorinë e Napoleonit i cili e rrëzoi qeverinë revolucionare. Ndër artistët e mëdhenj të shekullit, David-i është më konservatori, ose më tradicional, në kuptimin e piktorit patriot, arti i të cilit ishte në shërbim të një ideologjie koherente politike dhe morale.

Arti i Davidit është i pashoqë, por është e kuptueshme përse veprat e tij mund të konsiderohen edhe si propagandistike. Ndryshe nga thënia "një njeri nuk mund t'i shërbejë dy padronëve," Davidi i shërbeu dy sistemeve. Ai ishte mbështetës i Revolucionit ndaj edhe në vitin 1792, ai u zgjodh në Konventin Kombëtar, dhe si admirues dhe mik i Robespierre, ai votoi për ekzekutimin e mbretit (janar 1793) dhe mbretëreshës (tetor 1793), dhe shkurtimisht u bë kryetar i Konventit. Kur qeveria e Robespierre u rrëzua nga komploti thermidorian në korrik të vitit 1794, Davidi, i cili, duke kujtuar Sokratin, kishte bërë betimin që do të "pinte helmin" bashkë me udhëheqësin e tij, e humbi nervin dhe guximin, dhe shfaqësoi veten duke u shprehur se kishte qenë viktimë e hipokrizisë së Robespierre, duke kursyer kështu kokën e vet të pritej nga gijotina. Dhe me të ardhur Napoleon-i në pushtet ai u vu në shërbim të padronit të ri.

Në vitin 1801, Davidit iu dha nga Napoleoni titulli i *Premier Peintre* (Piktori i Parë). Artisti e adhuronte gjeneralin i cili më vonë u bë edhe Perandor. *Voilà mon héros* (Ky është heroi im), u tha ai nxënësve të tij kur Napoleoni e vizitoi atë në studio. Madje kur gjenerali ishte ulur të pozonte për të për ato pak orë, artisti u shpreh disi me servilizëm: "Shikoni çfarë fytire të bukur që ka. Është e kulluar. Është madhështore. Si antikitet." Davidi gjeti tek Napoleoni subjektin ideal,

një fitimtar me pamjen e përsosur dhe me një dhunti të jashtëzakonshme për madhësinë. Ai ishte krenar për padronin e tij pasi zyrtarisht ai tashmë ishte artisti autor i imazhit publik të njeriut më të rëndësishëm të Francës, tashmë një prej figurave më të shquara të historisë.

Por marrëdhënia e Davidit me Napoleoni-n pësoi një ndarje të paparashikueshme. Perandori i ri i Francës, në mënyrë jozyrtare e porositi Davidin të krijonte katër tablo për të përkujtuar fillimin e Perandorisë së re përmes katër skenave: *Kurorëzimi*, *Ulja në Fron*, *Prezantimi i Flamurit të Shqiponjës*, dhe *Arritja në Bashkinë e Parisit*. Për secilën prej këtyre pikturave me përmasa shumë të mëdha, David priste të paguhej 100,000 franga, një shumë e konsideruar tejet e tepruar nga Denon Vivant, kreu i administrimit të artit në oborin e Napoleonit. Kërkesat e vazhdueshme dhe urgjente të David-it për pagesën e irrituan jashtë mase Perandorin dhe çuan gradualisht zvogëlimin e porosive. Nga viti 1810 e më pas, ai ishte Piktori i Parë vetëm me titull dhe nuk iu dha asnjë punë tjetër zyrtare. Vetëm dy nga pikturat përkujtimore u realizuan dhe për përfundimin e tyre u deshën pesë vjet.

Admirimi i madh që Davidi kishte për Napoleon-in u shpalos edhe tek vepra *Kurorëzimi i Napoleon-it* (1805-1807). Më 2 dhjetor 1804, Napoleon Bonaparte legjitimoi veten për një pushtet absolut përmes një shfaqje madhështore pesë orësh në katedralen e Notre Dame e cila ia kalonte edhe miteve të lashta, ritualeve kishtarë dhe të gjitha simboleve të perandorisë dhe monarkisë. Në atë ceremoni madhështore ishte ftuar edhe Davidi, i cili, i ulur në një rën prej lozhave bënte skica pa fund për të përshkruar atë moment epokal. Më pas në studion e tij krijoi figura e kompozime për të krijuar tablonë e madhe me 150 figura. Edhe Perandori nuk ia kursente lëvdatat artistit, kur pa veprën e përfunduar ai i tha: "Kjo nuk është thjesht një pikturë, ka njerëz të gjallë që ecin në këtë tablo, dhe jeta ndodhet kudo. David, ju falënderoj dhe ju përgëzoj, sepse më keni bërë një kalorës të vërtetë francez."

Marrëdhënia e artistit me Napoleonin nuk përfundoi kaq lavdishëm. Në vitin 1814, Napoleoni u rrëzua nga fronti dhe qeveria e ardhshme e Luigji XVIII e la të qetë artistin, por, Napoleoni-i u rikthye dhe e caktoi sërish David-in si Piktori i Parë, por kësaj here artisti nënshkroi një deklaratë besnikërie ndaj Napoleon-it, një akt ky tepër i guximshëm që mund t'i sillte ndëshkimin. E kështu ndodhi, pasi disfatës së Napoleonit në Waterloo, me ardhjen në fron të monarkisë së Bourbon, Napoleoni-i u internua në ishullin e Shën Helenës ku edhe vdiq, ndërsa Davidi bashkë me të gjithë mbretvrasësit e tjerë të cilët kishin përkrahur Napoleon-in u dëbuan nga Franca.

Nga oborri perandorak në mërgatë, Davidi vdiq në Bruksel duke lënë pas një stil neo-klasik që promovoi tematikën heroike në art. Gjatë të gjithë viteve të punës së tij, ai e ndiente që po jetonte në kohë heroike dhe historike ndaj edhe i reflektoi ato tek veprat e tij si *Napoleoni Duke Kaluar Alpet*, apo edhe *Vdekja e Murat*, *Kurorëzimi i Napoleonit*, etj. Por mbi të gjitha na la një imazh të Napoleonit të ngulitur në mendjen e shekujve.

Kur vizitova varrin e Napoleon Bonaparte në *Esplanade des Invalides*, ku hiri i figurës së madhe historike prehet brenda një sarkofagu prej guri të kuqërremtë, në mendje më erdhën triumfet, fitoret, humbjet, ndikimi që ai pati në krijimin e shtetit modern, dhe dëshira e tij e fundit, "Dua që hiri im të rikthehet në brigjet e Senës, në mes të njerëzve të Francës, të cilët i kam dashur aq shumë." Por, teksa mendimet napoleonike flatronin mbi kokën time, përpara syve m'u shfaq imazhi i Napoleonit duke kaluar Alpet, me gishtin e drejtuar përpara, i hipur mbi një kalë flakëruar, e me vështrimin ftues për të marshuar edhe unë drejt historisë. Dhe ai imazh mbeti gjatë të mendjen time, e shfaqet herë-herës sa herë që dëgjoj emrin Napoleon Bonaparte.

Kjo është forca e artit, e cila kapërcen edhe fitoret në betejat më të lavdishme të historisë.

"Ëndrrat janë krijime estetike dhe s'ka dyshim që janë shprehja estetike më e lashtë".

JORGE LUIS BORGES

"Për një ëndërr mund të thuhet gjithçka, përveç se është një gënjeshtër".

ERNESTO SABATO

Një tekst kuptimshëm i pafund

Poezia e Jorge Luis Borgesit me titull "Duke e harruar një ëndërr" është një tekst poetik sa i veçantë aq dhe kuptimshëm i pafund. Ajo na zhyt në një det çështjet dhe është një nga tekstet më të hapur që lexuesit mund t'i ketë takuar ta njohë dhe të ndikohet prej tij.

Madhështia dhe veçantia e kësaj poezie përligjet në dy rrafshje: si vlerë poetike dhe si pafundësi kuptimore. Të dyja janë rrjedhojë e gjuhës poetike që përdor poeti dhe e mënyrës së shtjellimit të tekstit. Këta dy përbërës janë shkruarë në njëri-tjetrin sa nuk mund të flasësh për njërin pa qenë brenda edhe të dytë.

Me këtë krijesë poetike Borges-i na ka dhënë një nga shembujt e rrafshit më të lartë se çka duhet ta cilësojë një tekst poetik dhe si mund të shtjellohet – të ndërtohet ai për të bërë një ndikim estetik të duhur në marrësin. Pikërisht për këto cilësi po e vështrojmë në vijim nga disa rrafshje e aspekte.

Pse Borges-i e zgjodhi ëndrrën për objekt vështrimi poetik?

Shkrimtari Jorge Luis Borges njihet për aftësinë dhe shkaktësinë që t'i zgjedhë dukuritë që i bën objekt vështrimi poetik dhe për kujdesin e skajshëm që i kushton hartimit të tekstit në mënyrë që ai të jetë sa më poetik dhe si i tillë të bëjë ndikimin estetik sa më të madh në marrësin. Arsyet pse pikërisht e zgjodhi si objekt vështrimi poetik ëndrrën, nuk janë të rastit. Të ëndëruarit, ëndrra dhe ajo që ngjet brenda saj si dhe kujtimi për të – rrëfimi i saj, janë çështje që lidhen me jetën e njeriut dhe me natyrën e tij. Pra, është një gjë e pandashme nga jeta e njeriut si dje, si sot, si nesër. Pikërisht për këtë fakt ëndrra ka nxitur që të flitet për të nga kohët më të lashta dhe nga njerëz të shtresave e të vendeve të ndryshme¹. Vetë Borges-i pyet: "[...] a nuk është e kaluara jonë një seri ëndrrash? Ç'ndryshim mund të ketë midis kujtoj ëndrrat dhe kujtoj të kaluarën²?"

Ëndrra në qenësinë e vet është një shqiptim dhe ndërtim i njëmendësisë së ekzistuar ose të dëshiruar, përkatësisht shmangie nga realiteti jetësor, ku veprimet janë të kufizuara dhe zhvillohen brenda një rendi dhe logjike të caktuar; në shumicën e rasteve synimet dhe dëshirat e njeriut në jetën konkrete mbesin vetëm si të tilla. Në një mënyrë ose një tjetër, ëndrra është edhe kundërvënja dhe mohim i realitetit konkret, që përkon edhe me atë që ndodh në botën e përrallës³. Kjo ngjet për arsye se ëndrra është shprehje më vetjake e ndërdujes dhe e përvojës së njeriut, ajo shpreh njeriun në formën e tij më të plotë. Bota e saj është e pakufi dhe e pakufizuar; funksionon mbi parime të mëvetësishme, që janë krejt të tjera në krahasim me ato të botës konkrete, me atë që ngjet në veprimin e përditshëm të njeriut. Siç dihet, në ëndërr thyhen parimet dhe logjika e përditshmërisë; brenda saj ndodhin ngjarje të ndryshme (edhe kundërshtore); të kohëve e të natyrave të ndryshme; ato afrohen dhe njësohen – mes tyre, sikur të ishin të një vendi dhe të një kohe. Pikërisht për këto veçanti të ëndrës një varg shkrimtarësh i krijuan veprat e tyre dhe i krijojnë duke u mbështetur në këtë botë. Në mënyrë të veçantë për këtë dukuri ndikojnë rendi dramatik që shfaqet në ëndërr⁴.

Në ëndërr njeriu nuk di se çka ndodh kur sheh ëndërr, as pse e shohim atë ëndërr. Thuhet se njerëzit e parë nuk e kanë dalluar gjendjen e ëndrës nga zhgënjendria; ata kanë menduar se ëndrrat janë gjendje e të qenit zgjuar⁵. Këtë përcaktimi poetik i dhanë një përmasë edhe më të thellë⁶. Sipas tyre, në

1 Jorge Luis Borges, *Ligjërata*, Përktheu nga frëngjishtja Feride Papeleka, Tiranë 2013, f. 42.

2 Ernesto Sabato, *Para fundit. Ese*. Përktheu nga origjinali spanjisht Orjela Stafasani. OM, Prishtinë 2018, f. 45.

3 Ky punim i përbashkët lindi me nismën e don Robertit. Ai më nisi në italisht poezinë e Jorge Luis Borgesit "Duke e harruar një ëndërr" si një krijesë e veçantë që duhet ta lexoj. Pas një përimtimi të ngadalshëm e vëreja se njëmend poezia ishte me vlerë dhe i thashë ta përkthente. Ai e bëri këtë punë. Përkthimin e rishikova në disa pikë. Kur don Roberti më foli për disa figura mitike dhe biblike të tekstit të poezisë në shqyrtim, i thashë t'i qite në letër, të cilën punë ai e bëri me shumë përkushtim. Pastaj tekstit të tij ia shtova ato pjesë që ndriçojnë veçantitë dhe vlerën e një tekstit letrar poetik të interpretuar. Me një fjalë, është një punim mirëfilli i përbashkët.

4 Thuhet se edhe kafshët ëndërrojnë. Shih Jorge Luis Borges, *Ligjërata*, vep. e përm., f. 37.

5 Jorge Luis Borges, po aty, f. 141.

6 Shih punimin tim *Hyrje në poetikën e përrallës*. Në Çështje të letërsisë gojore. Rilindja, Prishtinë 1982, f. 41 – 101; Shih pjesën "Përralla, miti, ëndrra", f. 56 – 62.

7 Jorge Luis Borges, *Ligjërata*, vep. e përm., f. 37.

8 Jorge Luis Borges, po aty, f. 30.

9 Jorge Luis Borges, po aty, f. 31.

ËNDRRA SI SHUMËSI DHE FSHËHTËSI KUPTIMORË DHE SI VIZION

Nga Don Robert Kola dhe Anton Nikë Berisha

rrafshin poetik, çdo zhgënjendërr është ëndërr.

Paul Groussac thoshte se zgjohemi nga ëndrra pasi kemi përshkuar zonat e hijes, labirintet e ëndrës sonë¹⁰. Sipas Thomas Brown-it, ëndrrat japin një ide të epërsisë së shpirtit të njeriut, meqë shpirti është i pavarur nga trupi dhe priret të luajë e të ëndërrojë¹¹ (Petronë do të thoshte "shpirti pa trupin loz"), ndërsa në një sonet të Gongora-s thuhet:

Ëndrra, autor shfaqës,
në teatrin e saj prej ere
nganjëherë vesh trajta të bukura hijesh¹².

Se bota e ëndrës është për shumëçka e rëndësishme dhe e ndërliqshme, e dëshmon edhe ky mendim i vetë autorit të poezisë "Duke e harruar një ëndërr", Jorge Luis Borges-it: "Ëndrrat janë krijime estetike dhe s'ka dyshim që janë shprehja estetike më e lashtë¹³".

Në "Epin e Gilgameshit", ndër veprat letrare poetike më të lashtat, e shkruar me shkrimin kuneiform, ëndrra gjashtë herë paralajmëron ose shënjon diçka të rëndësishme për zhvillimin e mëtejshëm të veprimit të asaj që ngjet në këtë vepër¹⁴.

Shekspiri thoshte se ëndrra është gjëja që jam¹⁵; në tragjedinë e tij "Hamleti", princi Hamlet i drejtohet Ofelisë, po aq dhe vetes dhe tjetrit: *Se ç'ëndrra shohim natë gjumë-vdekje*, (Akti III, Skenë I). Edgar Allan Poe-ja ishte ndër poetët e rrallë që dëshmoi aftësinë të përshkojë atë "truall" të magjishëm midis reales dhe botës së ëndrës, atë brez të hijëzuar kufitar, ku përvojtat e krijuesit ndërliqohen e gërshe-tohen në mënyrë të çuditshme me përbërës të të dy anëve të mbretërive: jetës e vdekjes¹⁶. Kjo gjë përligjet sidomos në poezinë e tij "Tokë - ëndërr", që është një pamje e botës së ëndrës e kthyer përmbys¹⁷.

Një nga përbërësit e qenësishëm të kryeveprës poetike të Zherar dë Nerval-it "Silvia" është ndërtimi i saj mbi botën e ëndrës, që i jep një përmasë sa të veçantë aq dhe komplekse¹⁸. Edhe bota e veprës "Princi i vogël", një vepër poetike tëpër e rrallë, është e përfutur kryesisht sipas botës së ëndrës. Për këtë arsye çdo qasje dhe interpretim që i bëhet kësaj veprë, duhet të niset nga kjo botë. Shembuj të tillë të thuash se janë të pafund¹⁹.

10 Shih Jorge Luis Borges, po aty, f. 27.

11 Jorge Luis Borges, po aty, f. 35.

12 Jorge Luis Borges, po aty, f. 35.

13 Jorge Luis Borges, po aty, f. 42.

14 *Epi i Gilgameshit*. Përktheu nga gjermanishtja dhe e plotësoi me shënime Anton Nikë Berisha, Rilindja, Prishtinë 1984; Botimi i dytë "Naim Frashëri", Tiranë 1990; i tretë i rishikuar "Argeta – LMG", Tiranë 2008.

15 Jorge Luis Borges, *Ligjërata*, vep. e përm., f. 29.

16 Shih Edgar Allan Poe, *Poezi dhe esse*. Përktheu nga origjinali Dritan Thomollari. Plejada, Tiranë 2004, f. 20.

17 Edgar Allan Poe, *Poezi dhe esse*. Përktheu nga origjinali Dritan Thomollari. Plejada, Tiranë 2004, f. 20

18 Shih Zherar dë Nervali, Silvia. Shqipëroi nga frëngjishtja Beatrice Balliçi. Me një parathënie nga Anton Nikë Berisha. Shtëpia botuese Faik Konica, Prishtinë 2019.

19 Një shembull nga poezia arbëreshe: Në poezinë "La vida es sueño" (Jeta është një ëndërr) poeti arbëresh, Dushko Vetmo, për të depërtuar sa më thellë në shpirtin e vajzës, e përdor ëndrën, për arsye se nëpërmjet saj shprehen në mënyrë të thellë e të natyrshme veçantitë dhe ndërliqësia e fshehtësive të dashurisë dhe ndjenjësia e pazakonshme. Kështu, nënteksti poetik, simbolika dhe metaforika, bëhen pjesë e qenësishme e krijimit poetik.

Ëndërroni vasha një mængjes
se më ish flutur e bardhë
që mbi lule fluturonte
duke ndukur nektar të ëmbël.
(La vida es sueño)

Midis realitetit të ëndrës dhe realitetit konkret, vasha mëdyshet se cila është dhe çfarë është: Vashë e dëlirë ose flutur e bardhë? Kjo metaforë shpreh, para së gjithash, trazimin e vashës së dashuruar; botën e saj të pasur shpirtëror dhe përfytyrimet e pazakonshme, që përligjin mënyrat e ndryshme për të përmbushur dëshirat dhe gjakimet e epshit; provon madhësinë e artit të fjalës, të poezisë, për të zbuluar të veçantën shpirtërore si dhe të dukurve dhe për të vënë komunikim më thellësor me to.

Tani rri e mjera vashë
dhe këshillohet me vetësh: Jam unë vasha e dëlirë dhe ëndërron se po jam flutur apo jam e bardha flutur

Ëndrra dhe kujtimi për të

Borges iu qas dhe e bëri objekt vështrimi poetik ëndrrën (dhe akthin) për arsye se ajo është shumë më e ndërliqshme sesa mendohet në të parë. Kjo ndërliqësi dëshmohej nga procesi i ëndërrimit, vetë ëndrra si dhe rrëfimi i saj, pra përmes kujtimit, pastaj ëndërruesi përballë Hyjit²⁰.

Ëndrra si proces është një mister dhe veshirë i pranon përcaktimet dhe rregullat. Në qenësinë e vet ëndrra i njëson të kaluarën, të tashmen dhe të ardhshmen. Pra, ajo ngërthen shtresime kohësh e dukurish të shumta e të ndryshme. Në vepërën "An Experiment with Time", Dunne thekson dhe një dukuri të rëndësishme të ëndrës e të natyrës së saj: "Çdo njeriu ëndrra i fal një përjetësi të vogël që i lejon të shohë të kaluarën dhe të ardhmen e tij të afërt. Tërë këtë, ëndërruesi e sheh në një çast të vetëm ashtu si Zoti që sheh nga përjetësia e tij e pafundme procesin kozmik²¹". Këtë e thotë vetë Borges-i: "Ëndrra është njëherësh e shumëfishtë (shumësh-tresore) dhe e atypëratyshme²²".

Pa dyshim se veçantitë e këtylla të shumta të ëndrës, pafundësia e asaj që mund të thuhet për të, e ka nxitur Borges-in ta bëjë ëndrën objekt vështrimi poetik dhe t'i shpreh disa nga këto veçanti përmes tekstit poetik dhe pamjeve poetike.

Duke bërë fjalë për ëndrrat Erich Fromm (Erih From) thoshte: "Forcat tona që përcaktojnë ëndrrat tona, janë dëshirat tona irracionale. Në gjumë u japim jetë atyre impulseve, ekzistencën e të cilave nuk duam ose nuk guxojmë ta pranohet kur jemi të zgjuar [...] Prirjet irracionale, që në ëndërr shprehen si të plotësuara, i kanë rrënjët të fëmijëria jonë..."²³.

Bota e ëndrës, shumësia e dukurive dhe e vlerësimeve që nxit ajo, dyshimet që mbesin edhe pas përgjigjeve të ndryshme, dëshmon se ajo ndërliqëhet me shumë çështjeve të jetës dhe se ato mëdyshje në një mënyrë ose në një tjetër ndodhin dhe në veprimet e jetës së njeriut. Është ajo që ka thënë poeti austriak Walter von der Vogelweider, kur e pyet veten "Ist es mein Leben geträumt oder ist es war?" A është e ëndërruar (ëndërr) jeta ime ose ajo është njëmendësi²⁴.

Një dukuri tjetër po aq e rëndësishme që ngërthen ëndrra dhe ajo që ndodh pas saj, ose interpretimeve që i bëhen asaj (nga paraardhësit dhe vetë Frojdi) është ndryshimi që ngjet midis ëndrës dhe kujtimit të saj, përkatësisht të treguarit të saj (pas çastit të ëndërrimit), që nuk është i vogël. Thomas Brown thotë se "[...] kujtimi për ëndrrat është më i varfër se realiteti i tyre i shkëlqyer²⁵".

Ëndrra frymëzim i vizionit

Thuhet se poeti është mburoja e ëndrës zanafillore, ndërsa poezia zgjimi i saj. Përmes saj (ëndrës) endërr një misteri i pafund. Ëndrra është frymëzim i vizionit. Vizioni është shndritje. Shndritja është përmbushje e trajtës. S'ka

dhe ëndërroj se po jam vashë?

(La vida es sueño)

Në bazë të dhënës së Erich Fromm këtë metaforë e përdor një poet kinez. Duke folur për cilësitë e pazakonshme dhe të çuditshme të ëndrës dhe mëdyshjet që lënë ato te njeriu, ai shkruan: "Këtë dyshim një poet kinez e ka shprehur saktë: 'Mbrëmë natën pashë ëndërr sikur qeshë flutur dhe tani nuk e di a jam njeriu që ëndërroi sikur që flutur, apo flutura ëndërrova se është njeri.'" (Shih E. Fromm, *Gjuha e harruar*. Përktheu nga Kujtim Ymeri. Dituria, Tiranë 1998, f. 6. Shih më gjerësisht në studimin tim *Sull'opera Letteraria di Dushko Vetmo. Studio. Mbi veprën letrare të Dushko Vetmos. Studim*. Università della Calabria. Dipartimento di Linguistica, Sezione di Albanologia. Fondazione Universitaria "Francesco Solano", Rende (Italia) 2009, f. 18 – 19.

20 Sipas Boecit krahas atij që ëndërron është edhe Hyji, i cili i sheh të gjitha gjërat në një çast të përjetshëm, pra përshin historinë universale. Shih Jorge Luis Borges, *Ligjërata*, vep. e përm., f. 28.


21 Shih Jorge Luis Borges, po aty, f. 29.

22 Jorge Luis Borges, po aty, f. 29.

23 Shih Erich Fromm, *Gjuha e harruar*. Përktheu nga Kujtim Ymeri. Dituria, Tiranë 1998, f. 35.

24 Jorge Luis Borges, *Ligjërata*, vep. e përm., f. 31.

25 Jorge Luis Borges, po aty, f. 28.



Don Robert Kola

vizion pa shndritje dhe s'ka përmbushje të trajtës pa frymëzim. Misioni i poetit dhe i poezisë qëndron në shndritjen e trajtës.

Pra, poezia është thurje e njëmendësisë me dritën virgjërore të krijimit, ndërsa poeti ëndërrimtari që mbjell dritën e zanafillës..

Poezia e Borges-it "Duke e harruar një ëndërr", e ndërtuar mbi ëndërrën e këputur të zanafillës, është, siç thamë, njëra prej poezive më të thella të tij. Duke shquar natyrën e poetit, autorja spanjolle M. Zambrano, thotë: "[...] Poezia kërkon të rifitojë ëndërrën zanafillore, nga e cila njeriu u zgjua pas rënies së parë; kërkon ëndërrën e pafajësisë së mëparshme, ajo që ishte para pjekurisë së tij. Poezia është njësim, pajtim, përfaqim që shtrengon në bashkim qenien njerëzorë me ëndërrën prej së cilës vjen, duke shlyer hapësirat. Metafizika, përkundrazi, është largim i përhershëm nga ëndërra zanafillore. Filozofi beson që vetëm duke u larguar, e vetëm duke u zhytur në humbëtitë të lirisë dhe vetëm duke mbetur deri në fund vetvetja, do shpëtojë, do jetë."²⁶

Nga vargu i parë kjo poezi e Borges-it na ballafaqon me misterin e ëndërrës. Ajo e përshkon poetin me dritën e saj. Nga ëndërra e ëndërruar, poeti nuk kujton asgjë tjetër, pos dyerve të shumta që e rrethojnë.

*Në mëngjesin e dyshimtë pashë një ëndërr.
Mbaj mend se në ëndërr kishte disa dyer.*

Drita e vizionit kalon përmes derës, por nuk mbyllët përmes saj. Drita e saj hap dier aq sa përhapen edhe rrezet e saja. Misteri hyn përmes derës, por nuk mbyllët nga asnjë derë. Sa i thellë del vëzhgimi i M. Buber-it, i cili duke folur për takimin e përsosur që kërkon heshtja e trajtës së krijesës, heton se si të gjitha dyert e saj bashkohen në një derë të vetme dhe njeriu nuk di përmes cilës ka hyrë brenda saj: "Mund të rrëmbehemi nga jeta përmes natyrës, botës 'fizike', të konsistencës; nga jeta me njerëzit, botës 'psikike', të ndjesisë; nga jeta me qenësinë shpirtërore, botës 'noetike', të vlefshmërisë, dhe kështu mund të përshkohet tejdukshmëria e tyre, kuptimi i tyre. Secila nga këto sfera mund të bëhet dhe bëhet e rëndësishme, apo të mbesin dhe të pashndritura, pa marrë parasysh si do t'i quajmë ato, edhe nëse i emërtojmë me emra të shkëlqyer, si kozmos, eros dhe logos. Në të vërtetë, për njeriun kozmosi qëndron, nëse gjithësia bëhet shtëpia e tij, një vatër e shenjtë, ku kryen flitë e kushtuara; për njeriun qëndron erosi, vetëm nëse për të qenia bëhet ikonë e amshimit dhe bashkimi me qeniet e tjera një zbulësë; për njeriun qëndron logosi, vetëm nëse apelon në mister duke vepurur dhe duke shërbyer shpirtin. Kërkimi i heshtjes që lyp trajta, gjuha dashamirëse e njeriut, shpallja e heshtur e krijesës: të gjitha janë dier që na udhëheqin kah prania e fjalës. Mirëpo, kur vjen koha të ndodhë takimi i përsosur, dyert bashkohen në një derë të vetme të jetës reale dhe nuk dihet se nga cila derë ke hyrë brenda"²⁷.

Në çastin e zgjimit poeti është në mëdyshje. Përmallimi për ëndërrën e thellë që ka e përshkuar shpirtin e tij, nuk e shuan kërkimin. Ëndërra e tij bëhet e pakapshme, sidomos nga hija e miteve antike, që i thuren ëndërrat e njerëzimit përmes mitologjisë aq thellë, siç rrefën edhe miti i Tiresias. Ëndërra bëhet edhe më e pavëzhgueshme nga shfaqja e premtimit të Abrahamit nën qiellin e Urit të Kaldesë, kur Hyji i premton së pasardhësit e tij, do të jenë pa fund, si vjet e qiellit dhe si rëra e detit. (krhs Zan 15, 1-21) Po ashtu, vëzhgimet që vijnë nga Spinoza, trullonin mendjen e poetit, mbase ky mendimtar Hyjin e njëson më natyrën, kur tha:



Anton Nikë Berisha

"Deus sive natura."

Vizioni i ëndërrës së poetit bëhet sa i pakapshëm, po aq edhe i përmallueshëm; nuk pajtohet që ëndërra e tij të tretet me zgjimin e mëngjesit.

*Zgjimi im në mëngjes bëri të shuhet
ajo përralla intime që tani
është më e pakapshme se hija
e Tiresias ose e Urit të Kaldesë
ose e mëtimeve të Spinozës.*

Poeti nuk ndalon vetëm në përbluajtë e përimtime filozofike; nuk gjen prejhe derisa ëndërra e tij, nuk lartësohet në gjirin ngushëllues, ku përmbledhet çdo ëndërr dhe çdo lot i derdhur.

*Është e njohur që një irlandez thoshte
që në vëzhgimet e Hyjit, i cili nuk fle asnjëherë,
çdo ëndërr bashkohet në amshim
çdo kopsht i zbrazët dhe çdo lot.*

Pra, poezia është rruga e njësimin me transcencencën. Ajo pret ngadhënjimin e dashurisë. "Poezia është ikje dhe kërkim, nevojë dhe frikë, është vajtje dhe ardhje, është thirrje për ikje; është ankth pa fund dhe dashuri pa mbarim. Nuk mund të përqendrohet mbi zanafillën, sepse dashuron botën dhe krijesat e saj dhe nuk gjen prejhe derisa ato nuk do të njësohen me të në zanafillë. Nga kjo rrjedh se poezia

JORGE LUIS BORGES

DUKE E HARRUAR NJË ËNDERR

Në mëngjesin e dyshimtë pashë një ëndërr.
Mbaj mend se në ëndërr kishte disa dyer.

Pjesa tjetër më treti. Zgjimi im
në mëngjes bëri të shuhet
ajo përralla intime që tani
është më e pakapshme se hija
e Tiresias ose e Urit të Kaldesë
ose e mëtimeve të Spinozës.

E kalova jetën duke përimituar
dogmat me të cilat përballeshin filozofët.
Është e njohur që një irlandez thoshte
që në vëmendjet e Hyjit, i cili nuk fle asnjëherë,
çdo ëndërr bashkohet në amshim
çdo kopsht i zbrazët dhe çdo lot.
Vijon dyshimi dhe hijësimi rritet.
Po të dija çka ishte ajo ëndërr
që ëndërrrova ose çfarë do të kem ëndërruar,
do t'i dija të gjitha gjërat.

*Përkthyer nga italishtja
(krahasuar dhe me origjinalin spanjisht)*

DON ROBERT KOLA
ANTON NIKË BERISHA

është dashuri e birit, e të dashurit dhe dashuri e vëllait. Jo vetëm që dëshiron të kthehet në soditjen e zanafillës, por gjakon që të kthehet së bashku me të gjithë dhe s'mund ta arrijë këtë, pos në saje të shoqërimin, përmes shtegtarëve, fytyrat e të cilëve i ka parë nga afër, i ka ndier ofshamat e tyre së bashku me të vetat, në mundimin e udhëtimit [...]. Poezia nuk ndërthen individualitetin, por bashkësinë. Ajo synon njësimin e gjithëmbarshtëm: ngadhënjimin e dashurisë²⁸.

Vizioni i ëndërrës është fshehtësia e gjërave; shfaqet vetëm përmes dashurisë. Me ngulmim poeti kërkon të kapërcejë pragun e vizionit, dhe të gjendet në vatrën që shndrite thelbin e fshehtësisë të çdo gjëje:

*Po të dija çka ishte ajo ëndërr
që ëndërrrova ose çfarë do të kem ëndërruar,
do t'i dija të gjitha gjërat.*

Poezia "Duke e harruar një ëndërr" është "shifër e transcencencës". Përmes saj poeti kërkon të qëndrojë në pragun e vizionit, nga merret drita e trajtës. Tërë krijesa pret të përmbushet me dritën e amshuar.

Përmasat poetike të tekstit

Përbërësi kryesor që i jep shpirtin dhe pafundësinë kup-timore kësaj poezie të Borges-it, që nxit komunikim të pazakonshëm dhe një ndikim estetik të skajshëm është teksti i saj. Pikërisht kjo poezi e përligj atë mendimin e njohur të studiuesit të shquar rus, Jurij. M. Lotman, i cili thoshte: "Me siguri mund të thuhet se midis gjithë asaj që ka krijuar dora e njeriut teksti artistik në masën më të lartë ka ato cilësi, të cilat kibernetistin e nxisin të merret me indin e gjallë²⁹".

Veçantia e parë që e cilëson tekstin e kësaj poezie të Borges-it është ngjeshësia apo dendësia e tekstit. Autori ka hequr nga teksti çdo gjë të tepërt; ka lënë vetëm atë tekst që mjafton të kapën çështjet dhe kuptimet kryesore, që shkaktajnë pastaj degëzime të pafundme. Për këtë do të bindemi nëse synojmë të heqim qoftë edhe një varg madje edhe një fjalë dhe më nuk e kemi poezinë përkatëse. Pra, poezia "Duke e harruar një ëndërr" ka një tekst skajshmërisht të kursyer dhe të menduar mirëfilli.

Shumëkuptimësia e tekstit fillon në pjesën e parë të vargut të parë: *Në mëngjesin e dyshimtë*, me çka dyshimi parashënjon qenësinë që e përshkon gjithë krijimin. Si mund të jetë mëngjesi i dyshimtë dhe për çka shërben ky mëngjes i dyshimtë? Natyrisht, në tekstin poetik është e mundur, madje një mënyrë e këitillë e shqiptimit parapëlqehet. Pikërisht në këtë mëdyshje të mëngjesit, zënë fill mëdyshjet e tjera, po dhe shprehjet e tjera figurative që i japin shpirtësinë e poezisë si tërësi. Shprehja tjetër, sa e veçantë, aq dhe kuptim-shitë e pafund, është *përralla intime [...]* / *më e pakapshme se hija / e Tiresias ose e Urit të Kaldesë*, ku shumësi kuptimore degëzohet, në dy rrafsh kryesore: në atë poetik dhe në atë teologjik e mitik. Në rrafshin e parë teksti të vë para një pafundësi dyshimesh (vazhdon dyshimi nga vargu i parë): Cila është përralla intime e njeriut? Njëmendësia? Ëndërra? Synimi? Dëshira? E kaluara? E Ardhmja? Ose të gjitha së bashku?

Vargu tejet i rrallë: *Hyjit, i cili nuk fle asnjëherë*, ndërlikohet ngushtë me vetë aktin e ëndërrimit, të ëndërrës. Në rrethana të rëndomtë nuk thuhet se Hyji nuk fle (rëndom thuhet është gjithnjë i zgjuar, roje e përhershme etj.), po këtu njësohet mirëfilli me ëndërrën dhe me harrimin e saj. Kjo është në lidhje të ngushtë me vargun tjetër: çdo ëndërr bashkohet në amshim, që i përket Hyjit të gjithëpushtetshëm dhe të gjithëkohshëm. Edhe vargu: *Vijon dyshimi dhe hijësimi rritet* dëshmon për vazhdimësinë e rrafshit të lartë të të shprehurit poetik: ndërlikohet me dyshimin të shfaqur në vargun e parë dhe në vijim, po këtu pos dyshimit kemi dhe hijësimi; të fshehtë, të pathënshëm; atë që secili lexues, në mënyrë të mëvetësishme, e imagjionon. Pra, edhe dyshimi, edhe hijësimi shkojnë e rriten sa më shumë që i afrohem fundit të tekstit, po jo dhe fundit të mendimeve që nënkuptohen dhe nxiten nga teksti.

Edhe fundi i poezisë, që në vështrim të parë duket i qartë, dëshmon për vijimësinë e dyshimit që nis me pjesën e parë të vargut të fillimit: *Po të dija çka ishte ajo ëndërr dhe [...] çfarë do të kem ëndërruar, / do t'i dija të gjitha gjërat.*

Nga këto vargje lind pyetja: çka di njeriu? Pse është dija e tij e kufizuar? Mos kjo të shpie vetvetiu tek ideja se vetëm Hyji është i gjithëdijshëm? Ose sa shumë i mbetet njeriu të mësojë për qenien dhe ekzistencën e vet?

Edhe fundi i tekstit të kësaj poezie e përligj atë që thamë në fillim: tekste të saj është nga më të hapurit që është përftuar nga Borges-i po dhe nga poetë të tjerë.

Dhjetor 2021

26 M. Zambrano, *Filosofia e poesia*, Edizioni Pendragon, Bologna 2018, f. 109.
27 M. Buber, *Il principio dialogico e altri saggi*, San Paolo, Milano 1993, f. 132t.

28 M. Zambrano, *Filosofia e poesia*, vep. e përm., f. 118.
29 J. M. Lotman, *Struktura umetničkog teksta*, Nolit, Beograd 1976, f. 384.

FRANO KULLI



FJALOR
i veprës së
FISHTËS

 BOTIMET
FISHTA